

PRELË LEKOÇAJ



Krenaria jonë

New York, 2017

PRELË LEKOÇAJ

Krenaria jonë

New York, 2017

Recensues: Zef **KASTRATI**

Redaktor: Dr. Haxhi **BERISHA**

Art grafik: Toni **NAÇI**

Në ballinë: pikturë nga Agim **GECAJ**

Shtypur nga: S H T E P I A B O T U E S E
mediaprint

ISBN: 978-9928-08-323-4

© Copyright: Autori

Të gjitha të drejtat e botimit në gjuhën shqipe janë të ndaluara pa pëlqimin e Autorit.

“Nihil est veritatis luce dulcius”

Nuk është asgjë më e ëmbël se sa drita e së vërtetës

PËRMBAJTJA

Hyrje

I. Krenaria jonë.

- Nderi i shqiptarit. Shqiptari i vërtetë. Si i merret ndera burrit? Trimëria. Krenaria jonë. Miqësia sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit. Çfarë duhet të bëjmë që të ruhen doket dhe zakonet shqiptare? faqe 10

II. Disa zakone e të meta tek kombit shqiptar.

- Doket pagane; pijet alkoolike; duhani; droga; hajet; kafeini. Mungesat tona: urrejtja; hakmarrja, mendjemadhësia; ndarja (divorci); kurvëria; homoseksualiteti; magjia; aborti. Ndryshim traditash: feja. faqe 18

III. Familja.

- Martesa. Përse martohet njeriu? Përcaktimi martesës dhe fejesës sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit. Fjaltë e urta të Salomonit. Mendimet e La Brujere-it për gratë. Mendimet e Montaigne-it për gratë. Përcaktimi detyrave të burrit dhe anasjelltas sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit. Grueja e pa-kunorë. Si duhet ta ruajmë martesën? Rinia. Dashuria dhe miqësia. Dhjetë gjëra për të qenë një baba i mirë. Detyrat e nënës. Ca këshillë për prindërit..... faqe 36

IV. Shoqëria.

- Babai dhe djali. Thënie nga mendimtarët për miqësinë faqe 60

V. Njerëzit: prishësit e botës.

- Ushqimi; pija; karakteri; liria; shëndeti; natyra dhe fitimi faqe 62

VI. Truri i njeriut.

- Urtësia. Thënie nga mendimtarët për shpifjen. Dituria vjen nga Perëndiafaqe 64

VII. Shëndeti.

- 1. Rrezet e diellit. 2. Ajri i pastër. 3. Përmbaju, pa teprim. 4. Pushimi.
- 5. Lëvizjet. 6. Ushqimi i mirë faqe 70

VIII. Stresi faqe 78

IX. Besimet fetare ndër shqiptar.

- Pse të gjithë besimet janë të sigurtë se janë me Zotin? Si mund ta njohim Perëndinë? Çfarë është mëkati? Kush mund t'i falë mëkatet tona? Kush është Jezu Krishti? Përse Jezusi s'e di ditën e ardhjes së tij? A është puna e Perëndisë një mister për njerëzit? Jezusi dhe Zoti nuk janë dy zotra. Dashuria e Jezusit është shpëtim ynë. Cilat janë urdhërimet e Zotit? Pse ne duhet t'i mbajmë urdhërimet e Zotit? Si duhet të përgatitemi për ardhjen e Jezusit? Lutja është bisedë me Perëndinë dhe çelësi për parajsë. Kur Perëndia nuk përgjigjet lutjeve tona. Pesë gjëra që na pengojnë që të jemi më afër Zotit. Çfarë i bënë njerëzit të lumtur? Urdhërimet e Zotit për prindërit. Njëmbëdhjetë shenjat e fundit të kohës. Çfarë duhesh të jesh për të qenë njeri i mirë? Çfarë është parajsa? Çfarë është jeta pa zotin? A shkojnë të gjithë njerëzit e botës para gjykimit të Perëndisë? faqe 82

X. Miscellanes.

- 1. Shkenca sipas Darvinit. - 2. Perëndia krijoi njeriun e parë. - 3. Çfarë është jeta jonë? - 4. Armiku ynë. - 5. Kombi shqiptar është komb i ndarë. - 6. Çfarë duhet që bashkimi kombëtar të jetë i mundshëm? - 7. Fjalët e hallkut. - 8. Kush i kontrollon mendimet tona? - 9. Rreziku ynë. - 10. Krimi. - 11. Këshillë për udhëheqësit e popullit shqiptar. - 12. Pasuria. - 13. Të këqijat. - 14. Budallai dhe i marri. - 15. Liria. - 16. Çfarë duhet ne të ndryshojmë? - 17. Etika Indiane. 18. Lutje për kombin shqiptar faqe 116

Në vend të përfundimit faqe 133

Bibliografia faqe 134

Ne duhet gjithmonë të kemi në mendjen tonë një gjë: Të gjithë njerëzit e botës janë krijesa të Perëndisë. Perëndia i do të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë. Për këtë arsye s’duhet të poshtërojmë askënd, as të urrejnë pa marrë parasysh se çfarë kombi, feja apo ngjyra i takojmë. Të poshtërosh të tjerët është një mëkat përpara Zotit. Detyra jonë është që të mësojmë njëri-tjetrin aq sa dijmë, por në anën tjetër ne s’mund ta detyrojmë atë të jetë sikurse ne. Ju duhet të shikoni njerëzit ashtu sikur Perëndia i vështron. E Perëndia i shikon njerëzit sikurse mëkatarë, të cilëve i jep një rast për t’u përmirësuar.

Në këtë libër do të citohet në vazhdimë Kanuni i Lekë Dukagjinit, vepër që është mbledhur, radhitur dhe kodifikuar (të gjitha ata që kanë mbetur nga mendimet juridike të Shqipërisë në Kohë të Mesme) nga At Shtjefën Gjeçovi, edhe pse ka shumë të ngjarë që këta mendime t’i kenë rrënjët shumë përtej Kohës së Mesme. Në Kanun e Lekë Dukagjinit thuhet shkurt e shqip: nuk veçohet njëri prej tjetrit, “Shpirt per shpirt, se duket e falë Zoti” ose në një rast tjetër kur e bënë me dije se sikurse i miri dhe i keqi kanë një tagër (çmim). Me një fjalë në Kanun të Lekë Dukagjinit thuhet se: “Del i miri prej të keqit e i keqi prej të mirit.” Në Kanunin e Maleve të Shqypnis apo i njohur gjithkund si Kanun i Lekë Dukagjinit është shkruar se gjithë ata djem që lindin, njehen të mirë e nuk veçohen njëri prej tjetrit. Çmimi i jetës së njerit është një, si për të mirin si edhe për të keqin. Seicilli mbahet i mirë edhe i thotë vetit: “Jam burrë” e i thonë: “A je burrë!”

Edhe qëllimi i këtij libri është që të thuhet e vërteta ashtu siç është, të ketë dashuri ndërmjet njerëzve, të ketë mirëkuptim në shoqëri, të luftohen të metat, të këshillohet rruga e drejtë, të mos keni smirë dhe urrejtje për të tjerët, të jeni besimtarë të devotshëm në urdhërimet e Perëndisë dhe në fund të ruheni nga mëkati.

Le të japim ca fjalë të urta që janë thënë në kohë dhe vende të ndryshme:

- 1) E vërteta është si dielli, të gjithë e duam, por kur e ndiejmë që na djeg, vrapojmë të fshihemi nëper hije;
- 2) Të vërtetën të gjithë e duam, e megjithatë shumica ikën prej saj;
- 3) E vërteta është si ilaçi i syve: të djeg në fillim, por më vonë të bënë të shohësh qartë;
- 4) Të gjithë shesim diçka, por e vërteta është shitur rrallë;
- 5) Njerëzit duan të dëgjojnë atë që u pëlqen, nuk kujdesen për të vërtetën;
- 6) E vërteta është frika më e madhe e atyre që kanë bërë gabime;
- 7) Kush kërkon të vërtetën duhet ta dijë se si ta pranojnë atë;
- 8) Respektimi i autoritetit është armiku më i madh i së vërtetës;
- 9) E urrejtja është lindur nga e vërteta;
- 10) Të thuash të vërtetën dhe të bësh dikë të qajë është më mirë se sa të gënjesh e ta bësh të buzëqesh;
- 11) Jepni dikujt një maskë dhe ai do t'ju tregojë të vërtetën;
- 12) Gjithmonë kur fillon një luftë, e vërteta është viktimja e parë.

Le të japim ca thënie për të vërtetën nga mendimtarët e filozofët si Madame de Stael, Masaryk, Tagore, Volter të cilët thonë:

- a) Kërkimi për të vërtetën është preokupimi më fisnik i njeriut dhe publikimi i saj është një detyrë;
- b) Në politikë, e vërteta duhet të presë derisa dikush ta bëjë të nevojshme;
- c) Nëse ju e mbyllni derën të gjitha të metat dhe të vërtetat do të mbesin jashtë;
- ç) Të vërtetat nuk janë për të gjithë njerëzit e as për të gjitha kohërat.

I. KRENARIA JONË

Krenaria shqiptare

Unë jam krenar që jam shqiptar,
jam i fortë por si arrë.
Jam ruajt unë ditë për ditë,
të parët e mi mos me i koritë.

Jam krenar që jam shqiptar,
me punë të mira jam i parë.
Simbas traditës i kam nderuar,
babë e nënë, sepse i dua.

Ne jemi krenarë që jemi shqiptarë,
e kemi ruajtur kombin farë mbas fare.
Na mëson baba, për ta mësuar djalë,
me dashtë njeriun, fushën e malin.

Jam krenar që jam shqiptar,
se lë Zotin, pa më tretë fare.

S'ia bëj të keqen të afërmit tim,
pa u djeg unë në zjarr e në tym.

Ne jemi krenarë që jemi shqiptarë,
koha e keqe s'ka me na ardhë.
Do të jetojmë me lumturi,
se e kem Zotin në shtëpi.

Jemi krenarë që jemi shqiptarë,
edhe sot jemi si më parë.
I mësojmë fëmijët për me u rrit,
si të parët tanë pa u korit.

Jemi krenarë që jemi shqiptarë,
do të shkëlqejmë por si ar.
Do ta dijnë bota se kush jemi,
si të tanë tjetër ne nuk jemi!

Nderi i shqiptarit

Shqiptari është trim, kryekëput i ndershëm e besnik. Shqiptari për të mbajtur besën e ka dhënë jetën. Shqiptari e dinë se si të mirëpret e të përcjellë mikun. Lord Bajroni që që ka vizituar Shqipërinë më 1809 shkruante për shqiptarët: ndonëse kanë shumë mangësi, por asnjë poshtërsi. Ndoshta janë raca më e bukur në botë nga tiparet dhe gratë e tyre dendur janë të bukura. Në një rast tjetër Bajroni tregon se çfarë është miqësia e shqiptarit: kur kërkova ta paguaj një shqiptar për shërbimet që më kishte bërë, ai u vrenjt në fytyrë e më tha: “Dua të më duash, jo të më paguash”. Këto qenë fjalët e tij. Dihet botërisht se shqiptari e ka dhanë jetën për shokun dhe mikun. Shqiptari është i njohur për një gjë tepër të rrallë në botë: ka ditur për ta falur edhe armikun. Po gruaja shqiptare? Është e dëgjueshme dhe shtëpiake. E ka ruajtur martesën dhe nderin e shtëpisë. Lord Bajroni thoshte për gratë shqiptare: “Ato lërojnë e çajnë tokën, ato mbjellin. I kam parë të ngarkuara me dru dhe tek ndreqin rrugët e prishura. Gratë merren me punë, por kjo nuk duhet t’i lodhë shumë në një klimë aq të këndshme.” Shqiptarët e kanë pasur një karakter të mirë, ashtu si të gjithë ata që janë me Perëndinë. Kurse Simon Filipaj shkrunte për nderin e shqiptarit: “Nderi, kjo është pasuria më e madhe e malësorit. Kur është fjala, këtu nuk ka diskutim fare. As i varfëri më i madh, i cili ndoshta nuk ka as darkën, nuk e konsideron veten aspak më të ulët se pasaniku më i madh, vetëm nëse ka “nderin”!

Shqiptari i vërtetë

Shqiptari i vërtetë është përplot energji. E ka mendjen e kthjellët. Ai është largpamës dhe i dijsëm. Ai është një punëtor i palodhur e, gjithmonë është në lëvizje. Ai është zemërgjerë dhe s’ka ankesë. Ai është një mik i vërtetë, sepse ka: besën, shpresën, besimin dhe dashurinë. Është një kënaqësi e veçantë të kesh miqësi me shqiptarin e vërtetë, sepse kur të bisedosh me te, kuvendi s’ka të sosur.

Si i merret ndera burrit?

Në Kanunin të Lekë Dukagjinit thuhet:

- a) Me i thënë kush se rrën faqe burrave të mbledhun në kuvend;
- b) Me e pshtë, me i u matë, me e shtë a me i rá kush.
- c) Me i prishë ndermjetsín a besen.
- d) Me i a dhúnue gruen a me i a hikun.
- e) Me i a marrue armët e krahit a të brëzit.
- f) Me i a dhunue buken, tuj i a nga mikun a pûntorin.
- g) Me i a thye shpín, vathin, kotecin a çerranikun n’oborr.
- h) Me i a ndalë uhan a detyren.
- i) Me i a luejtë rrasen e vekshit në voter.
- j) Me nje kapshaten parpara mikut-i mirret ndera mikut.
- k) Me korit trevezën nder sy të mikut, kur i zoti i shpis e kruen fulteren a shin e lpin kupen.

Aj, të cillit i u muer ndera, xehet i dekun kah kanuja.

Në Kanunin të Lekë Dukagjinit thuhet:

- a) Shpija e Shqiptarit është e Zotit e e mikut.
- b) Mikut i lshohet kryet e vendit.
- c) Mikut do t’i bahet nderë: “Bukë e krypë e zëmer.”
- d) Buka e krypa e zemëra, zjarmi e trangu e do firi për shtrojë do të gjindet gadi për mik në çdo kohë të natës e të ditës.
- e) Po të hini miku në shpi, gjak me të pasë, do t’i thuejsh: “Mirë se erdhe!”

Trimëria

Eruditi Faik Konica kur shkruante mbi trimërinë e vërtetë të shqiptarëve thoshte: Shqiptarët janë një komb të cilëve i pëlqen të lëvdojnë veten. Si

thonë gojë-rumbullët tanë, kombi shqiptar është i pari nga mendja, nga të sjellurit, e nga trimëria.

Mua më duket se një njeri që i ka trutë në vend nuk duhet të flasë në atë mënyrë. Të ishte se shqiptarët të qenë jo kombi më i ditur do të kishin dalë që me kohë nga dita e zezë ku ndodhen. Po mendja e tyre është aq e ngushtë sa, edhe kur mësohen e udhëtojnë, shqiptarët nuk arrijnë të harrojnë vogëlitë e mbrapësitë e tyre e të lidhen urtisht duke ulur sicilido pak vullnetin e tij përpara vullnetit të të tjerëve.

Sa për të sjellurit (a karakterin) më mirë është ta kthejmë këtë fletë, e të flasim për të tjera.

Mbetet trimëria. Shqiptarët besoj se janë e duhet të jenë me të vërtet trima me qenë se edhe të huajtë i njohin për të tillë. Vetëm, një gjë më çpon pak: çfarë trimërie kanë shqiptarët?

Trimëria e shqiptarit nuk është e artë është e teneqenjtë. Në të tjera fjalë, trimëria e shqiptarit, sa do e madhe në vete, është e vogël në shkaqet që e ndezin. Për një të grabitur, për fjalë të shtrëmbër, e shumë herë pa ditur as vetë për se, shqiptarët marrin armët, hidhen, vriten. Por ata njerëz që vriten për interes e për përralla, ftohen edhe frikësohen po të jetë nevojë trimëria për ndonjë mendim të bukur, për ndonjë dobi të vërtetë e të përgjithshme.

Pali a Pjetri, Lami a Hasani, nuk kanë frikë nga plumbi, po dridhen nga Valiu!

Trimëria e vërtetë është ajo që vihet në shërbim të së Drejtës e të Atdheut, do me thonë në shërbim të dobisë së përgjithshme. Të tjerat punë, janë punë egërsie e kafshërie, jo trimërie - përfundonte Konica.

Le të shënojmë ca fjalë të urta shqipe për trimërinë:

- 1) Nuk është trim ai që vret por ai që falë;
- 2) Hero është ai që e bënë armikun shok të vet;
- 3) Trim është ai, që di të durojë rrezikun;
- 4) Me zaptua vetin është ma e madhja trimni;
- 5) Fuqia e madhe është në atë njeri, i cili mundohet të hesht edhe kur është i drejtë;
- 6) Mirë është të falësh, por më mirë është të harrosh.

Turpi

Për turpin kemi fjalë të urta në gjuhën shqipe që e shprehin më së miri: Nuk është turp me u rrëzua, turp është mos me u çua; Nuk është turp që të mos diësh, turp është kur s' do të mësoh; Më i madhi turp është kur njeriu s' turpërohet prej turpit të vet; Për gjithçka ka ilaç, përveç turpit; Dy herë gabon ai që i del zot gabimit; Mendo mirë e mbaju, mendo keq e thaju.

Krenaria jonë

Me që ra fjala për çështje të krenarisë, një gjë duhet ta kemi qartë: duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse shpeshherë krenaria është një mëkat. Me një fjalë: jemi mëkatarë, në fakt s' kemi pse të jemi aq shumë krenar. Vetëm me një gjë mund të krenohemi: bekimin e Zotit. Në të shenjtën *Bibël* thuhet: “Sytë krenarë dhe një zemër kryelartë, që janë llamba e të pabesëve, janë mëkat.” (*Fjalët e urta* 21:4). Në fjalë e moçme shqiptare thotë: “Çfarë është krenari për budallën, për të urtin është turp.”

Në qoftë se Perëndia s' është krenare me ne, atëherë te ne s' ka krenari. Edhe pse shumë njerëz janë krenarë, sepse ata mendojnë se janë më të vlefshme se të tjerët. Mendojnë se duke u marrë me gjëra të liga: kurvërim, pasuri e turpshme, idhujtari etj., të gjitha këta pa përjashtim të drejtojnë në mëkat. Në *Bibël* thuhet: “Sepse gjithçka që është në botë, lakmia e mishit, lakmia e syve dhe krenaria e jetës, nuk vjen nga Ati, por nga bota. Dhe bota kalon me lakminë e saj; por ai që bën vullnetin e Perëndisë mbetet përjetë.” (1 e Gjonit 2:16-17); - “E ka vendosur Zoti i ushtrive, për të errur krenarinë nga çfarëdo shkëlqimi, për të ulur gjithë njerëzit e nderuar të dheut.” (*Isaia* 23:9).

Shtrohet pyetja: çfarë na bën ne të jemi krenarë - varret e paraardhësve apo sjelljet tona ndaj njerëzimit dhe Perëndisë?

Jam krenar që jam shqiptar dhe e falenderoj Perëndinë:

- 1) Zoti krijoi prindërit e mi të ndershëm;
- 2) Zoti më krijoi dhe më dha një rast për të shkuar në shkollë që të marr dituri;
- 3) Zoti më dha punë dhe njohuritë për të bërë punën time;

- 4) Zoti më dhuroi makinën që ta përdor për nevojat e përditshme jetësore;
- 5) Zoti më dhuroi një shtëpi dhe në të shtratin e nxehtë;
- 6) Zoti krijoi zogjtë të këndojnë rreth shtëpisë time;
- 7) Zoti më dhuroi një nuse të re dhe të ndershme; Zoti më dhuroi fëmijët e mi sipas dëshirës time;
- 8) Zoti i shpëtoi fëmijët e mi dhe u martuan me shqiptarë;
- 9) Zoti më dhuroi nipër që të gëzojnë zemrën time;
- 10) Zoti më dha shëndet dhe Ai më shpëtoi, sepse unë s'isha duke u kujdesur për shëndetin;
- 11) Zoti më mësoi të dalloj se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe;
- 12) Zoti m'i afroi njerëzit e këqinj me qëllim që ta forcoj karakterin;
- 13) Zoti më dha dashuri dhe më mësojë për të falur mëkatet e të tjerëve;
- 14) Zoti më dha pasuri dhe dëshirë për të ndihmuar të tjerë;
- 15) Zoti më mësoi që s'duhet të kem armë, sepse Ai më mbron nga e keqja;
- 16) Zoti na mbron edhe kur s'jemi të kujdesshëm;
- 17) Zoti më ka treguar rrugën e vërtetë;
- 18) Zoti më ka përgatitur që të mos kem frikë nga vdekja, sepse Ai të dhuron jetë të re;
- 19) Zoti më dhuroi këtë libër për popullin shqiptar dhe më dha fuqi për të kontrolluar veten.

Në fund dua të shtoj se bekimi i Zotit më bën krenar, sepse pa bekimin e Perëndisë jam thjesht një grusht pluhur.

Çdo njeri është krenar, kur njerëzit e tjerë mund t'i shikojë drejt në sy.

Krenaria shqiptare duhet të ketë një karakter të fortë që i pëlqen Perëndisë dhe njerëzve. A jeni njëri prej tyre? Vlera e një njeriu është karakteri i tij: ne duhet të ndihmojmë njëri-tjetrit dhe me i fal mëkatet e tyre. Shqiptarët duhet të jenë të ndryshëm nga kombet e tjera të botës. Shqiptari duhet të jetë një shembull i mirë për të tjerët. Fatkeqësisht, s'është ashtu siç duam ne. Sot një numër i madh i shqiptarëve nuk dallojnë nga njerëzit e tjerë

në botë. Ata kanë një mentalitet: në sjellje dhe në veprime. E shohim pa përjashtim se bota është e prishur dhe çfarëdo që bënë shumica e njerëzve në botë e bëjmë edhe ne, duke i ndjekur të këqijat e kësaj bote.

Është thënë edhe para meje se personaliteti i njeriut fillon të formohet në shtëpi. Prindërit duhet të kalojnë më shumë kohë me fëmijët, për përgatitjen e tyre për jetë. Një gjë duhet ta bëjmë që fëmijëve s'duhet t'i lëmë televizionin, internetin, video lojërat dhe rrugën. Mësojini fëmijët vetë dhe mbajini ata nga djalli, sepse djalli është kudo.

Shumë fëmijë shqiptarë në mërgatë janë duke harruar gjuhën e amtare. E për këtë përgjegjësia më e madhe shkon te prindërit, sepse Perëndia s'gaboï kur na dhuroi gjuhën shqipe. Një gjë s'guxojmë ta harrojmë: me të humbur gjuhën humbasim traditat.

Çfarë duhet të bëjmë që të ruhen doket dhe zakonet shqiptare?

Sot një pjesë e madhe e fëmijëve shqiptarë në dhe të huaj e kalojnë pjesën më të madhe të kohës të mbyllur në shtëpi duke parë televizorin, kompjuterin dhe video lojërat ose duke e humbur kohën në telefon. Këta fëmijë shqiptarë është mirë të kalojnë një pjesë të kohës me të afërmit e tyre dhe të jenë në shoqëri me botën shqiptare. Duke qëndruar me shqiptarë ata do të martohen ndërmjet veti, sepse në atë çast që martohen fëmijët shqiptarë me të huaj do të humbasin duket dhe zakonet e shqiptarit.

Sot në mërgatën shqiptare nënat nuk i mësojnë vajzate tyre se si të bëjnë gatime nga kuzhina shqiptare dhe se si të kujdesen për mbarëvajtjen e shtëpisë. E kur të martohen ndeshën me vështirësitë e jetës shtëpiake. Një fjalë e urtë në gjuhën shqipe thotë: karakteri yt është themeli i jetës sate.

Përse s'ka njeri të përsosur në botë?

Në çdo kohë e në çdo vend bëjmë përpjekje për të gjetur njeriun e përsosur dhe kur s'e gjejmë dot, atëherë mbetemi të zhgënjyer. Në fillim dihet se çifti i parë mbi tokë Adami dhe Eva ishin të përsosur apo, jo. Ata bënë një gabim dhe e humbun bekimin e Zotit. Ndërsa ne s'mund të jemi të përkryer, sepse ne jemi mëkatarë. Pa marrë parasysh se sa i zgjuar mund të jesh, prapëseprapë s'është e mjaftueshme. Me një fjalë, mos u lodhuni duke e kërkuar njeriun e përsosur, sepse s'keni kurrë për ta gjetur. Veçse një gjë duhet ta kemi të qartë: duhet ta pranojmë çdo njeri ashtu siç është dhe t'i lutemi Zotit për të ndryshuar atë, sepse të gjithë ata që shkojnë në qiell, Perëndia i do pa përjashtim.

Le t'i kujtojmë disa të meta në këtë botë:

- a)** Tek shumë njerëz në këtë botë mungon dashuria;
- b)** Bota është duke u shkatërruar nga droga, duhani, kurvëria dhe pijet alkoolike;
- c)** Sot pornografia mbizotëron dhe homoseksualizmi është rritur dhe ka filluar të përkrahet;
- ç)** Sot në botë shumë nga televizionet japin programe që e dëmtojnë rënd shoqërinë;
- d)** Në botë shumë gra e vajza bëjnë abortime dhe shumë burra e prishin martesën;
- dh)** Ndodh shpesh që njerëzit të marrin një sëmundje vdekjeprurëse, sepse sot njerëzit s'kujdesen aq sa duhet për shëndetin e tyre;
- e)** Një e keqe e kësaj bote është ushqimi: në shumë raste është i helmuar;
- ë)** Shumë familje nuk komunikojnë me njëri-tjetrën dhe kjo është një padrejtësi e madhe;
- f)** Bota sot është e prishur nga krimi dhe korrupsioni.

Më në fund mund të them se të gjitha këto që i përmenda më lart janë kundër Perëndisë dhe kjo është një nga arsyet që kërkojmë të mos bëhemi si bota tjetër.

II. DISA ZAKONE E TË META TEK KOMBI SHQIPTAR

Kombi shqiptar ka pasur traditat të mira, veçse pak nga pak është duke i prishur ato. Te shqiptarët edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të mbijetojnë doket pagane. E dihet se paganët janë kundër Zotit. Sot për sot është e domosdoshme që këto doke duhen t'i largojmë me qëllim që të takohemi me Krijuesin tonë.

*Kur i shkojmë shqiptarit në shtëpi,
ndera e madhe është raki.
Atëherë na vjen nikotini,
dhe pastaj kafeini.
Me tanë të zezat ai të bën nder,
e nuk e dinë se në zemër të therr.*

Është e pakuptueshme se si njerëzit janë duke punuar kundër vetvetes. Secili e di që këto gjëra janë të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe prapëseprapë vazhdojmë t'i marrim. Këto janë me një fjalë drogë ligjore. Nëse ne nuk do të marrim ndonjë nga këta, pastaj shpeshherë na detyrojnë për të pirë raki duke thënë: “Pije një raki se s’ të bën keq?” Kur e marrim një teke raki pastaj vazhdojnë: “Pije edhe një se ke ardhur në dy këmbë?” Kur e pijmë të dytën, atëherë për të tretën s’ka nevojë të na nxitë askush, sepse e atë e kërkojmë vetvetiu. Çfarë bëhet më tutje? Pra në këtë gjendje që jemi e marrim makinën dhe vazhdojmë rrugën.

1. *Alkooli*. - “Pse aq kundërshtime kundër pijes?” mund të pyes njeri. “Kush pi, s’i bën të keqe përveç vetes”. - Këtu është lajthimi. Kush pi, i bën mjaft të keqe vetes, por u bën të keqe më të madhe të tjerëve: i bën të keqe kombit duke i dhënë djem të dobët, se djemtë e një pijaneci nuk mund të jenë të shëndoshë. Këtej del si detyrë për të mos pirë nuk është aq e rëndë për të gjithë. Kuptohet se ata që nuk janë për t’u martuar e për të pasur fëmijë, si edhe ata që nisin të pijnë kur kanë fëmijë dhe pastaj, nuk janë nën një barrë aq të madhe sa të rinjtë, të cilët kanë detyrë ta mbajnë shëndetin e tyre me kujdes për të mirën të vetes, të shtëpisë së tyre, të kombit e të shoqërisë. Prandaj - sa do që s’më pëlqen të dukem sikur predikoj - duhet të bëhet edhe ndër shqiptarë një propagandë kundër pirjes alkoolike. Mos pini alkoolin se sasia më e voqël është aq dëmshme për shëndetin tuaj dhe për lidhjen tuaj me Zotin. Alkooli është një helm i cili në trupin tonë kthehet në dioksidkarboni dhe ujë. Pija alkoolike sjellë shumë të këqija: grindje, vrasje, aksidente në rrugë, kancerin, lodhje trupore, shkatërrim të familjes etj.

Në botë ka pasur e do të ketë njerëz që do të punojnë kundër pakësimit të alkoolit. Janë veta që dhanë jetën e tyre në propagandë kundër pirjes. Një propagandë e tillë bëri që në Angli pijanecët të futën në *Listë të Zezë* (Black List) në shekullin e kaluar. *Kjo Listë e Zezë* bëri që pronarët e pijetoreve alkoolike të mos guxojnë të shesin alkool te pijanecët. Rugët e Londrës ishin të mbushur plot e për plot me pijanec gjysmë të vdekur nga të pirët para *Listës së Zezë*.

Është thënë sa e sa herë: alkooli s’është i keq, vetëm duhet me pi me masë. Është më se e vërtetë se sa më pak me pi alkool është më mirë, e aspak do të jetë edhe më mirë. Prej alkoolit s’ka as një të mirë për shëndetin tonë.

Më së miri për pijen shprehet në letërsinë popullore:

- 1) Në krye që hyn pija, del jashtë urtia;
- 2) Trimi i rakisë është turpi i shtëpisë;
- 3) Shtëpia me dy të këqija: duhani dhe rakia;
- 4) Ta pinë rakinë, sa del jashta ta shanë shtëpinë;
- 5) Kush rrinë me gotë n’dorë bëhet hor;
- 6) Më shumë njerëz vdesin nga pija sesa nga shpata.

2. Duhani. - Edhe sasia më e vogël e duhanit është e dëmshme për shëndetin tuaj në marrëdhëniet tuaja me Perëndinë. Duhani ka këto të këqija: shkatërron mushkërit, ndryshon shtypjen e gjakut; e shumon kolesterolin në gjak, ta jepë kancerin, e ngadalëson trurin tonë dhe në fund na bën të lodhur e të rraskapitur. Është thënë para meje se ata që pijnë duhan nuk mbajnë mend mirë. Në duhan janë shumë gjëra të këqija për trupin tonë dhe prej tij vijnë më shumë se 30 sëmundje serioze. Është thënë se duhani ndikon dukshëm në marrëdhënie seksuale dhe ka pasoja për fëmijët që lindin me të meta. Jo vetëm kaq: pirja e duhanit shkurton jetën për të paktën dhjetë vjet dhe sipas zbulimeve shkencore pirja e duhanit e zvogëlon dukshëm inteligjencën e njeriut. E më së miri përcaktohet në *Biblën* e shenjtë: “Shumë të dashur, unë ju këshilloj, si të huaj dhe shtegtarë, të hiqni dorë nga lakmitë e mishit, që luftojnë kundër shpirtit.” (1 e Pjetrit 2:11).

Sipas statistikave thuhet se një nga dhjetë duhan pirësit është me kancer. E dihet botërisht se tridhjetë për qind e të vdekureve nga kanceri janë të lidhura me pirjen e duhanit. Pirja e duhanit dyfishon rrezikun e sulmit në zemër, rrit rrezikun e lindjes së parakohshme dhe ndërlikime të tjera. Është thënë se duhani ka mbi 4.000 kimikate dhe më se tre milion njerëz në botë vdesin çdo vit nga duhani. Kam njohur një njeri që e ka tymosur duhan për së tepërmi dhe u sëmur nga kanceri. E kam parë se si pështynte gjak dhe copa të mushkërive nga goja. Ky njeri pati një fund tragjik: s’mund të durojë dhembjet e mori pistoletën dhe vrau veten. Ky rast më bën që t’iu këshilloj që të mos e pini duhanin dhe gratë të mos bëjnë një gjë të këqillë gjatë shtatzanisë dhe aq më keq nëse i jepë fëmijës gjirin nëna që e pinë duhanin.

3. Droga. - Është fatkeqësi e madhe se një pjesë e rinisë shqiptare marrin drogë. Fillimisht e marrin nga kureshtja për të provuar një gjë të ndaluar. Jo rrallë ndikon shoqëria për të bindur se është e mirë dhe duhet provuar. Droga është tragjedi, e nxituar nga djalli për të shkatërruar njerëzimin.

Si ndikon droga tek të rinjtë?

Të gjithë të rinjtë pa përjashtim fillimisht përdorin drogën në sasi të vogël. E para, kjo sasi e vogël droge në fillim s’është aq e dëmshme, por mbas një kohë ajo nuk punon. E dyta, pastaj trupat e të rinjve janë

në kërkim për një sasi më të madhe. E treta, kur të rinjtë fillojnë me sasi të mëdha, atëherë fillon shkatërimi i shëndetit dhe lodhja e trurit. E katërta, droga është e kushtueshme, të rinjtë që s'kanë mundësi e blejnë atë më të lirën që është vdekjeprurëse. Droga e shkatërron të riun. E bënë të gatshëm që të jetë: hajdut, mashtrues, vrasës dhe jo rrallë edhe vetvrasës.

Askush në botë nga të rinjtë që përdorin drogën nuk janë të kënaqur me atë që bëjnë. Jo rrallë kemi të rinj shqiptarë që vdesin nga droga. Ajo që është më e keq, prindërit shqiptarë, e mbajnë të fshehur. Është mirë për ata prindër që kanë përjetuar tragjedinë e humbjes së fëmijëve të jenë të hapur ndaj të tjerëve. Në këtë mënyrë mund të parandalojnë që të rinjtë shqiptarë të mos marrin drogë. S'është mirë për t'u mbajtur e fshehur.

Ka ardhur koha t'i themi drogës JO! Mos e provoni drogën, sepse po e provuat do ta merrni përsëri. Bëhuni me Perëndinë, sepse duke qenë me zotin, asnjëherë mendja s'të shkon tek droga! Perëndia të ka kujdes!

Simptomat e drogës. - Fëmija që përdor drogë dallohet:

- a).** Pamja e çrregullt;
- b).** Ngathtësia, të qenët i përgjumur, mezi flet;
- c).** Humbje të dukshme në peshë;
- d).** Veshje të çuditëshme: kur është vapë me rroba të gjëra e të gjata, ndërsa në dimër i vënë syzat e diellit që të maskohet me qëllim të mos i duken sytë e skuqur.
- e).** Ndryshime në karakter: gënjen me radhë e pa radhë, mashtron, heqje dorë nga shkollimi etj.
- f).** Ndryshim në sjellje: i padurueshëm, nervoz dhe aq më tepër nuk dihet kur është i gëzuar e kur i pikëlluar. Vuan nga dhembjet në të gjithë trupin. Ka djersitje, ka nervozizëm dhe kështu me radhë.
- j).** Bëhet hajdut: vjedhë para nga shtëpia dhe merrë para hua nga të afërmit dhe nga miqtë.
- k).** Humbja e interesit: asgjë s'e bën për vete dhe ka vetëm një shqetësim se si të marrë para për të blerë drogë. O jetë, o jetë!
- l).** Prindërit duhen të jenë të vetëdijshëm se kush futet në shtëpi, kush thërret në telefon në kohë e pa kohë.

E dimë se Perëndia i dëshiron të rinjtë t'i ketë nënkontroll e, le të shikojmë se çfarë thuhet në *Bibël*: “Gëzohu, pra, o i ri, në rininë tënde, le të gëzohet zemra jote në ditët e rinisë sate; ndiq edhe rrugët e zemrës sate dhe pamjen e syve të tu, por dije që për të gjitha këto gjëra Perëndia do të të thërrasë në gjyq.” (*Predikuesi* 11:9)

Ju lutem i thuani JO drogës!

Zonja dhe Zotërinj, dua të ndaj me ju disa dhëna lidhur me drogën. Përdorimi i drogës në mesin e të rinjve po lulëzon anë e mbanë botës. Përderisa shumë njerëz në fuqi pasurohen duke shitur drogë, të rinjtë tanë po e shkatërrojnë jetën e tyre.

Këtyre ditëve me lehtësi mund të gjejmë hapa kundër dhimbjes nga mjeku apo në treg të zi. Hapat kundër dhimbjes janë drogë e ngjashme me heroinë. Nëse përdor medikamente të tilla mund të bëhesh i varur. Të rinjtë zakonisht fillojnë me drogë të lehtë, sikurse hapat kundër dhimbjes, të cilat drejtojnë kah droga më e fortë, disa të shtrenjta, disa të lira, sintetike dhe droga tjera të ndryshme të rrezikshme. Kokaina, droga sintetike dhe disa droga të tjera janë shumë të rrezikshme dhe vrasin njeriun. Kjo drogë e rrezikshme e lë njeriun me dëme fizike, duke e shkatërruar trurin e tij.

Nga njëherë abuzuesit e drogës bëjnë vetvrasje. Çdo ditë dëgjojmë se si njerëzit vdesin nga abuzimi i drogës. Ne e dimë se shumë persona të famshëm në Holivud (Hollywood) kanë vdekur prej drogës, nga njëherë edhe vetvrasja si rezultat.

Ja 50 arsye pse ti nuk duhet të përdorësh drogën:

1. Nëse je duke u bindur se të përdorësh drogë do të ndihesh më mirë, kjo është thjesht një gënjeshtër dhe ti po mashtrohesh.
2. Herën e parë kur e provon drogën mund të bëhesh i varur prej saj. Nëse bëhesh i varur, atëherë do të jetë shumë e vështirë të ndalesh.
3. Nëse përdor drogën, të gjithë pa përjashtim do ta dallojnë këtë përmes sjelljes tënde, fytyra jote dhe sytë e tu e tragojnë qartësisht.
4. Duke përdorur drogën, i bashkangjitesh nivelit më të ulët të shoqërisë në shumë mënyra të sjelljes.

5. Nëse përdor drogën do ta lëndosh vetën në mënyra të ndryshme.
6. Nëse përdor drogën do të lëndosh të dashurit e tu dhe njerëz e tjerë në mënyra të ndryshme.
7. Nëse përdor drogën do të bëhesh: gënjeshtar, hajdut e mashtgues dhe do të bësh gjithçka për paratë që të blesh drogë.
8. Do të jesh gjithmonë pa para, sepse të gjitha paratë do t'i shpenzosh për drogë.
9. Do ta shkatërrosh shëndetin tënd me drogë e, nëse dëmton shëndetin tënd s'do të mundësh ta kthesh pas.
10. Do të shkatërrosh karakterin tënd në shumë mënyra të ndryshme e, nëse shkatërron karakterin tënd njerëzit do të humbin besimin tek ti.
11. Do ta shkatërrosh të ardhmen tënde në disa mënyra të ndryshme.
12. Nëse përdor drogën, pa asnjë dyshim do ta braktisësh shkollën.
13. Nëse përdor drogën nuk mund të krijosh familje, sepse s'do të mund të kujdesesh as për vetën tënde.
14. Nëse përdor drogën nuk mund të kesh shtëpi, sepse do të jesh gjithmonë pa para.
15. Nuk mund të kesh veturë, sepse do të jesh gjithmonë pa para.
16. Nëse përdor drogën, do të humbasësh lejen e shoferit sepse nuk mund të jesh vozitës i sigurtë dhe do të marrësh dënime trafiku që s'do të kesh mundësi t'i paguash.
17. Nëse nget veturën nën ndikimin e drogës ose alkoolit do të shkaktosh aksidente që mund të vdesësh ose mund të vrasësh dikë. Para disa viteve, një grua ngiste veturën nën ndikimin e drogës, ajo hyri në hyrjen për parkim në drejtim të gabuar dhe shkatoi vdekjen e shtatë personave. Në veturën e saj ishin pesë fëmijë dhe të gjithë vdiqën sa hap e mbyll sytë.
18. Nëse e humbë lejen shoferit, ti do të humbasësh punën, sepse ti nuk mund të shkosh në punë pa veturë.
19. Nëse përdor drogën nuk mund të mbash vetën, sepse do t'i harxhosh të gjitha paratë që ke në drogë.

20. Nëse përdor drogën, prindërit e tu do të nxjerrin jashtë shtëpisë, sepse është e pamundur të jetohet jetë normale me njerëz të droguar.
21. Do të bëhesh i pastrehë
22. Do të bëhesh i pavlerë.
23. Droga do të sjellë shoqëri të keqe.
24. Kur përdor drogën të gjithë miqtë e mirë dhe të afërmit e tu do të largohen.
25. Kur përdor drogën shumë njerëz do të përdorin dhe puna jote nuk do të paguhet mirë.
26. Personi që përdor drogën nuk merakoset për pastërti.
27. Përdoruesit e drogës jetojnë sot për nesër.
28. Përdoruesit e drogës janë shumë të pa organizuar dhe nuk kanë plane për jetën.
29. Droga e shkurton jetën dhe në shumicën e rasteve e merr jetën.
30. Personi që merr drogë nuk pranon kurrë gabimet e veta, por në vazhdimësi fajëson të tjerët.
31. Personi që merr drogë nuk pranon kurrë që merr drogë ose të ketë probleme.
32. Personi që merr drogë mund të infektohet me SST, sepse ka marrëdhënie me prostituta dhe të pastrehë.
33. Personi që merr drogë mund të fitojë shumë sëmundje për shkak të të ushqyerit të keq dhe përdorimit të gjilpërave.
34. Nëse përdor drogë mund t'i shkakëtosh dëme kompanisë ku punon. E humb punën.
35. Shumë njerëz bëhen depresiv dhe me tendenca vetvrasëse për shkak drogës dhe s' kanë jetë.
36. Kur droga pushon së vepruari, do të mbidozohesh dhe kjo do të shkatërroj.
37. Personat që përdorin drogën shpesh shkojnë në rehabilitim për ndihmë të përkohëshme, por shpesh pas kësaj i rikthehen drogës.

38. Nëse përdor drogë, do të humbasësh shëndetin, lumturinë, miqtë dhe familjen.
39. Nevoja e dëshpërimit për para të drogës, do të shëndrrojë në kriminel edhe vrasës.
40. Krimet do të të qojnë në burg.
41. Mund të vritesh prej shpërndarësve të drogës për paratë borxh.
42. Është e turpshme se kë ke mik ose të afërm që abuzon me drogë.
43. Përdorimi i drogës nuk do të të bëjë të lumtur e, as që të ndiehesh mirë. Realisht depresioni vetëm do të përkeqësohet.
44. Janë shumë mënyra për t'u ballafaquar me problemet dhe depresionin. Droga s'është zgjidhje për asgjë.
45. Droga e ndryshon personalitetin tënd, të bën të zemëruar dhe agresiv.
46. Me ndihmën e mjekëve dhe këshilltarëve ti mund ta tejkalosh çështjet tuja në mënyra të shëndetshme.
47. Përfundimisht do të humbasësh lidhjen me Zotin nëse përdorë drogën.
48. Ti meriton të jesh i lumtur dhe i shëndoshë.
49. Dikush të do.
50. Nëse veçmas ke filluar të përdorësh drogën, askush nuk mund të detyrojë të ndalesh. Vendimin duhet ta marrësh vetë: të ndalesh. Për këtë të duhet ndihma e Zotit, prandaj lutu.

Mbaje në mend: Të gjithë ata që përdorin drogë nuk janë të lumtur. Të gjithë kanë probleme. Lumturia vjen nga Zoti, jo droga.

Prandaj, ju lutem djem e vajza dëgjoni prindërit dhe luteni Zotin të ju mbrojë nga kjo drogë e rrezikshme, alkooli, duhani! Këto substanca janë shumë të këqija dhe do të bëhesh i varur. Do ta shkatërrojnë shëndetin dhe jetën.

Ju lutem mbrohuni nga e liga. Vetëm thuani jo drogës! Botës i duhen më shumë njerëz të mirë.

Jeta është e bukur dhe interesante nëse jeton si duhet. Kënaquni me shumë gjëra të mrekullueshme që ka kjo botë dhe që mund t'i ofrojë.

Zoti ju bekoftë të gjithëve!

Ju lutem ndajeni këtë me miqtë tuaj dhe të shpëtojmë rininë tonë!

4. Kafeini. - Mund ta mirrni në kafe, soda, çaj, çokollata dhe në shumë të tjera gjëra që i marrim për çdo ditë. Nga kafeja meshkujt merrin kancerin e prostatit. Është e bërë e njohur se fëmijët që marrin kafeinë nuk mësojnë mirë në shkollë dhe janë të padëgjueshëm në familje. Kafeini i përjashton kalcium në trupin tonë (i prish kockat tona) dhe i përjashton mineralet nga trupi ynë. Kafeini është i rrezikshëm për gratë shtatzëna. Ndodh që gratë të humbasin shtatzëninë e tyre, ose fëmijët lindin me pasoja. Jo vetëm kaq kafeini dëmton zemrën dhe sytë. Kam lexuar se prej kafeve femrave u zbresin gjinjtë, kurse dekafeja është edhe më e rrezikshme, sepse ajo ka kimikate që të sjellin kancerin. Në përfundim mund të themi se kafeja s'i bënë ndonjë të mirë trupit tonë.

5. Mungesat tona. - Sot për sot në këtë botë që jetojmë na mungon dashuria ndërmjet njëri-tjetrit. Kur ne flasim me dikë, në vend për të lëvdur atë, ne kërkojmë për të gjetur atij një gjë të vogël që ta vëjmë në bisht lahute. E kjo mënyrë e të sjellurit na bën të flasim keq për të gjithë dhe gëzohemi për të keqen që i ka ndodhur tjetrit. Jezu Krishti ka thënë: “Dhe, duke qenë se paudhësia do të shumohet, shumëkujt do t’i ftohet dashuria.” (Mateu 24:12). Të mos harrojmë se duhet të mësojmë të flasim mirë për njëri-tjetrin, sepse për secilin kemi diçka të mirë për të thënë. Duke folur për të mirat e shoqërisë i harrojmë veset e këqija që kemi. Në të shenjtën *Bibël* thuhet: “Tashmë fundi i të gjithave u afrua; jini, pra, të përkorë dhe rrini zgjuar për t’iu kushtuar lutjeve dhe të keni para së gjithash një dashuri të madhe për njëri tjetrin, sepse “dashuria do të mbulojë një shumicë mëkatesh.” (1 e Pjetrit 4:7 dhe 8).

6. Urrejtja. - Sot ndër shqiptarë shumë njerëz urrejnë njëri-tjetrin e në vend që t’i dalim në ndihmë për ta rregulluar mirëqenjen ne bëjmë ç’është e mundur që ta ulim sa më poshtë. Urrejtja shkaktohet ndër njerëz vetëm se dikush ka arritur më mirë se i urreyeri.

7. Hakmarrja. - Edhe kjo është një veçori që e ndal hovin e shqiptarit drejt qytetërimit perëndimor. Për shqiptarin s’duhet të ekzistojë hakmarrja. Le të shohim se ç’thuhet në të shenjtën *Bibël*: “Mua më përket hakmarrja dhe shpërblimi; do të vijë koha dhe do t’u merren këmbët! Sepse dita e gjëmës së tyre është e afërt, dhe gjërat e përgatitura për ta shpejtohen të vijnë.” (*Ligji i Përtërirë* 32:35) Siç shihet nga fjalët e Perëndisë hakmarrja është mëkat. Shqiptari për një të grabitur, për fjalë të keqe, e shumë herë pa ditur as vetë për se, merr armët, hidhet, vritet. Pastaj fillon hakmarrja dhe s’ka të ndalur. Pa dyshim, ky është një turp para Zotit dhe para njerzëve. S’është e lejuar nga Zoti për me vra njeriun, sepse ai është krijesë e Zotit e Zoti kujdeset për ne. Shiko se ç’thotë Perëndia: “Kur i shtrini duart tuaja, unë i fsheh sytë e mi nga ju; edhe kur i shumoni lutjet tuaja, unë nuk dëgjoj; duart tuaja janë tërë gjak.” (*Isaia* 1:15). Mos e humbni parajsën për hakmarrje, por duhet ta falëni dhe Perëndia do t’ju falë.

Le të shohim se çfarë thuhet për hakmarrjen në letërsinë popullore:

- a) Hakmarrja është gëzimi i njeriut të keq;
- b) Fuqia e madhe është në atë njeri, i cili mundohet të heshtë edhe kur e di se është i drejtë;
- c) Bëhu i mirë për kojshi, në do gëzim në shtëpi;
- d) Nuk është trim ai që vret, por ai që falë;
- e) Interesohu që armiku yt t’i derdhi lotët e pendimit, që ti të mos e derdhësh gjakun e tij;
- f) Mos u nxit me marrë gjak;
- g) Hakmarrja vjen gëzim një ditë, falja për jetë;
- h) Falja nuk ndryshon të kaluarën, por ajo jep një rast për të ardhmen;
- j) O Zot, më jep durim, se po më dhe forcë i vras të gjithë!

Le të shohim se çfarë thuhet për hakmarrjen nga të huajtë:

- a) I dobëti s’mund të falë. Falja është një virtyt i fortë. (Gandi);
- b) Kafsha është e rrezikshme atëherë kur është e uritur, kurse njeriu kur është i ngopur. (Alia Izetbegović);
- c) Harrimi dhe falja, janë hakmarrja e njeriut të mirë. (Shehiler).

Do të doja të shtoj se gjitha të ligat tona vijnë nga që s'mund të jemi vetëm: lodrat (bixhozi), verërat, gratë, padija, keqthënia, zilia, harrimi i vetes edhe i Perëndisë. Me një fjalë duhet më shumë dashuri dhe Jezu Krishti ka thënë: “Ju keni dëgjuar se qe thënë: “Sy për sy dhe dhëmb për dhëmb.” Por unë po ju them: Mos i rezisto të ligut; madje, në qoftë se dikush të qëllon mbi faqen e djathtë, ktheja dhe tjetrën, dhe në qoftë se dikush do të të nxjerrë në gjyq për të të marrë tunikën, jepi edhe mantelin. Dhe në qoftë se dikush të detyron të ecësh një milje, ti bëji dy me të. Jepi atij që të kërkon, dhe mos refuzo t’i japësh atij që të kërkon hua. Ju keni dëgjuar se qe thënë: “Duaje të afërmin tënd dhe urreje armikun tënd.” Por unë po ju them: “Duani armiq të tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin.” (*Mateu 5:39-44*); - “Mos ia ktheni kurrkujt të keqen me të keqe, kërkonin të bëni të mirën përpara gjithë njerëzve. Po të jetë e mundur dhe aq sa varet prej jush, jetoni në paqe me gjithë njerëzit. Mos u hakmerrni për veten tuaj, o të dashur, por i jepni vend zemërimit të Perëndisë, sepse është shkruar: “Mua më përket hakmarrja, unë kam për të shpëguar, thotë Zoti. Në qoftë se armiku yt, pra, ka uri, jepi të hajë; në pastë etje, jepi të pijë; sepse, duke bërë këtë, do të grumbullosh mbi krye të tij thëngjij të ndezur. Mos u mund nga e keqja, por munde të keqen me të mirën.” (*Romakëve 12:17-21*); - “Tashmë fundi i të gjithave u afrua; jini, pra, të përkorë dhe rrini zgjuar për t’iu kushtuar lutjeve dhe të keni para së gjithash një dashuri të madhe për njeri tjetrin, sepse “dashuria do të mbulojë një shumicë mëkatesh.” Jini mikpritës njëri për tjetrin, pa murmuritje.” (*1 e Pjetrit 4:7-9*); - “Dashuria le të mos jetë me hipokrizi; urreni të keqen dhe ngjituni pas së mirës. Duani njeri tjetrin me dashuri vëllazërore; në nderim tregoni kujdes njeri me tjetrin. Mos u tregoni të përtuar në zell; jini të zjarrtë në frymë, shërbeni Perëndisë, të gëzuar në shpresë, të qëndrueshëm në shtrëngime, këmbëngulës në lutje; ndihmoni për nevojat e shenjtoreve, jini mikpritës. Bekoni ata që ju përndjekin, bekoni dhe mos mallkoni. Gëzohuni me ata që gëzohen, dhe qani me ata që qajnë.” (*Romakëve 12:9-15*).

Vetëm dashuria në njërin anë e falja në anën tjetër e parandalon të keqen. Duhet t’ia falim gabimet njëri-tjetrit. Në qoftë se ju nuk falni armiq të që pendohen, ju duhet të përgjigjeni përpara Perëndisë. Gjithkush në këtë botë e meriton një rast të dytë, apo jo.

Le të shohim se çfarë thuhet në të shenjtën *Bibël*: “Kini kujdes veten

tuaj! Në se yt vëlla mëkaton kundër teje, qortoje; dhe në se pendohet, fale. Edhe sikur të mëkatonte shtatë herë në ditë kundër teje, dhe shtatë herë në ditë do të kthehet te ti duke thënë: “Pendohem,” fale.” (*Luka* 17:3-4); - “Ose, si mund t’i thuash vëllait tënd: “Dale të të heq lëmishten nga syri,” kur ke një tra në syrin tënd?” (*Mateu* 7:4); - “Mos gjykoni dhe nuk do të gjykoheni; mos dënoni dhe nuk do të dënoheni; falni dhe do të jeni të falur.” (*Luka* 6:37); - “Prandaj, o njeri, cilido të jesh ti që e gjykon, je i pafalshëm sepse në këtë që gjykon tjetrin, dënon vetveten, sepse ti që gjykon bën të njëjtat gjëra.” (*Romakëve* 2:1); - “Dhe kur nisni të luteni, nëse keni diçka kundër ndokujt, faleni, që edhe Ati juaj që është në qiejt, t’ju falë mëkatet tuaja. Por në se ju nuk falni, as Ati juaj, që është në qiejt, nuk do t’ju falë mëkatet tuaja.” (*Marku* 11:25-26); - “Kështu, pra, secili nga ne do t’i japë llogari Perëndisë për veten e vet. Prandaj të mos e gjykojmë më njeri tjetrin, por më tepër gjykoni këtë: mos i vini gur pengese ose skandal vëllait.” (*Romakëve* 14:12-13); - “Atëherë Pjetri iu afrua dhe tha: “Zot, në se vëllai im mëkaton kundër meje, sa herë duhet ta fal? Deri shtatë herë?” Jezusi i tha: “Unë nuk të them deri shtatë herë, por deri shtatëdhjetë herë shtatë.” (*Mateu* 18:21-22); - “Vishuni, pra, si të zgjedhur të Perëndisë, shenjtorë dhe të dashur, me dhembshuri të brendshme, mirësinë, përlulësinë, zemërbutësinë dhe me durimin, duke duruar njeri tjetrin dhe duke falur njeri tjetrin, nëqoftëse dikush ankohet kundër një tjetri; dhe sikundër Krishti ju ka falur, ashtu bëni edhe ju.” (*Kolosianëve* 3:12-13).

- 8. Mendjemadhësia.** - Le të shohim se çfarë thuhet në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* për mendjemadhësinë: Që i pëlqen shumë mendja e vet dhe nuk përfill mendimin e të tjerëve, që heq veten për më të ditur se të tjerët; që shet mend.

Kurse në *Bibël* thuhet “Sytë krenarë dhe një zemër kryelartë, që janë llamba e të pabesëve, janë mëkat.” (*Fjalët e urta* 21:4).

Letërisa popullore më së miri e paraqet mendjemadhësinë:

- a) Mendja e madhe fillon me pasuri, e përfundon me vdekje;
- b) Lëvdatat janë fillimi i turpit;
- c) Mendja e madhe është shenjë e pakuptimit;
- ç) Mendja e madhe është më e fortë se turpi;

d) Kush vetin e lëvdon, vetin e çnderon;

dh) Mënyra më e sigurt për t' u bërë i varfër është që të veproni si i pasur.

Në një thënie Çerçilli thoshte: Ai që e do tepër fort veten, është i ndamë prej Zotit e njeriut.

9. Ndarja (Divorci). - Çfarëdo që të thuhet për ndarjen e kurorës është e tepërt, sepse e ka thënë Jezu Krishti shkurt e qartë: Quod Deus coniuxit, homo no separet. Çfarë do thotë: çka zoti ka bashkuar, njeriu të mos e ndajë.

Tek disa shqiptarë po ndodh një gjë për të ardhur keq: martesë me të huaj; martesë pa kurorë dhe të shumtë janë që e shkatërrojnë martesën duke i lënë fëmijët rrugëve të botës.

Në të shenjtën *Bibël* thuhet: “Dhe tha: “Për këtë arsye njeriu do ta lërë babanë dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet; dhe të dy do të jenë një mish i vetëm. Dhe kështu ata nuk janë më dy, por një mish i vetëm; prandaj atë që Perëndia ka bashkuar, njeriu të mos e ndajë.” (*Mateu 19:5-6*); - “Je i lidhur me një grua? Mos kërko të zgjidhesh. Je i zgjidhur nga gruaja? Mos kërko grua.” (*1 e Korintasve 7:27*); - “Kurse të martuarve u urdhëroj, jo unë, por Zoti, që gruaja të mos ndahet nga burri, dhe në qoftë se ndahet, të mbetet e pamartuar, ose të pajtohet me burrin e saj. Dhe burri të mos e lërë gruan.” (*1 e Korintasve 7:10-11*); - “Por ai që kryen një shkelje kurorë me një grua është një njeri pa mend; ai që bën një gjë të tillë shkatërron jetën e tij. Do të gjejë plagë dhe përçmim, dhe turpi i tij nuk do t' i hiqet kurrë.” (*Fjalët e urta 6:32-33*); - “Sepse Zoti, Perëndia i Izraelit, thotë se ai e urren divorcin dhe atë që e mbulon me dhunë rroben e vet, thotë Zoti i ushtrive. Tregoni, pra, kujdes për frymën tuaj dhe mos u sillni me pabesi.” (*Malakia 2:16*).

Tek disa besime fetare pranohet ndarja dhe lejohet martesë me disa gra. E kjo është në kundërshtim me Perëndinë dhe Zoti ka për t' i dënuar këta njerëz të pa cipë.

Do t' i përmendi dy fjalë të urta popullore:

1) Të martohesh s' është aspak e vështirë, e vështirë është të jesh i martuar.

2) Ai që luan me kurorë do të bëhet hor.

*A të kujtohet, mori grua,
para Zotit kur jemi betuar.
Njëri-tjetrit i kemi dhënë dorën,
mos me thye për jetë kurorën.*

- 10. Kurvëria.** - Le të shohim se çfarë thuhet në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* për kurvërinë: Dukuri e shëmtuar kur femrat shesin trupin e tyre për të siguruar mjetet e jetesës.

Le të shohim se çfarë thuhet në *Bibël* për kurvërinë: “Por, ashtu si u ka hije shenjtorëve, as kurvëria, as ndonjë papastërti, as kurnacëri të mos zihet në gojë midis jush.” (*Efesianëve* 5:3); - “Martesa të nderohet nga të gjithë dhe shtrati martesor i papërlyer, sepse Perëndia do të gjykojë kurvarët dhe kurorëshkelësit.” (*Hebrenjve* 13:4); - “Por ai që kryen një shkelje kurore me një grua është një njeri pa mend; ai që bën një gjë të tillë shkatërron jetën e tij. Do të gjejë plagë dhe përçmim, dhe turpi i tij nuk do t’i hiqet kurrë.” (*Fjalët e urta* 6:32-33).

Siç shihet nga fjalët e Zotit kurvëria është mëkat dhe mëkati të dërgon në skëterrë. Mos mendo se e bënë në mënyrë të fshehtë dhe mund të ikësh nga mëkati, por Zotit s’i shpëton dot, ai të shehë. E keqja e kurvërisë është kur ajo futet në martesë, atëherë martesa shkatërrohet pa një pa dy.

- 11. Homoseksualiteti.** - Është një nga të këqijat e kësaj bote, që duhet të parandalohet në shoqërinë shqiptare. Duhet të flitet rreth kësaj epidemie në familje, të kuptohet se çfarë të liga i sjellë njeriut. Fatmirësisht, sot për sot në botën shqiptare është një numër i vogël, por as ky numër s’duhet të ishte.

Le të shohim se çfarë thuhet në *Bibël* rreth kësaj mortaje: “Nuk do të kesh marrëdhënie seksuale me një burrë, ashtu si bëhet me një grua; është një gjë e neveritshme.” (*Levitiku* 18:22); - “Prandaj Perëndia i dorëzoi ata në pasioneve të ulëta, sepse edhe gratë e tyre i shndërruan marrëdhëniet natyrore në atë që është kundër natyrës. Në të njëjtën mënyrë burrat, duke lënë marrëdhëniet e natyrshme me gruan, u ndezën në epshin e tyre për njëri-tjetrin, duke kryer akte të pandershme burra me burra, duke marrë në vetvete shpagimin e duhur për gabimin e tyre. Dhe meqenëse nuk e quajtën me vend të njihnin

Perëndinë, Perëndia i dorëzoi në një mendje të çoroditur, për të bërë gjëra të pahijshme, duke qenë të mbushur plot me çdo padrejtësi, kurvërim, mbrapshtësi, lakmi, ligësi; plot smirë, vrasje, grindje, mashtrim, poshtërsi.” (*Romakëve* 1:26-29); - “Në qoftë se dikush ka marrëdhënie seksuale me një burrë ashtu si ato që bëhen me një grua, që të dy kanë kryer një degjenerim të neveritshëm, do të dënohen pa tjetër me vdekje; gjaku i tyre do të bjerë mbi ta.” (*Levitiku* 20:13).

Ashtu sikurse homoseksualiteti edhe marrëdhëniet seksuale me kafshët janë një mëkat i madh, padyshim, do të përfundojë njeriu në Ferr. As është thënë në librin e shenjtë: “Nuk do të bashkohesh me asnjë kafshë duke u ndotur me të; gjithashtu asnjë grua të mos i afrohet një kafshe për t’u bashkuar me të; është një degjenerim i neveritshëm.” (*Levitiku* 18:23).

- 12. Magjia.** - Le të shohim se çfarë thuhet në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* për magjinë: Tërësi veprimesh, lëvizjesh ose fjalësh e shprehjesh të paktupueshme, të cilat gjoja kanë fuqi të ndikojnë mbi njerëzit e mbi dukuritë e natyrës dhe të bëjnë mrekullira.

Të shohim se çfarë thuhet në *Biblën* e Shenjtë për magjinë: “Të mos gjendet midis teje ndonjë që e kalon birin ose bijën e vet nëpër zjarr, as ndonjë që praktikon shortarinë, bën parashikime, interpreton shenjat dhe merret me magji, as ai që përdor yshtje, as mediume që konsultojnë frymat, as magjistarë, as ai që ndjell të vdekurit, sepse të gjithë ata që merren me këtë punë neveriten nga Zoti; dhe për shkak të kësaj neverie, Zoti është duke i përzënë para teje. Ti do të jesh i përkryer para Zotit, Perëndisë tënd; sepse kombet, që ti do të dëbosh, i kanë dëgjuar shortarët dhe magjistarët; kurse ty, Zoti, Perëndia yt, nuk të ka lejuar të veprosh kështu.” (*Ligji i Përtërirë* 18:10-14).

- 13. Aborti.** - Në mënyrë të qëllimshme ose të pa qëllimet femra bëhet shtatzënë. Pastaj merr një vendim të gabuar dhe vendos të bëjë abort. Nëse Perëndia e formoi fëmijën në barkun tuaj, përse vendosni ta shkatërroni krijesën e Perëndisë. Ta kuptoni një herë e mirë: aborti është krim ligjor, është vrasje, është mbi të gjitha mëkat. Nëse ju nëna shqiptare bëni abort, duhet ta kuptoni se ke bërë vrasjen e fëmijës tuaj.

14. Hajet. - Në jetën e përditshme hahet gjithçka çfarë pëlqehet. Askush nuk shqetësohet për ata çfarë hanë dhe s'do të dijë se çfarë pasoja do të ketë nga ky lloj ushqimi. Në *Bibël* thuhet: “Tani kini kujdes që zemërat tuaja të mos rëndohen nga të llupurit, nga të dehurit dhe nga preokupimet e kësaj jete; që ajo ditë të mos ju zërë në befasi.” (*Luka* 21:34). Në përfundim do të shtoja se njerëzit nga mënyra se si ushqehen duke marrë gjithfarë: pije alkoolike, pije joalkoolike, duhan, drogë e shumë gjëra të tjera e kanë bërë trupin e tyre porsì kosh plehrash. Te gjithë janë të vetëdijshëm për atë që e bëjnë, sepse janë të nxitur nga Satani, kur ai i thotë: “Bëni qejf se një jetë keni!” E këta të gjorë janë të gënjyer nga Satani, sepse ai mashtron duke ia bërë këtë punë për asgjë, me një fjalë ia bënë me dije se në një mënyrë të gjithë do të vdesim nga kjo botë.

15. Ndyshim traditash. - Kombi shqiptar ka ndryshuar traditat. I vëren ndryshimet në fe, në emra, në gjuhë. I ka humbur respekti për prindërit. S'janë të rralla rastet kur prindërit vdesin në vetmi në dhe të huaj. Një gjë duhet ta kenë të qartë se duke i lënë prindërit vetëm edhe ju do të mbeteni në pleqëri fillikat. Prindi i braktisur është mëkat përpara Zotit. Shiko se ç'thuhet në *Bibël*: “Ju bij, binduni prindërve në çdo gjë, sepse kjo është e pranueshme për Zotin.” (*Kolosianëve* 3:20); kurse te *Ligji i Përtërirë* thuhet: “Do të nderosh atin dhe nënën tënde ashtu si të ka urdhëruar Zoti, Perëndia yt, që të jetosh gjatë dhe të gëzosh begatinë në tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep.” Në fund një fjalë e urtë shqipe: Babain e urtë dëgjoje, babain e marrë duroje!

16. Feja. - Populli shqiptar ka disa besime fetare, ca fe të vjetra e ca fe të reja. Prapëseprapë kemi dy llojesh shqiptarësh: të mirët dhe të këqijët. Vlera e një njeriu nuk matet me anë të besimit, por matet me anë të karakterit. Në çdo fe ka njerëz të mirë, por ka edhe njerëz të këqij. Populli shqiptar nuk duhet të jipet shumë pas fesë, duhet t'i përkushtohet kombit, sepse jemi një gjak. Shqiptari ka një gjuhë e një flamur. Duhet të jemi vëllezër të dashur në mes veti. E feja s'ka pse të lidhet me çështjen shqiptare. Feja është vetëm çështje personale e njeriut. Besoj se më së miri e ka thënë Atë Anton Harapi: “Jam fetar, por e dua dhe e çmoj krejt natyrën njerëzore; jam fetar, por kam tagre dhe detyra shoqërore; jam fetar, e nuk rroj as në erë, as

në re, por në këtë tokë që quhet Shqipëri, midis këtyre njerëzve që janë shqiptarët; jam fetar, e dua të mbaj marrëdhënie të ngushta me Zotin, por gjakun shqiptar që më vlon ndër dej, shpirti shqiptar që më frymëzon mendimin dhe fjalën, rrethi shqiptar dhe traditat shqiptare që, duke ma përshkuar anembanë jetën mendore e morale, shpërthejnë ndër hove të shpirtit, ndër ndjenja dhe zakone, mund të zhduken prej meje me sa mund të zhduket natyra; jam fetar, e ky fakt, sikurse nuk më ndalon aspak që të jem një njeri i përkryer, të kemi dituri dhe kulturë, ashtu nuk më pengon që të jem atdhetar.”

III. FAMILJA

Martesa

Martesa është një trinitet: burri, gruaja dhe Perëndia. Nëse njëra prej tyre mungon, atëherë ajo s'është martesë. Para se të martoheni ju duhet të jeni të sigurtë: a është akësecili me Perëndinë, apo është i dhënë pas kënaqësive të kësaj bote. Para se të martoheni ju duhet të konsideroni nëse ju jeni të gatshëm për të marrë barrën e martesës? A jeni të gatshëm për të pranuar përgjegjësinë që ju pret në martesë? A jeni të gatshëm të sakrifikoni veten për familjen? Martesa lidh burrin dhe gruan përgjithmonë. Të mos e ndajë asgjë përpos vdekjes. Ne nuk duhet në asnjë mënyrë të thyejmë besën, të cilën e japim kur vëjmë kurorë.

Përse martohet njeriu?

1. Njeriu martohet që të ketë në jetë një shok të vërtetë. - Perëndia ka thënë: “Pastaj Zoti Perëndi tha: “Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm; unë do t’i bëj një ndihmë që i leverdis.”(*Zanafilla 2:18*) Kurse te Ungjilli sipas Mateut thuhet: “Për këtë arsye njeriu do ta lërë babanë dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet; dhe të dy do të jenë një mish i vetëm. Dhe kështu ata nuk janë më dy, por një mish i vetëm; prandaj atë që Perëndia ka bashkuar, njeriu të mos e ndajë.” (*Mateu 19:5,6*.)
2. Njeriu martohet që të ketë kënaqësi: dashuri, marrëdhënie seksuale.
- Në *Bibël* thuhet: “Qoftë i bekuar burimi yt dhe gëzohu me nusen e

rinisë sate. Drenushë e dashur dhe gazelë hirplotë, sisët e saj le të të kënaqin kurdoherë, dhe qofsh vazhdimisht i dhënë pas dashurisë që ke për të.” (*Fjalët e urta* 5:18, 19). “Burri le të kryejë detyrën martesore ndaj gruas, po ashtu edhe gruaja ndaj burrit. Gruaja nuk ka pushtet mbi trupin e vet, por burri; gjithashtu burri nuk ka pushtet mbi trupin e vet, por gruaja. Mos ia privoni njëri-tjetrit, veç në qoftë se jeni marrë vesh, për një farë kohe, që t’i kushtoheni agjërimit dhe lutjes, dhe përsëri ejani bashkë që të mos ju tundojë Satani për shkak të mungesës së vetkontrollit tuaj.” (*1 e Korintasve* 7:3,4,5)

3. Njeri martohet për të krijuar familje. - Perëndia na bën me fëmijë. Ne duhet të pranojmë atë që na jep Perëndia, qoftë mashkull ose femër, nëse janë të shëndetshëm ose të sëmurë. Perëndia bën çdo gjë për një arësye, kështuqë ne s’duhet të jemi të zemëruar me Perëndinë. Ndoshta Perëndia s’na jep fëmijë?!

Fjalët e urta të Salomonit

“Shtëpia dhe pasuritë janë trashëgimi nga etërit, por një bashkëshorte e mënçur vjen nga Zoti.” (*Fjalët e urta* 19:14)

“Gruaja e urtë ndërton shtëpinë e saj, por budallaqja e shkatërron me duart e veta.” (*Fjalët e urta* 14:1)

“Sepse buzët e gruas që shkel kurorën nxjerrin mjaltë dhe goja e saj është më e butë se vaji; or në fund ajo është e hidhur si pelini, e mprehtë si një shpatë me dypresa. Këmbët e saj zbresin drejt vdekjes, hapat e saj çojnë drejtpërdrejt në Sheol.” (*Fjalët e urta* 5:3-5)

**Para se të japim fjalën për martesë,
ne duhet t’i kushtojmë vëmendje disa gjërave:**

1. Ki kujdes se ju nuk jeni prej të njëjtit gjak, nga ana e babait apo e nënës. Në *Bibël* thuhet: “Asnjë nga ju nuk do t’i afrohet ndonjë të afërmi nga gjaku për të zbuluar lakuriqësinë e tij. Unë jam Zoti.” (*Levitiku* 18:6)
2. Mos e martoni një person të ndarë (divorc), sepse është mëkat. Në *Bibël* thuhet: “Por ai që kryen një shkelje kurore me një grua është një njeri pa mend; ai që bën një gjë të tillë shkatërron jetën e tij. Do të gjejë plagë dhe përçmim, dhe turpi i tij nuk do t’i hiqet kurrë.” (*Fjalët e urta* 6:32-33)

3. Kushtoji vëmendje karkterit. Po qe se personi ka një karakter të dobët, është e pamundur për ta ndryshuar.
4. Personalitet të ndryshme dhe dallime intelektuale. Shijet e ndryeshme dhe kultura e bënë martesën dështuese.
5. Martohu me moshatarë. Dallimi në moshë shkakton mosmarrëveshja dhe aty ka vetëm ndarje.
6. Martohu me të njëjtin besim, sepse mund të ketë përçarje.
7. Pijet alkoolike, duhani, droga dhe veset tjera si bixhoz dhe kurvëria të qojnë drejt ndarjes.
8. Mos u marto me një të papunë, se pastaj aty do të ketë vetëm ndarje!
9. Rregullat e shtëpisë. Shtëpia duhet të ketë vetëm një zot, sepse do të ketë ngatërresa në familje.
10. Mos u marto për pasuri!
11. Kini kujdes me përdorimin e parave! Bota sot është bërë dorështrenguar. Mos huazoni para përpara martesës, sepse do të ketë pasoja në jetën bashkëshortore.
Martesa ka pësuar ndryshime me kalimin e kohës. Është domosdoshmëti ruhen traditat shqiptare, të pyetën prindërit në radhë të parë e, pastaj të vendoset për fatin tuaj.

Virgjëria: Është e domosdoshme të ruhet deri në martesë. Ajo është gjëja më e shenjtë që mund t'i jipet bashkëshortit tuaj.

Le t'i japim ca fjalë të urta:

Dashuria është qorre, martesë t'i hapë sytë. (Grafiti)

Ajo femër që s'kërkon asgjë, ajo meriton gjithçka.

Një burrë i mirë është shpëtimi i gruas, një grua e mirë është shpëtimi i familjes.

Nëse zhveshja e femrave tregon qytetërimin, atëherë kafshët janë më të qytetëruara se ne. (Mehmet Akif Ersoj)

Martesa është si vdekja: pak janë ata që hyjnë në të të përgatitur. (Niccolò Tommaseo)

Hapni sytë tuaj para se të martoheni dhe pastaj t'i mbyllni. (Shekspiri)

Çelësat për martesë të suksesshme

Martesa është shoqatë vullnetare e përjetshme, e burrit dhe gruas! Që të kemi lumturi në martesë, ne duhet të tregojmë dashuri për njëri-tjetrin. Dashuria vjen nga Zoti. Nëse nuk je me Zotin nuk mund të ofrosh dashuri. Martesa nga interesi nuk zgjat shumë.

Le të shohim se çfarë thuhet në Biblë për martesën sipas Mateut 19:5-6 shkruan: “Dhe tha: Për këtë arsye njeriu do ta lërë babanë dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet; dhe të dy do të jenë një mish i vetëm. Dhe kështu ata nuk janë më dy, por një mish i vetëm; prandaj atë që Perëndia ka bashkuar, njeriu të mos e ndajë.”

Si ta shpëtojmë martesën?

Kurrë mos u marto me dikë, vetëm për shkak të bukurisë, pozitës ose pasurisë.

Kushtoi vëmendje: a) Karakterit të tij/saj; b) Dallimeve personale; c) Dallimeve intelektuale; d) Dallimeve shpirtërore; e) Dhënies pas: alkoolit, drogës, kumarës, etj.; f) Suksesit të tij/saj në punë ose jetë; g) Problemeve në familje.

1. Mos u marto me dikë me shpresën se do ta ndryshosh së shpejti, sepse njerëzit nuk ndryshojnë lehtë dhe shpejtë, disa njerëz nuk ndryshojnë kurrë.
2. Nëse vendosë të martohesh me dikënd të atillë, pranoje ashtu siç është njëherë e përjetë! Kurrë nuk do të mund ta ndryshosh dikënd që të bëhet personi që ti do.
3. Bëhu i/e singërtë dhe i/e drejtë me bashkëshorten/tin! Pa sekrete.
4. Nëse je i/e martuar, kurrë nuk do të duhej të mendoje marrdhënien intime me dikë tjetër, pavarësisht bukurisë dhe pasurisë.
5. Martesa jote le të jetë jetëgjatë. Nuk duhet ta mendosh kurrë shkurorezimin. Në Bibël, tek Romakëve 7: 2 dhe 3 shkruan: “sepse gruaja e martuar është e lidhur nga ligji me burrin derisa ai rron, por, po i vdiq burri lirohet nga ligji i burrit. Prandaj, nëse kur i rron burri ajo bashkohet me një burrë tjetër, do të quhet shkelëse e kurores; por kur i

vdes burri ajo është e liruar nga ligji, që të mos jetë shkelëse e kurorës, po u bë gruaja e një burri tjetër.

6. Mirëmbaje intimitetin e vazhdueshëm në martesë. Nëse bashkëshorti nuk mirëmbanë intimitetin dhe afërsinë në martesë, atëherë herët a vonë, kjo shpie tek tradhëtia dhe martesë shkatërrohet dhe vjen deri tek shkurorëzimi. Në Bibël sipas Hebrenjve 13:4, thuhet: “Martesë të nderohet nga të gjithë dhe shtrati martesor i papërlyer, sepse Perëndia do të gjykojë kurvarët dhe kurorëshkelësit.”
7. Bëhu tolerues. - Mos mendo se mund të gjesh person të përsosur. Person i tillë nuk ekziston në këtë tokë! Të gjithë njerëzit në këtë tokë kanë temperament, mendim dhe personalitet të ndryshëm. Kjo është arsya që ne duhet të kemi tolerancë për shumë gjëra. Nëse e do dikë, dëshmoje përmes respektit. Zoti kërkon nga ne të respektojmë bashkëshortin/en sikurse vetvetën, sepse jemi një. Çfarëdo që bëni kundër bashkëshortit/es, bëni kundër vetvetës.
8. Pavarësohu nga prindërit.
9. Asnjëherë mos ngre zërin ndaj të dashurve të tu.
10. Duaje bashkëshortin/en pa kusht.
11. Asnjëherë mos e ofendo të dashurin tënd me fjalë të këqija.
12. Kurrë mos e kritiko bashkëshortin/en tënde.
13. Kurrë mos e kritiko bashkëshortin/en tënde para fëmijëve të tu ose njerëzve të tjerë.
14. Kurrë mos e mallko familjen tënde. Është ves i keq tek njerëzit. Është keq për fëmijët të dëgjojnë, sepse ata mësojnë çfarë dëgjojnë.
15. Lutuni bashkë, sepse kur luteni bashkë dhe qëndroni bashkë.
16. Asnjëherë mos shpenzo para pa pëlqimin e partnerit tënd pavarësisht kush i ka fituar.
17. Mos lejo që bashkëshorti yt të punojë më shumë se ti.
18. Kujdesu për shëndetin tënd dhe të familjes suaj.
19. Bëhu i vëmendshëm për kënaqësitë e llojllojshme: duhani, alkooli, droga etj.

20. Përkujdesu për trupin tënd, sepse do të jesh më i shëndetshëm, do të dukesh më mirë, të ndiehesh më mirë dhe do të jetosh më gjatë. Ha ushqime të shëndetshme dhe kënaqu me jetën tënde.
21. Pastërtia në shtëpi është shumë me rëndësi. Është e rëndësishme për shëndetin dhe mirëqenien tënde.
22. Kurse paranë. Sekret i suksesit është kursimi. Paraja bën paranë.
23. Gjithmonë falë, harro dhe kërko falje.
24. Kurrë mos heq dorë nga familja.
25. Gjithmonë mbaj shpresë në vetën tënde.
26. Zgjidh problemet e martesës në mënyrën më të lehtë. Dëshëm ne apo jo, në jetë ballafaqohemi me probleme të ndryshme. Zgjedhe kohën e duhur që të zgjidhësh problemin, sepse do të shprehesh me ndonjë fjalë të keqe. Një fjalë e keqe sjell shumë fjalë të tjera më të këqija. Rri i qetë nëse do të themelosh paqe në shtëpi. Zgjidh problemet që ke me kohë dhe mos lejo që të grumbullohen. Të zgjidhësh problemin duhet të dëgjosh me kujdes dhe të komunikosh. Kupto se e tërë bota ballafaqohet me probleme të ndryshme.
27. Kurrë mos dil nga shtëpia pa përqaftuar të dashurit e tu. Thuaju se i do pavarësisht sa je i shqetësuar. Nga ti varet lumturia dhe suksesi i martesës tënde.

Zoti ju bekoftë!

Përcaktimi martesës dhe fejesës sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit

M'u martue më kanûn dó me thânë m'u bá shpí, me i a shtue shpís një rob má teper, sá per krah të pûnve, sá per të shtuem të fmive.

Mëndyrët e Martesës:

- a) Martesa me kunorë, e pelqyeme kah Feja e kanuja të Lekës;
- b) Grueja e mbajtne mbikunorë, kundra Fejet e kanujet të Lekës;
- c) Grueja e vajza e grabitme, e jasht-zakonshme kahë Feja e kanuja.
- d) Martesa me provë kundra Fejet e kanujet.

Fejesa

Të ndaluemt e martesës në Kanun.

Në fejesë varzash do të shikjohet:

- a) Të mos të jetë gjak e gjiní;
- b) Të mos të jetë të njëj fisit;
- c) Të mos të jetë mesë fisit të djalit, qi do me e xânë;
- d) Të mos të jetë grueja e lshueme;
- e) Të mos ket kumari.

Bukuria.

Është diçka që tërheq këdo. Pothuajse të rinjtë zakonisht janë në kërkim të bukurisë së një femre se sa karakterit të saj. Është thënë sa e sa herë se një njeri pa karakter është i pa vlerë, pa marrë parasysh se sa i bukur është. Bukuria është ajo që vret.

Le t'i japim ca fjalë të urta:

Çika pa nderë, s'ka vlerë.

Çika pa nderë, si lulja pa erë.

Karakter i mirë kushton më shumë se fytyra e bukur.

Thuhet se mashkulli dashurohet duke shikuar femrën, kurse femra dashurohet duke dëgjuar mashkullin. Për atë punë femrat zbukurohen sa më shumë, kurse mashkujt rrejnë sa më tepër.

Mendimet e La Brujere-it për gratë

Një fytyrë e bukur është më e bukura e të gjitha pamjeve; dhe harmonia më e ëmbël është tingëllimi i zërit të asaj që duam.

Gratë janë të përtëjme: janë më të mira a më të liga se burrat.

Burrat janë shkaku që gratë s'duan njëra-tjetrën.

Mund zemra të qëllohet prej ca bukurish aq të përsosura dhe prej një meritimi aq të shkëlqyer, sa kënaqet t' i shohë njeriu dhe t' i flasë.

Kam njohur qindra gra, të cilat mund t' i bëjë më lehtë të kafshojnë hekur të skuqur se sa të hiqin dorë nga një mendim që kanë zënë në zemërim e sipër.

S'ka gra fare të shëmtuara as fare të bukura.

Mbrojtësia e të dashurave të mërzit; po e vërteta është që lehtësia dhe dobësia e tyre të mërzitit edhe më tepër.

Njerëzit sot në botë s'janë të kënaqur aspak me veten e tyre. Ata s'janë të kënaqur as me pamjen e as me të metat e tyre dhe në fund as me marrëdhinet seksuale. Perëndia i ka bëri tepër të veçantë. Mos harroni se askush në këtë botë s'është sikurse ju. Ju duhet të jeni të kënaqur me atë që Perëndia ju ka dhënë. Ju duhet të pranoni të gjitha të metat tuaja, sepse për të gjitha këto Perëndia duhet të ketë një arsye. Në qoftë se Perëndia krijoi marrëveshjen grua apo burrë duhet të jetë ashtu siç është krijuar. Ju s'duhet të ndryshoni veten, sepse Perëndia ashtu ju ka krijuar. A mos dukeni të lodhur, se pamjen tuaj personale e mundon diçka. Duhet kuptuar një gjë se bukuria nuk është në dukje, por në vetë karakterin e njeriut.

Martohu me moshatar!

Merre bijë një djalë të ri

O moj bijë si re në dashuri,
me një burrë të vjeter dhe të zi.
Si nuk shikove me ata sy,
një djalë të ri ç'është për ty.

O moj bijë ti mos e merr,
atë burrë të ndarë në rrugë për në ferr.
Mos e humb ti këtë rini,
merre bijë një djalë të ri.

O të erdhi dita për t'u martuar,
babë e nënë pa i gëzuar.
E more burrin ti pa kurorë,
si gota e thyme të mbeti në dorë.

O mori bijë si lule të rrita,
këta prej teje s'e prita.
As kënd në botë si ty nuk dua,
pse ti zemrën m'a ke lënduar.

O mori rini unë dua t'i mësoj,
moshatarin duhet ta martoni.
Me moshatarin ju dorë për dore,
si ka thënë Zoti me një kurorë.

Detyrët e burrit ndaj grues

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit burri â' në detyrë:

- a) Me u perkujdesë per veshë e mathë e per gjithshka të lypet per me mbajtë jetën;
- b) Me ruejtë nderën e grues e mos e lânë me u ankue per kurrnji nevojë.

Detyrat e grues ndaj burrit

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit grueja á në detyrë:

- a) Me i a ruejtë nderín burrit.

- b) Me i rroque pá zhibla.
- c) Me i ndêjë nen sundim.
- d) M'u pergjegjë detyrve të kunorës.
- e) Me rritë e me mkambë femín me nderë.
- f) Me i ndejë gadi me të veshmen e të mathmen (kah e qepmja).
- g) Mos me i u perzie në fejesë të të bijve e të të bijave.

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit i zoti i shtëpisë ka tagër:

- 1) Me ndëjë në krye të vendit në shpí të vet, edhe pse gjinden mâ të vjeter se ky në shpí.
- 2) Mbí armët e veta, edhe njiqin qese n' i bâshin; mbí kál të shalës; mbí shtrojë e mblojë të veten; mbí veglat e kafes, e këto sende as kanuja e dahes s'i peshin.
- 3) Mbí fitime të gjindes së shpís, të rrogës a të të falmeve.
- 4) Me blé, me shitë e me ndrrue tokë, si arë, livadhe, râna (ograja), prozhme, rendin e vadës, gjâ të gjalla e rêmet.
- 5) Me dhânë e me mârrë uhá e me hî dorzânë.
- 6) Me ndreqë shpija, ksolla, vithna, etj.
- 7) Me çue në pûnë a në shtek gjinden e shpís.
- 8) Me çue gjinden e shpís per pûntorë uhá a edhe falë.
- 9) Mbí vênë e raki, a me blé a me shitë a me dhânë uhá.
- 10) Me ndeshkue gjinden e shpís, kúr mos të hecin si e lypë e mara e shpís.

Grueja e pa-kunorë

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit aj, qi të mârrë gruen pá kunorë, jet i lidhun kah Feja edhe kah kanûja. Grueja e pá-kunorë farë tagrit s'ká në shpí të burrit. Kanuja i nep këto ndeshkime burrit, qi mërr grue të pá-kunorë:

- a) shpija i digjet e toka i jet djerr.
- b) xieret prej vendit, e s'mund t'a shklasë token e vet mje qi t'a largojë gruen e mbajtime pa- kunorë.
- c) në pasët femí me grue të pá-kunorë, njehen të pá-ligjë e prandej s'mund të bâhen kurr perkaes (trashigues).

Si duhet ta ruajmë martesën?

1. Pranoni njëri-tjetrin ashtu siç jeni! Perëndia ka krijuar çdo njeri të ndryshëm në pamjen dhe karakter.
2. Të jeni të drejtë dhe të ndershëm me njëri-tjetrin. Në *Biblën* e shenjtë thuhet: “Prandaj, duke e lënë mënjane gënjeshtren, secili t’i thotë të vërtetën të afërmit të vet, sepse jemi gjymtyrë, njeri me tjetrin. Zemërohuni dhe mos mëkatoni; dielli të mos perëndojë mbi inatin tuaj; dhe mos i jepni vend djallit.” (*Efesianëve* 4:25-27)
3. Gratë le t’u binden burrave të vet, ashtu sikurse edhe Zotit. - Në *Biblë* thuhet: “Ju, gratë, nënshtrohuni burrave tuaj porsí Zotit, sepse burri është kreu i gruas, sikurse edhe Krishti është kreu i kishës, dhe ai vetë është Shpëtimtari i trupit. Ashtu si kisha i është nënshtruar Krishtit, kështu gratë duhet t’i nënshtrohen burrave të tyre në çdo gjë. Ju, burra, t’i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të.” (*Efesianëve* 5:22-25) - “Ju bashkëshorte, jini të nënshtuara bashkëshortëve tuaj, ashtu si ka hije në Zotin. Ju bashkëshortë, duaini bashkëshortet tuaja dhe mos u bëni të ashpër ndaj tyre.” (*Kolosianëve* 3:18, 19).
4. Respekti njëri-tjetrit në anën e marrëdhënieve seksuale. - Në *Biblën* e shenjtë thuhet: “Burri le të kryejë detyrën martesore ndaj gruas, po ashtu edhe gruaja ndaj burrit. Gruaja nuk ka pushtet mbi trupin e vet, por burri; gjithashtu burri nuk ka pushtet mbi trupin e vet, por gruaja. Mos ia privoni njëri-tjetrit, veç në qoftë se jeni marrë vesh, për një farë kohe, që t’i kushtoheni agjërimit dhe lutjes, dhe përsëri ejani bashkë që të mos ju tundojë Satani për shkak të mungesës së vetkontrollit tuaj.” (1 e *Korintasve* 7:3,4,5)

Kurrënjëherë mos i sjellë problemet tuaja në shtrat. Janë disa gjëra që mund t'i dëmtojnë marrëdhëniet tuaja seksuale: ngatërresat familjare, gjendja financiare, humbja e besimit dhe mosmarrëveshja. Është mirë që të harrohen të gjitha problemet që keni kur të jeni në shtrat. Aty pastaj do të shfaqen padurimi, mungesa e kujdesit ndaj njëri-tjetrit dhe kështu me radhë. Në *Biblën* e shenjtë thuhet: “Zemërohuni dhe mos mëkatoni; dielli të mos perëndojë mbi inatin tuaj; dhe mos i jepni vend djallit. Ai që vidhte, le të mos vjedhë më, por më tepër të mundohet duke bërë ndonjë punë të mirë me duart e veta, që të ketë t’i japë diçka atij që ka nevojë. Asnjë fjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por ajo që është e mirë për ndërtimin, sipas nevojës, që t’u japë hir atyre që dëgjojnë. Dhe mos e trishtoni Frymën e Shenjtë të Perëndisë, me të cilin u vulosët për ditën e shpengimit. Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin.” (*Efesianëve* 4:26-32)

5. Gjeni kohën e duhur për të biseduar për ngatërresat familjare. Fjala nxjerrë fjalën.
6. Mos i grumbulloni problemet. - Ruaje veten nga gabimet e shkuara!
7. Dëgjoni njëri-tjetrin me kujdes! Bisedoni paqësisht. Mos jep përgjigje pa e dëgjuar pyetjen. Mos e ngritni zërin kur keni mosmarrëveshje.
8. Ju duhet të jenë të gatshëm për ta falur njëri-tjetrin dhe ta harroni të keqen. E dimë se e tërë bota është në shqetësime. E dime se bëjmë edhe gabime, por duhet të fëlim. Po nuk falem ne, as Perëndia s’ka për të na falur. Në *Bibël* thuhet: “Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin.” (*Efesianëve* 4:32) “Dhe kur nisni të luteni, nëse keni diçka kundër ndokujt, faleni, që edhe Ati juaj që është në qiejt, t’ju falë mëkatet tuaja.” (*Marku* 11:25)

Fjalë të urta: Është më lehtë të lëndosh dikë dhe t’i thuash “Më falë”. Por është e vështirë të jesh i lënduar nga dikush dhe të thuash “Të falë”.

9. Ju duhet të jetë tolerant! - Është thënë edhe para meje se njerëzit mund të shëmbëllojnë të njëjtë, por prapëseprapë ndryshojnë në sjellje. Prandaj është e vështirë të bësh dikënd sikurse veten tënde.

10. “Të dua”. - Është shprehje që më së shumti duhet ta përdorni. I shkaton kënaqësi. Të përdoret në vend të duhur e, jo kur punët e tjera e tregojnë të kundërtën.

11. Kërkojini Perëndisë t’ju ndihmojë për ta ruajtur martesën. Është mirë të luteni së bashku, sepse është thënë shumë herë se kur luteni së bashku do të jeni gjithmonë bashkarisht. S’është keq të pyesni edhe njerëzit e ndarë: sa herë janë lutuar ata së bashku?

Thonë se një njeri duhet të përgatitet për martesë, ashtu sikurse ushtari që vete në luftë. Të mos harrojmë se djalli është vazhdimisht duke u përpjekur të shkatërrojë martesën tonë. Është lehtë të fajësosh tjetërin, por mendo t’i lutesh Perëndisë për ta dëbuar djallin. Djalli është i fortë dhe pa lutje e keni të vështirë për ta hequr qafe. Një gjë duhet ta kuptoni qartësisht: po qe se s’jeni me Perëndinë është vështirë të kesh paqe në shtëpi dhe aq më keq ka mundësi që të humbasni gjëjen më të shtrenjtë të jetës - familjen. Së fundi do të shtoj se ndarja s’është e ajo që mund të rregullojë prishjen e familjes. Të kini kujdes me ndarjen!

Rinia

Sot për sot pasuria më e madhe e kësaj bote është që të kemi fëmijë, të cilët respektojnë Perëndinë, njerëzit dhe vetveten. Në *Biblën* e shenjtë thuhet: “Mësoji fëmijës rrugën që duhet të ndjekë, dhe ai nuk do të largohet prej saj edhe kur të plakët.” (*Fjalët e urta* 22:6); “Dhe ju, etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj, por i edukoni në disiplinë dhe në këshillë të Zotit.” (*Efesianëve* 6:4). Rini, nëse dëshironi të jenë të lumtur në këtë botë, nëse dëshironi të shkoni në Parajsë, besoj se duhet të kuptoni se çfarë Perëndia kërkon prej jush. E Perëndia ka thanë:

“Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde, me qëllim që ditët e tua të jenë të gjata mbi tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep.” (*Eskodi* 20:12)

“Le të ecim me ndershmëri, si ditën, jo në orgji dhe në dehje, jo në imoralitet dhe sensualizëm, jo në grindje e në smirë. Por vishuni me Zotin Jezu Krisht dhe mos tregoni kujdes për mishin, që t’ia kënaqni lakmitë.” (*Romakëve* 13:13, 14)

“Dhe unë them: Ecni sipas Frymës dhe nuk do ta përmbushni dëshirat e mishit, sepse mishi ka dëshira kundër Frymës, dhe Fryma ka dëshira kundër

mishit; dhe këto janë të kundërta me njëra-tjetrën, që ju të mos bëni ato që dëshironi.”(*Galatasve* 5:16, 17)

“Largohuni nga kurvëria! Çdo mëkat që kryen njeriu është jashtë trupit, po ai që kurvëron mëkaton kundër trupit të vet. A nuk e dini se trupi juaj është tempulli i Frymës së Shenjtë që është në ju, të cilin e keni nga Perëndia, dhe se nuk i përkitni vetvetes?”(1 e *Korintasve* 6:18,19)

“Por, ashtu si u ka hije shenjtorëve, as kurvëria, as ndonjë papastërti, as kurnacëri të mos zihet në gojë midis jush.” (*Efesianëve* 5:3)

“Do të nderosh atin dhe nënën tënde ashtu si të ka urdhëruar Zoti, Perëndia yt, që të jetosh gjatë dhe të gëzosh begatinë në tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep.” (*Ligji i Përtërirë* 5:16)

“Largohu nga pasionet rinore dhe bjeru pas drejtësisë, besimit, dashurisë dhe paqes bashkë me ata që e thërresin në ndihmë Zotin me zemër të pastër. Shmang gjithashtu diskutimet e marra dhe pa mend, duke ditur se shkaktojnë grindje.” (2 e *Timoteut* 2:22, 23)

“Në qoftë se dikush mashtron një vajzë ende të pafejuar dhe bie në shtrat me të, duhet të paguajë për pajën e saj dhe ta marrë për grua. Në qoftë se ati refuzon prerazi t’ia japë, ai do të paguajë shumë e kërkuar për pajën e vajzave të virgjëra.” (*Eksodi* 22:16, 17)

“Asnjë nga ju nuk do t’i afrohet ndonjë të afërmi nga gjaku për të zbuluar lakuriqësinë e tij. Unë jam Zoti.”(*Levitiku* 18:6); “Nuk do të marrin për grua një kurvë, as edhe një grua faqenxirë; nuk do të marrin një grua të ndarë nga burri, sepse janë të shenjtë ndaj Perëndisë së tyre.” (*Levitiku* 21:7).

Sot bota ka mbetur në rininë. Rini, bota është e juaj - thoshte Migjeni i lavdishëm. Sot është e domosdoshme që të rinjtë të mësojnë në shkollë e, kështu do të jenë të përgatitur për jetën. Të jeni të përgatitur për suksesin. Forca juaj qëndron në trurin tuaj. Në fjalë e urtë thotë: ata që shikojnë me sy të besimit, ata shohim më së largu! Rina, për ne, ka vlerë të madhe e, që nuk mund të blihet me para. Të gjitha këto kanë një domethenie që vijnë nga Perëndia: shëndeti, dashuria, shpresa dhe besimi.

Mosha rinore i bënë të rinjtë të provojnë çdogjë. Pikërisht tek ata që ndërpresin shkollimin fillojnë: pirja e duhanit, alkooli dhe më e keqja: droga. Pasojat janë të mëdha: shkatërrojnë shëndetin dhe vdesin të rinj.

Detyra e perlimi i djelmvet

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit:

- a) Bijt jua kan detyrë prindës bindjen e ndigiesen;
- b) Do të rrijn nen sundim të t'et mje qi të desë ky.
- c) S'mund të sjellin doren më 'ta, as m'u rá ndesh fjalësë.
- d) Per çdo punë do të merren vesht me t'anë.
- e) Pá leje të t'et s'mund të shkojn kund.
- f) Pá zamë të t'et s'mund të blejn as s'mund të shesin gjâ, e as farë marrdhaniet s'mund të kenë me kend.
- g) S'munden me hî dorëzânë, posë per aq, sá u bâjn armët e brezit:
- h) S'munden me qitë t'anë më rrugë të madhe edhe pse â'plakë jetos.
- i) Me pretue (me mârre pre), me vjedhë a me vrá kend i biri, i ati do të pergjegjet per arsye qi "Fitimi e rreziku i të bijve i perpjesënohet t'et e vllazenvë".
- j) Me vrá i biri t'anë, fisi a grîn dorërasin ase e xjerrë vendit per gjith herë.
- k) Me i u mbushë mendja ndonjënit nder djelm me u dá prej t'et, del pa pjesë e pá gjâ.

Le t'i japim ca fjalë të urta:

- Nëna e vetë, është dashamiri ma i madh n' jetë.
- Ma të madhin shërbim që mundet të bëjë një baba për fëmijët, pa dyshim, është që t'ia duash nënën fëmijëve. (P. Merime)
- Fëmija është bylbyli i shtëpisë.
- Sa vrima ka shtëpia, aq halle ka fëmija.
- Të këqinj janë ata prindër që harrojnë mëkatet e rinisë. (Balzak)

Në këtë kohë të sotme është bërë vështirë për të rritur fëmijët, sepse ne kemi djallin në shtëpi. Djalli është i mistifikuar përmes: mediasë së shkruar, televizioni dhe video lojërave.

Dashuria dhe miqësia

Sipas La Bryer: Dashuria lindet menjëherë, pa tjetër mendim, nga karakteri a nga dobësia: një pikë bukurie na heq, na mban. Miqësia, për kundër, bëhet pak nga pak, me kohë, me praktikë, me marrëdhënie të gjatë. Sa shpirtomëndje, sa mirësi zemre, sa besë, sa shërbime e sa ëmbëlsi-sielljesh ndër miqtë, për të mbaruar në disa vjet shumë më pak se sa mbaron nga një herë në një çast një e bukur fytyrë a një e bukur dorë!

Koha që shëndosh miqësitë, dobëson dashurinë.

Shohim më shpesh një dashuri të flaktë se një miqësi të përsosur.

Dashuria edhe miqësia përjashtojnë njëra-tjetrën.

Dashuria nis nga dashuria; dhe nga miqësia më e fortë nuk mund të shkosh përveç në një dashuri të dobët.

Dashuria që lindet në një çast, është më e gjatë për të shëruar.

Dashuria që rritet pak nga pak e me shkallë i shëmbëllen tepër miqësisë për të qenë një pësim i zjarhtë.

Njeriu ndjen dashuri të vërtetë vetëm një herë: të parën; dashurit që vijnë pastaj nuk janë aq të pavullnetshme.

Në qoftë se një e shëmtuar arrin të duhet, nuk mund të jetë përveç me një dashuri të pakufijshme: se do të jetë a nga një dobësi e çuditëshme e të dashurit të saj, a nga hirëra më të fshehta e më të pamundëshme sa bukuria.

Sado delikat që në qoftë njeriu në dashuri, fal më shumë faje se në miqësi.

Të rrosh me armiq të sikur një ditë do të bëhen miqtë e tu, e të rrosh me miqtë sikur një ditë mund të të bëhen armiq, nuk është as pas natyrës së smirës, as pas rregullave të miqësisë: nuk është një udhë morale, po politike.

Nuk duhet të bëjmë armiq ata që, të njohur më mirë, mund të hyjnë në radhë të miqve tanë. Miqtë duhen zgjedhur aq të sigurtë e me një cilësi aq të përsosur sa, në qoftë që miqësia merr fund, të mos duan të tepër-përdorin besën që u kemi zënë, as ta japin frikë posi armiq.

Dr. Baron Franc Nopcea kur flet për ushqimet e malësorëve thotë: “Mos t’ish dashuria e zemrës miqësore të cilën më i varfëri malësor sjell më të mirën gjellë që ka për mik, kishte njeriu për të folur keq për hajet e malësorëve, veçse dashuria e zemrës miqësore me të cilën t’a shtron më të mirën gjellë që ka, e më të fundit kafshatë që ka, të bënë me mbyll gojën për çdo të shame”.

Aty ku është dashuria, aty është buzëqeshja, shpresa, besimi, e vërteta, falja e shëndeti. Është thënë se dashuria vjen nga Perëndia. Se dashuria në këtë jetë është Perëndia vetë.

Në *Bibël* thuhet: “Ai që nuk ka dashuri nuk e ka njohur Perëndinë, sepse Perëndia është dashuri.” (1 e *Gjonit* 4:8); “Por unë po ju them: “Duani armiq të tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin.” (*Mateu* 5:44); “Mos ia ktheni kurrkujt të keqen me të keqe, kërkoni të bëni të mirën përpara gjithë njerëzve. Po të jetë e mundur dhe aq sa varet prej jush, jetoni në paqe me gjithë njerëzit. Mos u hakmerrni për veten tuaj, o të dashur, por i jepni vend zemërimit të Perëndisë, sepse është shkruar: Mua më përket hakmarrja, unë kam për të shpëguar, thotë Zoti. Në qoftë se armiku yt, pra, ka uri, jepi të hajë; në pastë etje, jepi të pijë; sepse, duke bërë këtë, do të grumbullosh mbi krye të tij thëngjij të ndezur. Mos u mund nga e keqja, por munde të keqen me të mirën.” (*Romakëve* 12:17-21); “Dhe më në fund jini të gjithë të një mendjeje, të dhembshur, plot dashuri vëllazërore, të mëshirshëm dhe dashamirës, pa e kthyer të keqen me të keqe ose fyerjen me fyerje, po, përkundrazi, bekoni, duke e ditur se për këtë u thirrët, që të trashëgoni bekimin. Sepse kush don ta dojë jetën dhe të shohë ditë të mira, le ta ruajë gojën e tij nga e keqja dhe buzët e tij nga të folurit me mashtrim; të largohet nga e keqja dhe të bëjë të mirën, të kërkojë paqen dhe të ndjekë atë, sepse sytë e Zotit janë mbi të drejtët dhe veshët e tij janë në lutjen e tyre; por fytyra e Zotit është kundër atyre që bëjnë të keqen.” (1 e *Pjetrit* 3:8-12).

Le t’i japim ca fjalë të urta:

- Fuqia e madhe është në atë njeri, i cili mundohet me heshtë edhe kur ka të drejtë.
- Bëhu i mirë për fqinjët, nëse do gëzim në shtëpi.
- Vetëm dashuria e Zotit dhe ajo e nënës fitohet pa mundim e pa merita.
- Çka të mbjellësh, atë do të korrësh.
- Çka i dëshiron vetit, bëja tjetrit.
- Nuk është trim ai që vret, por ai që falë.
- Kush mbjell dashuri, ka për t’u rritur gëzim.
- Siç nuk ndalet zjarri me zjarr, ashtu nuk ndalon e keqja me të keqe.
(Tolstoj)
- Dashuria e vërtetë niset atëherë kur nuk pret gjë për t’u kthyer.
(Antoine de Saint-Exupery)
- Ti mundesh me dhënë edhe padashuri, por nuk mundesh me dashtë pa dhënë.
- Krejt çka të lypet është dashuria. Dashuria është krejt çka të lypet.
(Alfred Lord Tennyson)

- Vetëm hapësira dhe dashuria nuk kanë kufij. (Zelda Fitzgerald)
- Dashuria na ruan prej të keqes. Dashuria s'ka rrena.
Dashuria s'mundet t'fshihet.
- Dashuria e vërtetë falet dhe harrohet lehtë. (Ivo Andric)
- Dashuria është zjarr, po. Vetëm se kurrë nuk dihet a ka me të nxehtë zemrën tuaj, ose ka për të djegur shtëpinë. (Joan Crawford)
- Dashuria e papjekur thotë: Të dua sepse më lypesh. Dashuria e pjekur thotë: Më lypesh sepse të dua. (Erich Fromm)
- Sa më shumë dashuri, aq më pak fjalë.
- Gjuha e dashurisë është në sytë tuaj.
- Njeriu më i lumtur është ai që i bën më njerëzit e tjerë të lumtur.
- Njeriu i gëzuar është si dielli, kudo që shkon ndriçon.
- Nëse lumturia juaj varet nga veprimet e njerëzve të tjerë, atëherë ju me të vërtetë nuk mund të jetë një person i lumtur.
- Shumica e njerëzve vuajnë nga mungesa e bukës dhe dashurisë.
- Është shumë e rëndësishme që të duam të tjerët, por është po aq e rëndësishme për të ndihmuar të tjerët të na duan!
- Dashuria të bën të lumtur si një mbret me kurorë, por të bën dhe të vuash si një lypsar me shkop në dorë.
- Sëmundja më e madhe nga e cila vuan bota sot, është mungesa e dashurisë.
- Ka njerëz që nuk e dinë se si ta tregojnë dashurinë.
- Kur në zemër mungon dashuria, gjithçka tjetër bëhet e parëndësishme.
- Duke qeshur fiton 3 gjëra: mbyt armikun; zgjat jetën tënde dhe zbukurohesh.
- Dashuria është posi lufta: e lehtë për të filluar, por shumë e vështirë për t'u ndaluar.
- Dashuria është një lojë për dy, ku dy prej tyre mund të fitojnë.
- Mos harroni se dashuria mes dy njerëzve duhet të jetë më shumë se sa nevoja për njëri-tjetrin.
- Zemëra është pasuri, që as nuk shitet, as nuk blehet por dhurohet.
- Kur sytë flasin, goja hesht.
Për familjen duhet të kujdesëm derisa të jetojmë. Familjes kurrë s'duhet kthyer kurrizin, sepse është mëkat. Duhesh ta nderosh nusen e djalit, ashtu siç kërkon të nderohet edhe vajza jote.

Dhjetë gjëra për të qenë një baba i mirë

1. Ndero nënën e fëmijëve tu! Fëmijët mësojnë atë që e shohin.
2. Kaloni shumë kohë me fëmijët.
3. Bisedoni me fëmijët, sikur me të rriturit. Edhe kur t'i kritikosh të jesh i kujdesshëm, sepse preket në sedër nga babai.
4. Rriti fëmijët me dashuri.
5. Rrite fëmijën me nder, me besë dhe me ndershmëri.
6. Bëhu mësues i fëmijëve tuaj. Mos e lë këtë punë për dikë tjetër.
7. Është mirë të hani së bashku me familjen, sepse është traditë e shëndetshme për fëmijët.
8. Është mirë t'i lexoni fëmijës, sepse kur të rritet lexon vet!
9. Trego dashuri: përqafoje, ledhatoje, përgëzoje.
10. Puna e atit kurrë s'mbaron. Detyrimi ndaj fëmijës do të jetë i përjetshëm.

Para se të përfundoj këta këshilla për të qenë baba i përsosur, do të doja të shtoja se shpeshherë më ka rastisur të shoh prindër që s'janë të përgatitur për të qenë prindër. Duhet këto lloj prindëresh të edukohen me libra për të qenë prindër si duhet.

Detyrat e nënës

1. Nëna duhet t'i mësojë fëmijëve gjuhën amtare. Le t'i kujtojmë këta vargje të Gjergj Fishtës:

*Prá, mallkue njai bir Shqyptari,
qi ketë gjuhë të Perëndís',
trashigim, që na la i pari,
trashigim s'i a lën ai fmis -
edhé atij i u thaftë, po, goja,
qi e perbuzë ketë gjuhë hyjnore;
qi n'gjuhë t'huej, kúr s'është nevoja,
flet e t'veten e lën mbas dore.*

2. Nëna ka nevojë për t'i mësuar fëmijët të dëgjojnë, sepse kur ata martohen do të kenë shqetësime.
 3. Nëna ka nevojë për t'i mësuar fëmijët për të bërë punët e shtëpisë.
 4. Nëna duhet të edukojë fëmijët që të jenë të respektueshëm.
 5. Nëna ka nevojë për t'i mësuar fëmijët që të mos përdorin kimikate të rrezikshme:
 - a) Kimikatat për pastrimin e shtëpisë, veshmbathjeve;
 - b) Kimikatat e përdorura në ushqim dhe pije;
 - c) Kimikate në parfume dhe kozmetikë.
 6. Është detyrë e nënës t'i mësojë fëmijët që të mos marrin: pije alkoolike, duhan, drogë etj.
- Po që se prindërit kujdesën dukshëm për fëmijët, atëherë do të kemi fëmijë të shkëlqyer. Të mos harrojmë se fëmijët mësojnë atë që shohin, e jo atë që e kanë mësuar. Prindi është shembulli më i mirë për fëmijët. Shkolla e syrit bën të veten.

Nënës dashur

Nëna ime gjithmonë jeton,
në zemër t'ime ajo banon.
S' më lën vetëm askurrë për jet,
për vena të gjakut ajo më flet.

Rueju bir e mos gabo,
rrugës drejt ti gjithmonë shko.
Mos u shmang prej rrugës Zotit,
të jesh krenar, si të parët tu motit.

Nëna është një mrekulli,
i lumi ai që e ka në shtëpi.
E ka dorën shumë të but,
E fjala e saj askurrë s'tutt.

Rueje Nënë por si Zotin,
mos e ba për me lëshua lotin.
Rueje Nënë si sytë e vet,
Se ke me lyp ni bësh me tret.

Nëna të do ty pa kondita,
për ty çuem e zen drita.
Për ty jeta nuk i dhimbet,
t'i plotëson tanë premtimet.

Veç një Nënë e ke në botë,
mos lyp tjera se e ke kotë.
Dashurinë e nënës vet,
s'ke me gjet ni bësh me tret.

O, ta dish Nënë, sa të dua,
më ke përkund duke këndua.
Gjini yt më ka dhënë fuqi,
e fjalhtë e tua, shumë dashuri.

Për ty Nënë kam shumë me shkrua,
vetëm po të thom shumë të dua.
Kurrë për jetë unë s'të harroj,
si me ke mësua, unë do të jetoj.

Faliminderit o Nënë drita,
s'ta paç të shoqen ka shëtita.
Nuk paç në kënin aq dashuri,
sa ke pas ti, për ne fëmi.

Ca këshillë për prindërit

1. Të dy prindërit duhet të flasin njëzëri, kur është fjala për fëmijët. Duhet të mbështetni njëri-tjetrin.
2. Mos bëni dallime.
3. Fëmijët duhet të ndiejnë dashuri në shtëpi. Rritni fëmijët pa zhurmë, pa shamatë.
4. Të kini kujdes për të hollat. Mos harxhoni para për makina luksoze? S’duhet t’i jepni shumë para fëmijëve, sepse kur ata i fitojnë paratë atëherë i çmojnë.
5. Prindërit s’duhet gjithmonë t’i sulmojnë fëmijët.
6. Lavdëroni fëmijët edhe kur ata nuk e meritojnë.
7. Ju nuk keni nevojë për të rrahur fëmijën, por ata duhet të dënohen në ndonjë mënyrë tjetër. Ndaloni fëmijëve atë që u pëlqen. Nëse ju jeni i vrazhdë me fëmijën edhe fëmija do të jetë i këtillë.
8. Kur i premtan fëmijës, duhet të mbash premtimin.
9. Mësoni fëmijët si t’u ushqehen me ushqime të shëndetshme.
10. Fëmijët kanë nevojë të flenë çdo natë në të njëjtën kohë.
11. Fëmijët s’duhet të kenë shoqëri të madhe dhe s’duhet të flenë në shtëpinë e tjetrit.
12. Shpjegoni fëmijës se sa e rëndësishme është shkolla.
13. Rralloja fëmijëve shikimin e televizionit. Më shumë lexim dhe argëtim.
14. Luteni Zotit për të ndihmuar në ruajtjen e fëmijëve, sepse ata lehtë mund të humbasin.

Shpeshherë ndodh që të jemi të shpejtë për të gjetur njerëzve gabimet dhe mangësitë dhe t’i kritikojmë, por nuk e shikojmë vetveten. Shumë lehtë mund ta lëndosh zemrën e dikujt, e tepër gjatë ajo zemër e lënduar merr kohë për t’u shëruar. Fjala e bukur s’kushton shumë, por mbahet mend përgjithmonë.

Në *Bibël* thuhet: “Ose, si mund t’i thuash vëllait tënd: “Vëlla, më lër të të heq lëmishtën që ke në syrin tend”, kur ti vetë nuk e sheh

traun në syrin tënd? O hipokrit, nxirre më parë traun nga syri yt dhe atëherë do të mund të shohësh mirë për të nxjerrë lëmishtën nga syri i vëllait tënd.” (Luka 6:42) ; “Kush kontrollon gojën e tij mbron jetën e vet, por ai që i hap shumë buzët e tij shkon drejt shkatërrimit.” (Fjalët e urta 13:3); “Asnjë fjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por ajo që është e mirë për ndërtimin, sipas nevojës, që t’u japë hir atyre që dëgjojnë. Dhe mos e trishtoni Frymën e Shenjtë të Perëndisë, me të cilin u vulosët për ditën e shpengimit. Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin.” (Efesianëve 4:29-32); “Edhe gjuha është një zjarr, një botë paudhësie; ajo është vendosur midis gjymtyrëve tona, gjuha e fëlliq gjithë trupin, ndez ecjen e natyrës dhe ndizet nga Gehena.” (Jakobi 3:6); “Por, ashtu si u ka hije shenjtorëve, as kurvëria, as ndonjë papastërti, as kurnacëri të mos zihet në gojë midis jush. As pandershmëri, as të folur pa mend e të përqeshur, të cilat nuk kanë hije, por më tepër të ketë falenderime.” (Efesianëve 5:3, 4).

Tragjedia është e madhe për kombin shqiptar, kur fëmijët dëgjojnë pleqtë në shtëpi të shajnë e të malkojnë. A ecën kështu përpara kombi shqiptar? Në një rast dhe në një vend kam dëgjuar fëmijën shqiptar që mallkonte t’ëmën. E di se e ka dëgjuar t’atin, kur ai mallkonte bashkëshorten e tij. S’është e mirë kur fëmijët dëgjojnë sharjet dhe mallkimet në shtëpi. Disa herë më ka rastisur të dëgjoj nga njerëzit kur thonë: a s’dëgjojnë ata nga të tjerët? S’ka gjë, le të dëgjojë nga të tjerët, por ama jo të dëgjojnë në familje. Më thuani, a është njësoi sikur ta dëgjojnë në rrugë e sikur ta dëgjojnë në shtëpi? Jo. Në shtëpi formohet karakteri i fëmijës. A nuk thuhet në *Biblën* e shenjtë: “Dhe, duke qenë se paudhësia do të shumëhohet, shumëkujt do t’i ftohet dashuria; por ai që do të ngulmojë deri në fund do të shpëtohet.” (Mateu 24:12, 13)

Mësohu me fal!

O more zemër mos m'u zemëro,
gabova unë por, ti mos gabo.
Mos m'a bë jetën m'a të vështirë,
me dashuri, shpirt, është më mirë.

O more shpirt, mësoju me falë,
mos e bë të madhe kot një fjalë.
Askush në botë s'është pa gabime,
shpëtimi jonë është me durime.

O more lulje mos m'u zemëro,
ni ke dashuri, ti pak duro.
E dinë se jetën e jap për ty,
për ty s'më dhimbset çka shoh me sy.

O more zemër, mos m'u zemëro,
eja te vet, e më përqafo.
Fjala e keqe i sjellë ca të tjera,
pa dashuri jetës i tretë vlera.

O moj zemër, mësoj këta fëmijë,
të kalojnë jetën me dashuri.
Të lutëm ruaje, gojen për ditë,
çka dëgjojnë fëmija, kanë me dijtë.

O more shpirt, mos m'u zemëro,
familjen tonë na e shpëto.
Do të jetojmë jetën me lumturi,
parajsë është, paqja në shtëpi.

IV. SHOQËRIA

Shoqëria mundet ta çojë njeriun deri në qiell ose ta rrëzojë përdhe, do me thënë ta shkatërrojë krejtësisht. Shoqëria, po ashtu mundet ta bëjë njeriun të mirë ose të bëjë të keq, me një fjalë ta bëjë horr.

Le t'i japim më poshtë ca fjalë të urta:

- Kush rrinë me ujë, mësohet të ulërijë.
- Në katundin e të marrëve, i urti është i çmendur.
- Shoqërohu vetëm me ata që kanë për të bërë të mira.
- Mos ec para të mençurit, por as pas budallit.
- I mirë është, po qe se s'e krymb shoqëria.
- Me kë të shkosh, ashtu dhe je.
- Kushdo që do ta përmirësojë shoqërinë duhet të fillojë së pari nga vetvetja.

Babai dhe djali

Këtë ndodhi e kam të treguar nga im atë:

Një ditë i biri i thotë të atit se kam shumë shokë, kurse ti ke vetëm një. “Në rregull” - i thotë babai - “thirri gjithë shokët e tu kurse unë po e thërras timin. Të shohim se kush ka miq më të mirë.” Të nesërmen shtëpia u mbush plot e përplot me miq. Bisedat vazhdonin pa skaj. Vjen një çast që duhet të provohet miqësia. Ngritet babai e thotë: “Im bir dhe

unë kemi një hall të madh: kemi një të vdekur të fshehur në tavan. O sot o kurrë: kemi shumë nevojë për ndihmën tuaj. Na ndihmoni ta varrosim diku”. Me të dëgjuar miqtë e djalit një nga një u larguan. Mbeti vetëm miku i babait. Ai në një çast pyeti: “kur do ta varrosim të vdekurin?” Babai iu drejtua të birit: “e shikon se çfarë është miqësia e vërtetë.” Me një fjalë kjo të kujton një shprehje italiane që thotë: mik i kujtdo, mik i askujt. Më së miri e thotë Aristoteli: të gjithë miq, askush mik. Kurse Gray thotë: kush është mirë me të gjithë nuk ka miq (The favourite has no friends).

Ç’thonë mendimtarët për miqësinë:

Ato që do njëri t’i dojë dhe tjetri, dhe ato që nuk do njëri as tjetri të mos i dojë, asaj vetëm i thonë miqësi e shëndoshë

(SALLUSTIUS)

Miqtë e ditës së sotme janë posi pjepëra; duhet të shprovosh pesëdhjetë gjersa të gjesh një të mirë.

(CLAUDE MERMET)

Kam miq që më duan, miq të cilët s’më peshojnë fare, edhe miq që më kanë smirë.

(CHAMFORT)

Ruhamëni nga miqtë e mi, ruhem vetë nga armiqtë.

(VILLARS)

S’ka gjë më të përhapur se ky emër (emëri *miqësi*), s’ka gjë më të rrallë se puna (d. m. th. miqësia e vërtetë).

(LA FONTAINE)

Më e larta marrëveshje që mund të bëjmë me mikun tonë është, - Le të jetë vërtetësia në mes tonë për gjithënjë.

(EMERSON)

Më të shumtë miq janë vetëm me buzë.

(SHAKESPEARE)

E vetmja udhë për të pasur një mik, është të jesh mik.

(EMERSON)

V. NJERËZIT: PRISHËSIT E BOTËS

Sot njerëzit po prishin tokën dhe banorët e saj. Sot njerëzit e pasur kanë një pushtet në të cilën askush tjetër nuk mund të marrë një copë. Në të kaluarën kemi pasur koloni e diktatorë që i kemi ditur, kurse sot ne jetojmë në një kohë të re. E në këtë kohë që jetojmë: kemi koloni moderne me diktatorë të fshehur. Bota do të jetë e qetë vetëm atëherë kur të gjithë diktatorët ikin nga pushtetin.

Botën sot e kontrollojnë njerëzit e fuqishëm në disa aspekte:

- 1. USHQIMI.** - Bujqësia dhe fabrikat bëjnë përgatitjen e ushqimit me shumë kimikate. Qëllimi i tyre është të duken sa më mirë për syrin dhe të qëndrojnë një kohë të gjatë që të mos prishen. Sasi të mëdha të ushqimit janë të përpunuara në alkool. Këta njerëz të fuqishëm nuk kujdesen për botën e uritur.
- 2. PIJA.** - Pija është përbërë prej shumë kimikateve si për shembull: sheqer, kripë, alkool, etj. Ujin që kemi blerë s'është i pastër mjaftueshëm.
- 3. KARAKTERI.** - Njerëzit e fuqishëm të botës janë duke përdorur si ushqim, shkollë, TV, internet, telefon, video-lojëra e shumëçka

tjetër, me qëllim që të kontrollojnë njerëzimin. E dihet se të gjitha këto gjëra e bllokojnë trurin rinisë. Kjo është arsyeja pse rinia e sotme është mjaft e varfër në shumë pikëpamje. Këta pasanikë të sotëm e prishin karakterin e të rinjve për një qëllim të caktuar, vetëm për t'i bërë të rinjtë më të dëgjueshëm domethënë për t'i mbikqyrur. Kjo është dhe një nga arsyet pse ne duhet të punojmë me fëmijët sa më shumë që të jetë e mundur.

4. LIRIA. - Sot ne jemi të gjithë pa përjashtim në duart e atyre që nuk e kanë Zotin në shpirt. Së shpejti ne do t'i humbasim të drejtat e njeriut në mbarë botën. E di se nuk do të lejojnë të mbrojmë të drejtat tona dhe nuk do të lejojnë për t'i shërbyer Zotit, Perëndisë. Bota është në luftëra të vazhdueshme.

5. SHËNDETI. - Njeriu ka prodhuar kimikate të rrezikshme që gjenden kudo në botë, po ashtu edhe në ushqim. Njerëzit e pasur janë duke punuar për të zvogëluar popullsinë e botës. Ata prodhojnë bakterjet që sjellin sëmundje në mbarë botën. Jo vetëm kaq, por prodhojnë edhe barna me drogë. Këta njerëz të pasur nuk janë të interesuar për të gjetur një shërim për kancerin.

6. NATYRA. - Njerëzit kanë gjetur energjinë atomike që të shkatërrojnë tokën. Çdo gjë është helmuar në këtë tokë. Kjo ndodhë që shumë fëmijë ta marrin kancerin, e disa të lindin me pasoja.

7. FITIMI. - Në botë ka vetëm dy klasa të njerëzve: një pakicë që ka tepër pasuri përrallore, ndërsa pjesa dërmuese në një varfëri të skajshme.

Në përfundim të këtij kapitulli do të citoj një autor të panjohur që thotë: bota është e uritur, jo sepse ne nuk mund t'i ushqejmë skamnorët, por sepse ne nuk mund t'i ngopim të pasurit.

VI. TRURI I NJERIUT

Truri i njerëzve është një sistem që unë mendoj se vetëm Zoti mund ta krijojë. Njeriu është krijesa e vetme intelektuale në këtë planet. Kafshët e kanë trurin por s'e kanë mendjen. Truri ekziston për të kontrolluar trupin tonë. Kur mëkati mbretëron mbi ne, atëherë trupi ynë kontrollon trurin tonë. Truri është një gjë që mund të zhvillohet pafundësisht. Është njohur botërisht nga ekspertët, të cilët e kanë pranuar një zëri se një njeri normal përdor vetëm 2-3% të kapacitetit të trurit të tij. Nëse një pjesë e trupit të njeriut nuk do të përdoret, padyshim do të shtrembërohet e do të bëhet i papërdorshëm, ashtu sikurse edhe truri ynë kur s'përdoret doemos do të çformohet. Për këtë arsye ne i shohim shpesh njerëzit që nuk mund ta kontrollojnë veten. Sot shumica e njerëzve në rruzullin tokësor e përdorin trurin pak ose aspak, sepse kompjuterat janë mbizotërues, kurse në anën tjetër një pakicë të pasurish janë vërtet të lumtur, sepse ata mundin fare lehtë të kontrollojnë njerëzimin.

Si mund ta zhvillojmë trurin tonë?

1. Prindërit duhet t'i mësojnë fëmijët, deria janë të vegjël, sepse kur të rriten është tepër vonë. Thuhet se karakteri i fëmijës krijohet derisa është shtatë vjeç.
2. Fëmijët duhet t'i ushqejmë: me pakëz mish, me prodhime të qumështit dhe më tepër fruta e perime.
3. Mos helmoni fëmijët duke ia lejuar duhanin, alkoolin, sodat, kafën

dhe më të keqën drogën. Të gjitha këto që i përmenda më lart janë të dëmshme për trurin e fëmijëve.

4. Të pini më shumë ujë, sepse truri ka në përbërje rreth 85% ujë.
5. Ruani fëmijët që të mos hanë tepër mish dhe djathë, sepse është thënë se kanë vështirësi të mbajnë mend. E kjo, pa dyshim është pra arsyeja pse ata nuk janë mirë në mësim.
6. Fëmijët ashtu edhe të rriturit kanë nevojë për ajër të pastër. Oksigjeni është i nevojshëm në gjakun tonë.
7. Për të qenë truri në rregull, patjetër duhet të kemi një gjak të pastër.
8. Të rrini me njerëz të zgjuar.
9. Të mësoni në gabimet e të tjerëve.
10. Të lexoni sa më shumë libra të dobishëm për njerëzimin.
11. Të mos harrojmë se kemi nevojë të jemi me Perëndinë, sepse dituria vjen nga Perëndia.

Urtësia

Nuk mundesh të jesh i urtë vetëm se ti mendon se je i urtë. Vetëm me punën që bën mund ta vërtetosh se vërtet je i tillë. Sot në botë ekzistojnë dy lloje njerëzish: disa janë duke bërë atë që ata e dinë, kurse të tjerët e dinë se çfarë ata po bëjnë. Njerëzit e mëdhenj flasin për ide e mendime të mëdha. Kurse shumica e njerëzve sot mirren për gjëra të kota: përgojime, shpifje.

Le të shohim se çfarë është shpifja për njerëzit e mëdhenj:

Shpifni, shpifni! Diç ka për të mbetur gjithnjë nga shpifja.

(BEAUMARCHAIS, Barbier de Séville)

Nga të shpifurit me guxim gjithnjë diç' ngjitet'. (BACON)

Të shpifurave më e mira përgjigjie është heshtja. (BEN JONSON)

Njerëzit që përhapin dhe ata që dëgjojnë të shpifura, sikur të pëlqej mendja ime, të gjithë duhej të vareshin, shpifarakët nga gjuha,

dëgjonjësit nga veshët. (PLAUTUS, Pseudolus, I. 5).

Duhet të shpifurave t'u vëmë veshin ngadalë. (PUBLIUS SYRUS)

Ji aq i kthjelltë sa akulli, aq i kulluar as bora, nuk ke për të shpëtuar nga shpifja. (SHAKESPEARE)

Si mund t'i njohim njerëzit e zgjuar:

- a) është i mençur dhe i arsimuar;
- b) mëson vazhdimisht, sepse mendon se nuk është mjaft i zgjuar;
- c) s'flet shumë dhe flet me zë të ulët;
- ç) s'poshtëron askënd dhe nuk shan kënd;
- d) s'është përtac, s'është xheloz përndryshe është bamirës;
- e) s'ndërhyn në fjalët askujt;
- ë) nuk ngutet në përgjigjie dhe nuk flet për gjëra të kota;
- f) e pranon të vërtetën dhe e çmon atë ç'është më i mençur; së fundi kujdeset për shëndetin dhe është me Perëndinë.

Dituria vjen nga Perëndia

Është thënë se njeriu më i ditur i botës ishte Salomoni. Ai i bindej atit dhe Krijuesit të tij. Ja çfarë thotë i ati, Davidi: “Biri im, mos harro mësimet e mia dhe zemra jote le të ruajë urdhërimet e mia, sepse do të të shtohen ditë të gjata, vite jete dhe paqeje. Mirësia dhe e vërteta mos të lënçin kurrë; lidhi rreth qafës, shkruaji mbi tabelën e zemrës sate; do të gjeshtë kështu hir dhe arsye në sytë e Perëndisë dhe të njerëzve. Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në gjykimin tënd; pranoje në të gjitha rrugët e tua, dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua. Mos e mbaj veten të ditur në sytë e tu, ki frikë nga Zoti dhe hiq dorë nga e keqja; kjo do të jetë shërim për nervat e tua dhe freskim për kockat e tua. Ndero Zotin me pasurinë tënde dhe me prodhimet e para të çdo të ardhure që ke; hambarët e tu të grurit do të jenë plot e përplot dhe vozat e tua do të gufojnë me musht.

Biri im, mos e përçmo ndëshkimin e Zotit dhe mos urre qortimin e tij,

sepse Zoti qorton atë që do, si një baba djalit që atij i pëlqen. Lum ai njeri që ka gjetur diturinë dhe njeriu që ka përfutur arsyen. Sepse fitimi i tij është më i mirë se fitimi i argjendit dhe fryti i tij vlen më tepër se ari i kulluar. Ajo është më e çmuar se perlat dhe se mbarë gjërat më të këndshme nuk mund të barazohen me të. Gjatësia e jetës është në të djathtë të saj, pasuria dhe lavdia në të majtë të saj. Rrugët e saj janë rrugë të kënaqshme dhe në të tërë shtigjet e saj mbretëron paqja. Ajo është një dru i jetës për ata që e kapin dhe lum ata që mbahen fort atje. Me diturinë Zoti krijoi tokën dhe me zgjuarësinë i bëri të qëndrueshëm qiejtë. Me diturinë e tij u hapën humnerat dhe retë japin vesë. Biri im, këto gjëra mos u largofshin kurrë nga sytë e tu. Mbaje diturinë dhe të menduarit. Ato do të jenë jetë për shpirtin tënd dhe një zbukurim në qafën tënde. Atëherë do të ecësh i sigurt në rrugën tënde dhe këmba jote nuk do të pengohet. Kur do të biesh për të fjetur, nuk do të kesh frikë; po, do të biesh dhe gjumi yt do të jetë i ëmbël. Nuk do të druash llahtarën e papritur, as shkatërrimin e të pabesëve kur do të ndodhë, sepse Zoti do të jetë pranë teje dhe do të pengojë që këmba jote të kapet në ndonjë lak.

Mos i refuzo të mirën atij që i takon, kur e ke në dorë ta bësh. Mos i thuaj të afërmit tënd: “Shko dhe kthehu; do të të jap nesër,” kur e ke me vete gjënë e nevojshme. Mos kurdis asnjë të keqe kundër të afërmit tënd, ndërsa ai banon me besim bashkë me ty. Mos bëj padi kundër askujt pa shkak; po të jetë se nuk të ka bërë asnjë të keqe. Mos ki zili njeriun e dhunshëm dhe mos zgjidh asnjë nga rrugët e tij, sepse Zoti e neverit njeriun e çoroditur, por këshilla e tij është për njerëzit e ndershëm. Mallkimi i Zotit është në shtëpinë e të pabesit, por ai bekon banesën e të drejtëve. Me siguri ai tallët me tallësit, por i fal të përvuajturit. Njerëzit e urtë do të trashëgojnë lavdinë, por poshtërsia do të jetë trashëgimia e atyre që nuk kanë mend.” (*Fjalët e urta*, Kapitulli 3).

“Duke iu afuar Davidit dita e vdekjes, ai urdhëroi të birin Salomon, duke i thënë: “Unë jam duke shkuar atje ku shkojnë tërë banorët e tokës; prandaj tregohu i fortë dhe sillu si burrë! Respekto urdhrat e Zotit, Perëndisë tënd, duke ecur në rrugët e tij, duke zbatuar në praktikë statutet e tij, urdhërimet e tij, dekretet e tij dhe porositë e tij, ashtu siç është shkruar në ligjin e Moisiut, me qëllim që ti t’ia dalësh mbanë në të gjitha gjërat që do të bësh dhe nga çdo anë që të kthehesh, me qëllim që Zoti ta plotësojë premtimin që më ka bërë kur tha: “Në qoftë se bijtë e tu do të kujdesen për të ecur para meje me të vërtetë me gjithë zemër e me gjithë shpirt, nuk do të mungojë

kurrë dikush mbi fronin e Izraelit.” (1 i Mbretërve 2:1-4)

Salomoni i lutet Zotit: “Jepi, pra, shërbëtorit tënd një zemër të zgjuar, në mënyrë që të administrojë drejtësinë për popullin tënd dhe të dallojë të mirën nga e keqja. Kush në fakt mund të administrojë drejtësinë për popullin tënd kaq të madh?” Në rast se ti ecën në rrugët e mia duke iu bindur statutet dhe urdhërimet e mia, ashtu si bëri Davidi, ati yt, unë kam për t’i zgjatur ditët e tua.” (1 i Mbretërve 3:9-14)

Të gjithë ne mund të jemi të zgjuar me ndihmën e Perëndisë: “Frika e Zotit është fillimi i njohjes; por njerëzit e pamend përçmojnë diturinë dhe arsimin.” (*Fjalte e urta* 1:7); “Sepse Zoti jep diturinë; nga goja e tij rrjedhin njohuria dhe arsyeja.” (*Fjalte e urta* 2:6) ; “Nuk ka as dituri, as zgjuarësi dhe as këshillë kundër Zotit.” (*Fjalte e urta* 21:30); “Njerëzit e këqij nuk e kuptojnë drejtësinë, por ata që e kërkojnë Zotin kuptojnë çdo gjë.” (*Fjalte e urta* 28:5)

Le t’i japim ca fjalë të urta:

- Ende s’ kam takuar njeri, prej të cilit s’ mund të mësohet diçka. (Autor i panjohur)
- Sa më pak të dijë njeriu, aq më e madhe i duket dija e tij. (Zh. Ruso)
- Njeri i urtë jo se nuk flet marrina, por as që i dëgjon.
- Në u zënshtin dy vetë, i urti tërhiqet.
- Njerëzit e urtë mësojnë prej budallenjve më shumë se sa budallenjtë prej të urtëve.
- Më së shumti gabon ai që e mban vetin për të urtë.
- Heshtja është më e madhja urti.
- Kur kishin me shitë mendë, seicili kishte me i ble të vetat.
- I dijshtmi është më i madh se kryetari i shtetit, se kur vdes ai s’ka kush ta zëvendësojë.
- Më kollaj është me qenë i dijshtëm për të tjetër se sa për veti.
- I urti të marrin duhet ta durojë.
- Rreziku më i madh është, kur ta kujtosh veten për të urtë.

VII. SHËNDETI

Shëndeti juaj është në duart tuaja. Ne kemi marrë shëndetin dhuratë nga Perëndia dhe kjo është arsyeja pse ne nuk jemi të kujdesshëm.

Tetë hapa për shëndetin e mirë:

- 1. Rrezet e diellit.** - Trupi i njeriut s'mund të jetë i shëndetshëm pa diell. Rrezet e diellit depërtojnë thellë në lëkurën tonë dhe na ndihmojnë shumë. Koha më e mirë për të qenë në diell është: në verë nga 8:30 në mëngjes kurse në dimër nga ora 10:00. Rrezet e diellit i shkatërrojnë bakterjet, veçse duhet të jemi të kujdesshëm me rrezet e diellit, sepse ne mund të merrim kancerin e lëkurës.
- 2. Ajri i pastër.** - Të mos harrojmë se pa ajër të pastër ne s'mund të jemi të shëndetshëm. Oksigjeni është shumë i nevojshëm për gjakun tonë, trurin dhe nervat. Shumë herë njerëzit rrinë të mbyllur në dhoma të nxehta ku ajri është i thatë, pa oksigjen, pra për arsye ata janë të sëmurë. Është mirë të pini ujë gjatë natës, por edhe në mëngjes, sepse shumë njerëz të cilët kanë pasur sulm në zemër, gjithmonë ka ndodhur në agim. Kur ju jeni jashtë në ajër të pastër, të mësoni për të sjellë ajër nëpërmjet hundës dhe për ta nxjerrë atë nëpërmjet gojës, sepse për çudi qimet në hundë e kanë filtruar ajrin. Nëse ju jeni duke shtuar një ajër të ftohtë nëpërmjet gojës, mos harroni se ju jeni duke shtuar të fëlliqurat, bakteriet dhe të ftohtit, që pa dyshim do të sjellë sëmundjën. Ajri duhet të ketë lagështinë 30-65%. Është e domosdoshme të hapen shpeshherë dyert dhe dritaret për të hyrë në çdo dhomë të shtëpisë

oksigjeni. Mos pini duhan në shtëpi! Mos hapni dyert apo dritaret gjatë kohës së gatimit!

3. *Përmbaju-pa teprim.* - Mos e teproni me ushqim, me punë, me internet, me televizion, me të ngasje makinës gjatë natës dhe disa gjëra të tjera që na shkaktojnë stres. Duhani, alkooli dhe droga, na marrin paqen, shëndetin dhe jetën. Jepni fëmijëve një shembull të mirë, duke e ruajtur veten nga veset e liga. Të gjithë ata fëmijë që besojnë Perëndinë vështirë se marrin duhan, pije alkoolike dhe drogë.
4. *Pushimi.* - Ne kemi nevojë fizike dhe mendore për të pushuar. Ne kemi nevojë për të fjetur 7-9 orë gjatë natës. Kjo është shumë e rëndësishme që të shkoni në shtrat para ores 10 në mbrëmje. Të flini një ditë të tërë s'është e shëndetshme.
5. *Lëvizjet.* - Ne kemi nevojë për ushtrime, të ecim në ajër të pastër, të ngasim biçikletën, të notojmë. Të gjitha këto ndihmojnë të heqim trashësinë, stresin dhe të forcojmë sistemin imunitar.
6. *Ushqimi i mirë.* - Të blesh ushqim të shtrenjtë nuk do të thotë se është i mirë. Ju duhet të hani më pak ose aspak mish dhe produkte të qumështit. Hani më shumë perime, fruta, dhe gjëra të tjera natyrore. Hani në mëngjes, sepse në qoftë se ju nuk hani mirë në mëngjes, ju nuk mund të jeni të shëndetshme. Një vakt të mirë në mëngjes, ju bën të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm në punë. Është thënë se fëmijët që ushqehen në mëngjes, ata mësojnë më mirë sesa fëmijët që s'kanë ngrënë mëngjes. Në mëngjes ju mund të hani në qoftë se ju nuk hani në mbrëmje vonë. Hani tri herë në ditë. Mos hani ndërmjet mëngjes, drekës dhe darkës, sepse trupi ynë ka nevojë për të pushuar. Mos hani 3 deri 5 orë para se të shkoni në shtrat. Mos hani natën vonë, sepse ushqimi është i gatuar në bark gjithë natës, veçanërisht nëse ju hani shumë mish dhe në mëngjes ju do të jenë të rraskapitur. Kafeja, ëmbëlsira dhe alkooli janë tepër të dëmshme për ne në mëngjes. Mos bëni përzjerje në perime dhe fruta të njëjta, sepse disa prej tyre e urrejnë njëra-tjetrën dhe për këtë arsye ata prodhojnë helm, pra ky është shkaku pse barku shkakton dhembje. Mos pini shumë pije: të nxehta ose të ftohta. Mos pini, kur jeni duke ngrënë. Mos harroni të pini 15 minuta para se të hani, ose më herët se dy orë para ngrënies.

Në të shenjtën *Bibël* sipas *Levetikut* 11, Perëndia ka thënë se çka është e pastër dhe çfarë s'është: "Pastaj Zoti i foli Moisiut dhe Aaronit, duke u thënë atyre: "Foluni bijve të Izraelit dhe u thoni: Këto janë kafshët që do të mund të hani nga tërë kafshët që janë mbi tokë. Mund të hani çdo kafshë dythundrake që e ka këmbën të ndarë dhe ripërtypet. Por nga ripërtypësit dhe nga dythundrakët nuk do të hani këto: devenë sepse përtypet, por nuk është dythundrake; për ju është e papastër; baldosën, sepse ripërtypet, por nuk është dythundrake; për ju është e papastër; lepurin, sepse ripërtypet, por nuk është dythundrak; për ju është i papastër; derrin, sepse është dythundrak dhe e ka këmbën të ndarë, por nuk është ripërtypës; për ju është i papastër.

Nuk do të hani nga mishi i tyre dhe nuk do të prekni trupat e tyre të pajetë; për ju janë të papastër. Midis gjithë kafshëve që ndodhen në ujë mund të hani këto: mund të hani të gjithë ato që kanë pendë e luspa në ujë, si në dete ashtu dhe në lumenj. Por të gjitha ato që nuk kanë as pendë as luspa, si në dete, ashtu dhe në lumenj, tërë ato që lëviznin në ujë dhe të gjitha ato që jetojnë në ujë janë të neveritshme për ju. Do të jenë të neveritshme për ju; nuk do të hani mishin e tyre dhe do keni neveri për trupin e tyre të pajetë. Çdo gjë që në ujë nuk ka pendë dhe luspa do të jetë e neveritshme për ju.

Midis zogjve do të keni neveri këta; nuk duhet t'i hani, sepse janë të neveritshëm: shqiponjën, shqiponjën e detit dhe fajkuan peshkatar; qiftin dhe çdo lloj fajkoi; çdo lloj korbi; strucin, hutën, pulëbardhën dhe çdo lloj krahathatë; bufin, karabullakun e detit, ibisin; mjellmën, pelikanin, hutën; lejlekun, çdo lloj çafke, pupëzen dhe lakuriqin e natës. Do të keni neveri për çdo insekt me krahë që ecën me katër këmbë. Por nga të gjitha insektet me krahë që ecin me katër këmbë, mund të hani ato që i kanë kofshët mbi këmbët për të kërcyer në tokë.

Nga këta mund të hani çdo lloj karkaleci, çdo lloj bulku dhe çdo lloj akridi. Çdo lloj tjetër insekti me krahë që ka katër këmbë do të jetë i neveritshëm për ju. Këto kafshë do t'ju bëjnë të papastër; kushdo që prek trupin e tyre të pajetë do të jetë i papastër deri në mbrëmje. Kushdo mbart trupat e tyre të pajetë, do të lajë rrobat dhe do të jetë i papastër deri në mbrëmje. Çdo kafshë dythundrake që nuk e ka këmbën të ndarë dhe nuk ripërtypet është e papastër për ju; kushdo që do ta prekë do të bëhet i papastër.

Ndër të gjitha kafshët katërkëmbëshe, ata që ecin mbi shputën e

këmbëve janë të papastër për ju; kushdo që prek trupin e tyre të pajetë do të jetë i papastër deri në mbrëmje. Kushdo që transporton trupin e tyre të pajetë do të lajë rrobat e tij dhe do të jetë i papastër deri në mbrëmje. Për ju ata janë të papastër. Ndër kafshët që zvarriten mbi tokë, këta janë të papastër për ju: urithi, miu dhe çdo lloj hardhje, gekoja, varani, hardhuca, kërmilli dhe kameleoni. Këto kafshë midis tërë atyre që zvarriten janë të papastra për ju; kushdo që i prek kur kanë ngordhur, do të jetë i papastër deri në mbrëmje.

Çdo gjë mbi të cilën një prej tyre bie kur kanë ngordhur do të jetë e papastër; qoftë kjo një vegël prej druri, apo rroba, apo lëkurë, apo thes apo çfarëdo sendi tjetër i përdorur për punë, duhet të futet në ujë dhe do të jetë i papastër deri në mbrëmje; pastaj do të jetë i pastër. Çdo enë prej argjile brenda të cilës një prej tyre bie, do ta thyeni; dhe gjithçka që ndodhet në të do të jetë i papastër. Çdo ushqim që hahet mbi të cilin bie uji i kësaj ene do të bëhet i papastër; dhe çdo gllënjë që mund të merret prej tij do të jetë e papastër. Çdo gjë mbi të cilën bie një pjesë e trupit të tyre të ngordhur, qoftë furra apo furnela, do të copëtohet; ata janë të papastër dhe do të konsiderohen të papastër nga ana juaj. Por një burim apo një çisternë, ku mblidhet uji do të jetë i pastër, por çdo gjë që prek trupat e tyre të pajetë do të jetë e papastër. Dhe në rast se një pjesë e trupave të tyre të pajetë bie mbi çfarëdo lloj fare që të mbillet, kjo do të mbetet e pastër; por në rast se vihet uji mbi farën dhe një pjesë e trupave të pajetë të tyre bie mbi të, ajo është e papastër për ju. Në rast se ngordh një kafshë që ju lejohet ta hani, ai që do të prekë trupin e pajetë të saj do të jetë i papastër deri në mbrëmje.

Ai që ha nga ky trup i ngordhur do të lajë rrobat e tij dhe do të jetë i papastër deri në mbrëmje; po kështu ai që transporton këtë trup të ngordhur do të lajë rrobat e tij dhe do të jetë i papastër deri në mbrëmje. Çdo gjë që hiqet zvarrë mbi tokë është një gjë e neveritshme; nuk duhet ta hani.

Ndër të gjitha kafshët që hiqen zvarrë mbi tokë, nuk do të hani asnjërin prej atyre që ecin mbi bark, që lëvizin me katër këmbë, ose të atyre që kanë shumë këmbë, sepse kjo është e neveritshme. Mos u bëni të neveritshëm me asnjë nga këto kafshë që zvarriten; mos u bëni të papastër me to, në mënyrë që të ndoteni. Sepse unë jam Zoti, Perëndia juaj; shenjtërohuni, pra, dhe jini të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë; mos u infektoni me asnjë prej këtyre kafshëve që zvarriten mbi tokë. Sepse

unë jam Zoti që ju bëri të dilni nga vendi i Egjiptit, për të qënë Perëndia juaj; jini pra të shenjtë sepse unë jam i shenjtë.

Ky është ligji përkatës i katërkëmbëshve, zogjve dhe i çdo qenieje të gjallë që lëviz në ujë, dhe i çdo qenieje që hiqet zvarrë mbi tokë, me qëllim që të dini të dalloni midis asaj që është e pastër dhe asaj që është e papastër, dhe midis kafshës që mund të hahet dhe të asaj që nuk duhet të hahet.”

Kujdesuni për veten!

Perëndia ka dhënë për të ngrënë mish dhe peshk në një kohë kur s’ka pasur ushqime bimore. Sot ne kemi mjaft ushqimeve bimore, drithërat, frutat, perimet etj. Duhet të shmangni mishit dhe produkteve të qumështit, për shkak se ushqimi bimor është shumë më i mirë, sepse ai nuk sjellë sëmundje. Të mos harrojmë se fermerët bëjnë vaksinimin e kafshëve, ata japin shumë sëmundje dhe ushqim të helmuar. Dikush hanë për të jetuar kurse disa jetojnë për të ngrënë. Nëse ju hani si duhet, ju do të dukeni më të rinj, do të ndjeheni më mirë dhe natyrisht do të jetoni më gjatë.

7. Ujë. - Çdo person duhet të pijë 6-8 gota ujë në ditë. Mesatarja është rreth 2 litra, varësisht nga madhësia e trupit. Pa ujë të mjaftueshëm gjaku s’mund të lëviz normalisht. Në trupin tonë kemi ujë 60%. Truri është 85% ujë, e gjaku është 90% ujë. Uji mbart minerale në trupin tonë, dhe këta e pastrojnë atë. Vetëm mos të harrojmë se nuk është e mirë ta teprojmë duke pirë shumë ujë, se pastaj do të hedhim jashtë mineralet. Kur ne nuk pijmë ujë të mjaftueshëm, ne dukemi të lodhur, dukemi si të fjetur, sepse truri ynë s’është duke punuar si duhet dhe pastaj kemi dhembje koke. Një gjë është tepër e rëndësishme për trupin: duhet të lahem çdo mëngjes, sepse do të jemi më të shëndetshëm dhe aq më tepër në dimër s’do të ndjejmë të ftohtë.

8. Besimi në Perëndinë. - Kur të jeni me Perëndinë, zoti të mban ty. Lutuni Perëndisë çdo mëngjes dhe falenderoni për çdo natë. Perëndia ka thënë: “Por para së gjithash kërkonti mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto gjëra do t’ju shtohen.” (Mateu 6:33); - “Lëshoni klithma gëzimi Perëndisë, ju të gjithë banorë të tokës; i këndonim himne lavdisë së emrit të tij; bëjeni zulmëmadh lëvdimin e tij. I thoni Perëndisë: “Sa të tmerrshme janë veprat e tua! Për shkak të madhësisë së fuqisë sate armiqtë e tu do të të nënshtrohen ty. Tërë toka do të të adhurojë

dhe do të këndojë për ty, do të këndojë lëvdimet e emrit tënd. Ejani dhe admironi atë që Perëndia ka bërë; ai është i tmerrshëm në veprat tija për bijtë e njerëzve.” (*Psalmi* 66:1-5); - “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju? Në qoftë se dikush e prish tempullin e Perëndisë, Perëndia do ta prishë atë, sepse tempulli i Perëndisë, i cili jeni ju, është i shenjtë.” (1 e *Korintasve* 3:16, 17); - “Pra, nëse hani, nëse pini, nëse bëni ndonjë gjë tjetër, të gjitha t’i bëni për lavdinë e Perëndisë.” (1 e *Korintasve* 10:31)

Një fjalë e urtë thotë: shëndeti është pasuria më e madhe dhe tejkalon çdo pasuri tjetër, në mënyrë që një lypës i shëndoshë, me të vërtetë është më i pasur se një mbret i sëmurë.

Të mos harrojmë: duhet ta ruajmë shëndetin, që të kemi një jetë të gjatë dhe të lumtur. Po që se jemi me Perëndinë e kemi të premtuar një gjë të këtyllë.

Në *Bibël* sipas *Eskodit* 23:25 thuhet: “Shërbejini Zotit, Perëndisë tuaj, ai do të bekojë bukën tënde dhe ujin tënd; dhe unë do të largoj sëmundjen nga ti” kurse *po aty* 15:26 thuhet: “Dhe tha: “Në qoftë se ti dëgjon me vëmendje zërin e Zotit, Perëndisë tënd, dhe bën atë që është e drejtë në sytë e tij dhe dëgjon urdhërimet e tij dhe respekton tërë ligjet e tij, unë nuk do të jap asnjë nga ato sëmundje që u kam dhënë Egjiptasve, sepse unë jam Zoti që të shëron.”

Fjalë të urta popullore:

- Kur iku shëndeti, atëherë ju kujtu lezeti.
 - Nëse e do veten, duhet ruajtur shëndeti.
 - Njeriu i shëndosh i ka njëqind dëshira, kurse i sëmuri vetëm një: si të shërohet.
 - Kush ka shëndet e, kush ka besim në Zot, ai i ka më të madhën pasuri e gëzim.
 - Barku me barrna si këmisha me harrna.
 - Ha si thiu, fuqinë si miu.
 - Kur e bënë vetë, mos thuaj çka më gjeti.
- Lypësi është në të vërtetë i lumtur, sikurse një mbret i sëmurë.

(Arthur Schopenhauer)

Në fund do të shtoj se nëse nuk e ruani shëndetin, nuk do të keni një jetë të lumtur, aq më keq s’do të jetoni gjatë.



Si do të duket, ardhjen e dytë Jezu Krishtit?

A mendoni se Perëndia ka caktuar një ditë kur ju do të vdisni?

Te shumë njerëz mendohet se kur ata kanë lindur, Perëndia e ka caktuar edhe ditën se kur ata do të vdesin. *Bibla* na mëson ndryshe. Zoti ynë dëshiron që ne të jemi të shëndetshëm, të kemi një jetë të gjatë dhe natyrisht të jemi të lumtur.

Le të shohim se çfarë thuhet në *Biblën* e shenjtë: “Frika e Zotit i zgjat ditët, por vitet e të pabesit do të shkurtohen.” (*Fjalët e urta* 10:27); - “Mos ji tepër i keq dhe mos u trego budalla. Pse kërkon të vdesësh para kohës sate?” (*Predikuesi* 7:17); - “A nuk konsiston vallë në ndarjen e bukës sate me atë që ka uri, në sjelljen në shtëpinë tënde të të varfërit pa strehë, në të veshurit e atij që është lakuriq, pa lënë pas dore ata që janë nga gjaku yt? Atëherë drita jote do të shpërthejë si agimi dhe shërimi yt do të mbijë menjëherë, drejtësia jote do të të pararendë dhe lavdia e Zotit do të jetë preparoja jote.” (*Isaia* 58:7-8); - “Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde, me qëllim që ditët e tua të jenë të gjata mbi tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep.” (*Eskodi* 20:12); - “Shërbejini Zotit, Perëndisë tuaj, ai do të bekojë bukën tënde dhe ujin tënd; dhe unë do të largoj sëmundjen nga ti.” (*Eskodi* 23:25); - “Dhe tha: “Në qoftë se ti dëgjon me vëmendje zërin e Zotit, Perëndisë tënd, dhe bën atë që është e drejtë në sytë e tij dhe dëgjon urdhërimet e tij dhe respekton tërë ligjet e tij, unë nuk do të jap asnjë nga ato sëmundje që u kam dhënë Egjiptasve, sepse unë jam Zoti që të shëron.” (*Eskodi* 15:26)

Pa tjetër, ne një ditë do të vdesim, por ne shohim që Perëndia dëshiron që ne të kemi një jetë të gjatë dhe të lumtur. Kjo do të thotë se lumturia jonë është në duart tona. Ajo varet nga ne, nëse ne do të jemi me Zotin ose me djallin. Perëndia e zgjat jetën tonë, kurse djalli e shkurtton.

VIII. STRESI

Më pak stres!

Koha në të cilën jetojmë e, që jetojmë në kohë moderne, padyshim është kohë tepër e stresuar. Çfarë është stresi? Stresi është reagimi i nervave tona me artikuj të padëshiruar. Stresi është pengesë e jashtëzakonshme e trupit tonë. Po ashtu është shkaktar i disa sëmundjeve. Bota sot jeton në një garë sikurse të ishte dita e fundit e jetës. Është më se e vërtetë se njerëzit nuk kanë aspak kohë të mjaftueshme për familjen. Kjo do të thojë është një nga arësyet kryesore pse ata nuk janë të lumtur në jetë, sepse mund të arrihet në përfundim se ata janë plot me mëkat dhe stres. Një shprehje gjermane thotë: “Cili është qëllimi i të vrapuarit, nëse jemi në rrugë të gabuar.” Është thënë se nga dhjetë njerëz të sëmurë, nëntë prej tyre kanë fituar sëmundjen nga stresi.

Disa nga shkaqet e stresit që ndikojnë në trupin tonë:

- a)** stresi shkakton dhembje koke, marramendje, ankth, zemërim, nervozizëm dhe panik;
- b)** stresi shkakton dhembjen e dhëmbve;
- c)** stresi shkakton sulm në zemër, diabet etj.;
- d)** stresi shkakton problem në jashtëqitje, dhembje barku;
- e)** stresi zvogëlon dëshirën për marrëdhënie seksuale;
- ë)** stresi shkakton problem në mirësjellje, probleme në sistemin imunitar, mungesë energjie, depresion dhe paranojë.

Si duhet ta zvogëlojmë stresin?

Disa nga shkaqet e zvogëlimit të stresit:

- 1)** duhet ta kemi të qartë se jeta e njeriut është përplot shqetësime;
- 2)** ta fillojmë ditën mbarë;
- 3)** të hamë mëngjes;
- 4)** ta kontrollojë truri trupin e jo anasjelltas;
- 5)** bëje planin e punës ditore;
- 6)** të jeni të përpiktë në orarë (sepse pastaj do të vraponi për t
ë mos qenë vonë);
- 7)** mos harroni të bëni punën mirë, me qëllim që të mos kthehesh
përsëri në të njëjtën punë;
- 8)** mos mendo: ta përfundosh krejt punën në një ditë;
- 9)** mos huazoni dhe mos shpenzoni më shumë se keni fituar;
- 10)** është mirë të kurseni 10% të asaj që keni fituar;
- 11)** mos mendoni shumë për veten: për bukurinë, rrobat,
makinat, pasurinë;
- 12)** shkoni në shtrat në kohë;
- 13)** mos sjellni problemet në shtrat;
- 14)** ki kujdes shëndetin: mos merrni duhan, pije alkoolike, drogë,
soda etj.
- 15)** mos u bëni xheloz;
- 16)** pushoni mjaftueshëm e mos mendoni shumë për të nesërmen;
- 17)** mos u bëni miq me njerëz të krisur;
- 18)** mos u zemëroni, sepse zemërimi shkakton shqetësime te
të dashurit tuaj;
- 19)** mos poshtëro askënd;
- 20)** ndihmo nevojtarët (a është thënë se dora që jep është
gjithmonë e lartë);
- 21)** kini besim, dashuri, shpresë dhe pranoni gabimet tuaja;
- 22)** bisedo me njerëzit qetësisht e kurrë mos e ndërpre kur ai është
duke folur;
- 23)** çështja s'është të fitosh betejën, por është që të kuptosh gjendjen;

24) mos u gëzo të keqes, por s’duhet t’i gëzohesh as të mirës;

25) duhesh t’i kujtosh gjërat e mira që t’i harrosh të këqijat dhe së fundi mos u zemëro me vdekjen në familje, sepse këto janë punët e Perëndisë.

Nëse ne kemi në mendjen tonë Zotin dhe jetën e re, shqetësimet e kësaj bota s’kanë pse të na hidhërojnë. A është thënë sa e sa herë se hidhërimi e dëmton shëndetin e, ne s’duhet të humbasim shpresën.

Le t’i shënojmë ca fjalë të urta:

Kur ditë është pa qeshje, padyshim është ditë e humbur;

Buza me gaz, shëndeti pa masë.

Vetëm shpresa është forca që na mban në jetë. Ajo vjen tek ne nga Krijuesi ynë. Njerëzit që humbasin shpresën, fitojnë sëmundje, vrasin veten. E kur jemi të lidhur ngushtë me Perëndinë, ne kurrë s’do të humbasim shpresën. A s’është thënë: ai që ka shëndet ka edhe shpresë ose anasjelltas. Suvarovi thoshte se frika na bllokoi këmbët e na lidh duart kurse vjershtëtori Njegoshi thoshte se frika shumë herë e korit njeriun.

Gjithkush ndodhet në një gjendje: ka humbur punën, ka humbur shtëpinë prej dikujt. Çfarë duhet të bëhet më tej? Koha është për të gjetur një punë të re dhe për të blerë një shtëpi të re, sepse Perëndia gjithmonë ka plane më të mira për ne, se sa vetë ne mendojmë. S’duhet të jeni të zemëruar për ngjarje të këtilla, sepse ka një arsye për këtë. Shikoni përpara, sepse e mirë u vjen pas. Kur e mbyllni një derë, Perëndia e çelë një tjetër. Vetëm s’është mirë ta shikojmë gjatë derën e mbyllur. E kur ju mendoni më tepër për Perëndinë, ajo do të kujdeset më shumë.

Shpeshherë Perëndia ka përdorur njerëzit me karakter të dobët: na kanë sjellë shqetësime në punë ose na kanë lëvizur nga një vend në tjetrin. Perëndia një gjë të këtillë e bëri edhe për mua disa herë. E kur ndodheni në një gjendje të tillë, mos harroni se ka dalje. Zoti të vënë në provë. E për Perëndinë nuk është ndonjë gjë e rëndë. Ai mund të bëjë shumë më tepër për ju, se sa ju vërtetë mendoni. Veçse mos e pyet për diçka të keqe. Kur njerëzit e humbin shpresën, ata duket se kanë rënë në fund dhe nuk kanë asnjë mënyrë për të dalur. S’kanë asnjë dëshirë për të jetuar. Mos harroni se nga çdo situatë ka një mënyrë për të dalë, vetëm një gjë është e sigurt askush s’ka mundur të ikën nga varri.

IX. BESIMET FETARE NDËR SHQIPTAR

*Jem shqiptar, por s’jem si motit,
e kem lënë rrugën e Zotit.
Të gjithë po thonë: ne jemi krenar,
por kështu kombi s’e ka mbarë.*

Ne të gjithë jemi krenar në besimit tonë, pa marrë parasysh se çfarë feja kemi. Kur ne kemi lindur, prindërit na detyruan ta pranojnë besimin e tyre. Nuk është një tragjedi e madhe që prindër na dhanë besimin e tyre, sepse ata s’kanë ditur më shumë. Tragjedia është më e madhe për shumë prej nesh shqiptarëve, kur ne si të rriturit nuk e pyesim veten se çfarë kërkon Perëndia prej nesh e të mos t’i mbylлим sytë dhe të ecim pas njerëzive të tjerë. Tani është koha për të pyetur Perëndinë e, për t’i hapur sytë dhe për të parë se ku po shkojmë. Feja gjithmonë ka qenë për të blerë padijen e njeriut. Shumë njerëz ndihen të qetë në besimin e tyre për arsye të ndryshme: mungesa e njohurive, çështje materiale ose të ndjekë shumicën se çfarë bën. Tek disa besime: e vërteta është e parëndësishme. Kur vjen puna te besimit, ne s’duhet të besojmë në njerëz dhe as në komunitete fetare. Ne duhet t’i lutemi Perëndisë që të na udhëzojë në rrugën e drejtë. Nëse ju jeni besimtarë të devotshëm, duhet të keni kujdes: sot njerëzit vazhdimisht ndryshojnë e mos më keq bëjnë gjëra kundër Perëndisë. Të jemi të sigurt se askush s’ka të drejtë të ndryshojë Urdhërimet e Zotit.

Për t’u ruajtur nga besimet e kota më së miri i përgjigjet leximi i *Biblës*. Të shohim se çfarë thuhet sipas *Gjonit* 8:31-32: “Atëherë Jezusi u tha Judenjve që besuan në të: “Nëse do të qëndroni në fjalën time, jeni me të vërtetë

dishepujt e mi; do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju bëjë të lirë.”

Le t'i japim ca fjalë të urta:

- Kur është në pyetje paraja, të tanë janë një fe.
- Çka është skeleti për trupin, ashtu është morali për shpirtin.
- Si është trupi pa frymë, i vdekur, ashtu është feja pa vepra të mira, e vdekur.
- Zemra e pastër është çelsi i jetës shenjtë.

BIBLA E SHENJTË. - *Bibla* është një libër i shenjtë ç'është shkruar për historinë njerëzore që nga fillimi deri në marrës. Në *Bibël* gjinden të gjitha mesazhet e shkruara të Perëndisë për njerëzit e, ç'është plani i Perëndisë për shpëtimin e njeriut. Në *Bibël*, fjala e shkruar e Krijuesit tonë është fjala e Shpëtimtarit tonë. *Bibla* u shkrua nën kontrollin e Perëndisë. Ja se çfarë thuhet në të: “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqe dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë.” (2 e Timoteut 3:16-17); - “Dhe ne e dëgjuam këtë zë që vinte nga qielli, kur qemë bashkë me të në malin e shenjtë. Ne e kemi edhe më të vërtetuar fjalën profetike, të cilën bëni mirë ti kushtoni kujdes, si një kandil që ndriçon në një vend të errët, derisa të zbardhë dita dhe ylli i dritës të lindë në zemrat tuaja, duke ditur së pari këtë: që asnjë profeci e Shkrimit nuk është objekt i interpretimeve të veçanta. Sepse asnjë profeci nuk ka ardhur nga vullneti i njeriut, por njerëzit e shenjtë të Perëndisë kanë folur, të shtyrë nga Fryma e Shenjtë.” (2 Pet. 1:18-21); - “Sepse të gjitha gjërat që u shkruan në të kaluarën u shkruan për mësimin tonë, që me anë të këmbënguljes dhe të ngushëllimit të Shkrimeve, të kemi shpresë.” (Rimokëve 15:4); - “Sepse asnjë profeci nuk ka ardhur nga vullneti i njeriut, por njerëzit e shenjtë të Perëndisë kanë folur, të shtyrë nga Fryma e Shenjtë.” (2 e Pjetrit 1:21) *Bibla* është e vërtetë, sepse ajo ishte shkruar nën kontrollin e Frymës së Perëndisë. Ajo është shkruar nga profetët, të cilët folën drejtpërsëdrejti me Perëndinë dhe bashkë me të dymbëdhjetë apostujt, të cilët ishin dishepuj e Jezusit. Në tërë *Biblën* Zoti, Perëndia ynë zbulon madhësitinë e karakterin e tij. Në *Bibël* do të gjeni gëzime, bekime të Perëndisë dhe paqe.

Një autor i panjohur thotë: “Pasqyra ju tregon se çfarë është pamja e jonë para popullit, kurse *Bibla* ju tregon se çfarë është pamja jonë para Perëndisë.”

Bibla është udhëzim i Perëndisë, në mënyrë që të përgatiten për një

takim me Krijuesin tonë. Urtësia e popullit të Perëndisë është studimi i *Biblës*. *Bibla* është udhërrëfyese ynë për parajsë! Bibla ka ndryshuar jetën e miliona njerëzve. Ajo gjithashtu mund të ju ndihmojë. *Bibla* na tregon se ne jemi duke jetuar në kohën e ngjarjeve të fundit të historisë së botës. Bota së shpejti do të përfjohet shkatërrimin e papritur. Unë nuk e bëj këtë për t'i trembur juve, por unë dua t'iu tregoj se ka shpëtim për ata që dëshirojnë.

Për të forcuar mendjen - është thënë para meje - asgjë s'është më e dobishme se duke lexuar shkrimet e shenjta. Asnjë libër s'e ka këtë fuqi për t'i rritur mendimet, për t'i rigjallëruar aftësitë, studimet biblike. Të gjithë ata që kanë studiuar Fjalën e Perëndisë karakterizohen nga gjërsia e mendjes, fisnikëria e karakterit, pra me një fjalë janë njerëz me virtyte të mëdha.

Perëndia shpejt do të shkatërrojë botën! Ne po jetojmë në ditët e fundit të historisë së botës. Dita e shkatërrimit do të vijë shpejt. Por le të shohim se çfarë thuhet në *Bibël*: “Dita e Zotit është e afërt, është e afërt dhe po vjen me shpejtësi të madhe. Zhurma e ditës së Zotit është e hidhur; atëherë njeriu trim do të këlthasë fort. Ajo ditë është një ditë zemërimi, një ditë mjerimi dhe ankthi, një ditë shkatërrimi dhe shkretie, një ditë terri dhe mjegulle, një ditë resh dhe errësire të thellë, një ditë zhurmimi të borisë dhe alarmi kundër qyteteve të fortifikuara dhe kullave të larta. Unë do të sjell fatkeqësinë mbi njerëzit dhe ata do të ecin si të verbër, sepse kanë mëkatuar kundër Zotit; gjaku i tyre do të shpërndahet si pluhur dhe mishi i tyre si jashtëqitje. As argjendi i tyre, as ari i tyre nuk do të mund t'i çlirojnë ditën e zemërimit të Zotit; përkundrazi tërë vendi do të gllabërohet nga zjarri i xhelozisë së tij, sepse ai do të kryejë me siguri një shkatërrim të plotë të të gjithë banorëve të vendit.” (*Sofonia* 1:14-18)

Mos u tutni, sepse nëse jini me Jezusin ju do të shpëtoni! “Dhe atëherë do të duket në qiell shenja e Birit të njeriut; dhe të gjitha kombet e dheut do të mbajnë zi dhe do ta shohin Birin e njeriut duke ardhur mbi retë e qiellit me fuqi dhe lavdi të madhe. Ai do t'i dërgojë engjëjt e vet me tinguj të fuqishëm borie; dhe ata do t'i mbledhin të zgjedhurit e tij nga të katër erërat, nga një skaj i qiellit te tjetri.” (*Mateu*, 24:30-31); - “Sepse Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryengjelli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër; dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin. Ngushëlloni, pra, njëri-tjetrin me këto fjalë.” (*1 e Thesalonikasve* 4:16-18).

Perëndia s'është krenare për ne aq sa ne mendojmë. Shtrohet pyetja: pse është e rëndësishme për ne të dijmë se ç'mendojnë të tjerët për ne?

Shpeshherë ndodh ndër ne: duhet të shfaqemi tërheqës e të bukur para popullit. Të tregojmë lakuriqësinë apo bukurinë. Veset tjera: veshje luksoze; shtëpi madhështore e makina luksoze.

A keni menduar ndonjëherë: çfarë mendon Perëndia për ju? Duhet të kemi kujdes: të ruhem nga mëkati! Mos ta humbasim jetën tonë të re në qiell për shkak veseve dhe huqeve që bëjmë në tokë.

Çka na vlen që jemi shqiptar, me ne Zoti s'është krenar. Të gjithë jemi mëkatar, dikush më pak e dikush më shumë. “Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë.” (*Romakëve 3:23*)

Ende te shqiptarët ka adhurim për zotrat pagane. Ne vazhdojmë t'i lutemi idhujve dhe njerëzve të vdekur. E aq më keq festojmë lavdinë pagane dhe nuk i mbajmë urdhërimet e Perëndisë. Është thënë edhe para meje se atij që i lutesh, ai është zoti i yt. Kombi shqiptar i ka përvetësuar disa tradita pagane. Këto tradita i praktikojnë vetëm ata që s'janë me Zotin. E keqja është se në asnjë mënyrë s'mund të binden se e kanë gabim. E mos më keq njerëzimi duke u larguar nga Perëndia po ndodhin gjëra të llatarshme: luftëra, tërmete, përmyetje, sëmundje nga më të ndryshme; uria, droga, alkooli, kurvëria dhe homoseksualiteti.

Bëhuni bashkë ju vëllezër shqiptarë

Çka do ti të gjithë këto fe,
që ja lodhën zemrën Zotit.
Si e mbrapshtuan popullin,
që veç një fe ka qenë moti.

Janë shumë fe të vjetra e të reja,
çka është Zoti që nuk dijnë.
Të gjithë po thonë besojnë në Zotin,
por me të gjallin shkojnë e vijnë.

Janë shumë fe, janë tregtira,
por një drejtim është te Zoti.
Për ata shikoni ju ka shkoni,
mos gaboni me u vra Zoti.

E kemi lënë Zotin e kemi marrë traditat,
të na duket se është mirë.
Do të shohim se është gabim,
në gjygj Zoti kur të na thirrë.

Janë shumë fe që janë të vjetra,
por të gjithë nuk janë të drejta.
Janë shumë fe që kanë qenë motit,
Por veç një është e Zotit.

Bënu bashkë ju vëllezër shqiptarë,
prej një prindi jemi të tanë.
Mos këtë gjalli gjë me ne,
dikur ishim të gjithë një fe.

I madhi Zot është dashuri,
Ai na thirrë me i shkua në shtëpi.
Që me qenë gjithmonë të gëzuem,
se prej mëkatit ne jemi të rrëzuem.

Dashuria e Krijuesit kurrë nuk soset,
por shumë kohë s'na ka mbetur.
Vëllezër shqiptarë po Ju lutem,
kthenju Krijuesit sa s'kemi tret!

Pse të gjithë besimet janë të sigurt se janë me Zotin?

Le të shohim çka ka thënë Zoti në *Biblë*: “Sepse nuk pranuan ta duan të vërtetën për të qenë të shpëtuar. E prandaj Perëndia do t’u dërgojë atyre një gënjim që do t’i bëjë të gabojnë, që t’i besojnë gënjeshtres.” (2 e *Thesalonikasve* 2:10-11)

Shumëkush thotë se ka me mijëra fe në botë. Të gjithë pajtohen në një pikë: se të gjithë ata besojnë në Perëndinë. Sikur të gjithë fetë të ishin, vërtet, me Perëndinë atëherë bota s’do të kishte ngatërresa. Tani shtrohet pyetja: si mund të jenë të gjitha fetë me Perëndinë kur ata vetë s’e njohin Perëndinë?

Si mund ta njohim Perëndinë?

1. Njihuni me Perëndinë nëpër qiell. Shikone qiellin, të gjithë ju e dini se

është krijuar nga Zoti dhe fuqia e tij.

2. Njihuni me Perëndinë nëpërmjet natyrës. Të gjithë ju e dini se është krijuar nga Zoti dhe fuqia e tij.
3. Njihuni me Perëndinë nëpërmjet bekimeve tuaja.
4. Njihuni me Perëndinë nëpërmjet dashurisë së tij. “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.” (Gjoni 3:16)
5. Bisedoni me Perëndinë për t’i përmbushur dëshirat e tuaja. Ai dëshiron diçka nga ju.
6. Lexoni *Biblën* dhe luteni Zotit t’ju dërgojë dituri dhe dashuri.

Perëndia është e vetmia që i do të gjithë njerëzit në mënyrë të barabartë, pa interes. E dihet se dashuria e Perëndisë është e përjetshme.

Çfarë është mëkati?

Të mos zbatosh urdhërimet e Perëndisë është mëkat. - Në Ungjillin sipas 1 Gjoni 3:4 thuhet: “Kush bën mëkat, bën edhe shkelje të ligjit; dhe mëkati është shkelje e ligjit” kurse në një rast tjetër thuhet: “Zoti është i ngadaltë në zemërim dhe i madh në mëshirë; ai fal padrejtësinë dhe mëkatin, por nuk lë pa ndëshkuar fajtorin, duke dënuar paudhësinë e etërve të bixhës, deri në brezin e tretë ose të katërt.” (Numrat 14:18)

Mos mendoni se ju nuk jeni mëkatar, se vetëm mëkati juaj mund t’ju bëjë të veçantë nga Perëndia. Në *Bibël* thuhet: “Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë.” (Romakëve 3:23); - “Nuk ka në fakt asnjë njeri të drejtë mbi tokë që bën të mirën dhe të mos mëkatojë.” (Predikuesi 7:20); - “Po të themi se jemi pa mëkat, gënjejmë vetveten dhe e vërteta nuk është në ne.” (1 e Gjoni 1:8)

Çfarë na bën mëkati?

1. Kur ne mëkatojmë, djalli heq shpresën tonë. Kur njerëzit e humbin shpresën, ata duket se kanë marrë fund dhe s’ka asnjë mënyrë për t’i

nxjerrë ata. E më keq ata s'kanë asnjë dëshirë për të jetuar. Kjo gjendje i bën të vrasin dikënd ose të vetvriten. Por ka një zgjidhje: të mos harrojmë se nga çdo gjendje ka një rrugë për të dalë, se vetëm nga varri s'dilet.

2. Ne humbim kontrollin e vetes. Ne nuk punojmë si duhet dhe çdo gjë që ne mendojmë themi se është mirë. Ndërsa gjithçka që njerëzit e tjerë e bëjnë ne mendojmë se kjo është e gabuar. Ka një të keqe në këtë punë: nuk duam që dikush të na mësojë, duke menduar se ne dijmë gjithçka.
3. Ne nuk e mbajmë shëndetin tonë. Marrim pije alkoolike, pijmë duhan dhe drogë, udhqehemi keq dhe në këtë mënyrë e shkatërrojmë shëndetin tonë. E gënjejmë veten s'nuk mundemi pa ta.
4. Ne nuk na intereson asgjë, sepse ne jemi humbës. Ne e shohim veten si humbës dhe nuk bëhet vonë për të gjetur një zgjedhje. Jemi mësuar si gjithmonë dikush të jetë fajtor për dështimet tona.
5. Ne nuk kujdesemi për familjen tonë.
6. Mëkati na ndan nga Perëndia dhe na merrë paqen në familje.
7. Mëkati e shkatërron moralin tonë.
8. Mëkati shkatërron mendjen tonë dhe na bën të marrë.
9. Mëkati shkatërron dashurinë tonë. (Ne nuk duam të shohim njëri-tjetrin dhe flasin si mos më keq për të tjerët.)
10. Mëkati na tërheq në gëzimin e gjërave të këqija: pijeve alkoolike e duhanit, kurvërisë dhe bixhozit.
11. Mëkati na sjellë vdekjen e parakohshme dhe mjerim në mesin e fëmijëve.
12. Mëkati na tërheq në borxh.
13. Mëkati na prish fjalorin tonë. (Shumë njerëz nuk kujdesen se çfarë thonë, përdorin me vend e pavend fjalë të liga).
14. Mëkati na sjellë shumë gjëra të liga: turpin, hakmarrjen, kotësinë, vrasjen, vetëvrasjen, varfërinë e skajshme, mashtrimin, stresin etj.
15. Mëkati na bënë të vjedhim, të mashtrojmë dhe të spiunojmë.
16. Për shkak të mëkatit ne nuk i shohim nderin fitimet, sepse fëmijët i kemi

jashtë kontrollit. Me një fjalë puna pa fitim është si toka pa bërëqet.

17. Mëkati na sjellë çdo ditë e më shumë probleme edhe na rrethon me shoqëri të keqe.

18. Mëkati e detyron trupin për të kontrolluar trurin.

Këta janë gjërat që mund të ketë ndonjë njeri që është i ngarkuar me mëkatin e pafalshëm. Për shkak të mëkatit, mund të themi, populli shqiptar ka qenë një kohë të gjatë nënsundimin e armikut. E kemi shprehur që gjithmonë t'i lëmë fajin armikut e kurrënjëherë vetvetes. Mëkati na prekë aty ku dhemb më së shumti: në shëndet, në martesë dhe te fëmijët. E më keq mëkati të dërgon në ferr.

Një fjalë e urtë thotë: pendimi është një ilaç për çdo mëkat.

Kush mund t'i falë mëkatet tona?

Në *Biblën* e shenjtë thuhet: “Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë, por janë shfajësuar falas me anë të hirit të tij, nëpërmjet shpengimit që është në Krishtin Jezus. Atë ka paracaktuar Perëndia për të bërë shlyerjen nëpërmjet besimit në gjakun e tij, për të treguar kështu drejtësinë e tij për faljen e mëkateve, që janë kryer më parë gjatë kohës së durimit të Perëndisë.” (*Romakëve* 3:23-25); - “Po t'i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.” (1 e *Gjonit* 1:9); - “Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja. Edhe të gjitha gjërat janë nga Perëndia që na pajtoi me veten përmes Jezu Krishtit dhe na dha shërbimin i pajtimit, sepse Perëndia e ka pajtuar botën me veten në Krishtin, duke mos ua numëruar njerëzve fajet e tyre dhe vuri ndër ne fjalën e paqimit.” (2 e *Korintasve* 5:17-19)

Mëkati nuk matet me ndonjë masë. Mëkati i madh apo i vogël është mëkat. Dënimi për mëkatin është vdekja e përjetshme, pavarësisht nëse është i madh apo e vogël ai mbetet mëkat. Prandaj luteni Zotit për t'i falur të gjitha mëkatet pa përjashtim.

Çfarë Perëndia nuk mund t'i falë njerëzve? Ai nuk mund t'i falë njerëzit vetëm për blasfemi kundër Frymës së Shenjtë. Ja çfarë thuhet në Ungjillin sipas Markut 3:28-29: “Në të vërtetë po ju them se bijve të njerëzve do t'u falet çfarëdo mëkat dhe çdo blasfemi që do të thonë; po për atë që do të blasfemojë kundër Frymës

së Shenjtë nuk do të ketë falje përjetë; ai është fajtor për dënim të përjetshëm?” Shtrohet pyetja: çfarë do të thotë kjo? Ja çfarë thuhet në *Biblë*: “Por ata nuk deshën të dëgjojnë, kthyen krahët me kryeneçësi dhe i zunë veshët që të mos dëgjonin. E bënë zemrën e tyre si diamanti, për të mos dëguar ligjin dhe fjalët që Zoti i ushtrive u dërgonte atyre me anë të Frymës së tij, me anë të profetëve të së kaluarës. Kështu u krijua një indinjatë e madhe te Zoti i ushtrive. Dhe ndodhi që, mbasi ai thërriste dhe ata nuk ia vinin veshin, ata thirrën dhe unë nuk ua vura veshin, thotë Zoti i ushtrive.” (*Zakaria* 7:11-13); - “O njerëz qafëfortë dhe me zemër e veshë të parrethprerë, ju gjithnjë e kundërshtoni Frymën e Shenjtë; ashtu siç bënin etërit tuaj, ashtu bëni edhe ju.” (*Veprat e Apostujve* 7:51)

Kushdo që refuzon thirrjen e Perëndisë, nuk do të ketë justifikim për gjykimin e Zotit. Perëndia nuk do t’ju falë.

Kush është Jezu Krishti?

Pasi njeriu gabo i ndaj Zotit, ai u dha njerëzve urdhërimet që të dijnë sesi të sillen. Djalli apo Luciferri ka thënë: njeriu e ka të vështirë t’i përmbahet urdhërimeve të Zotit. Për këtë shkak Zoti e ka dërguar Jezusin, birin e vet në tokë, jo si Zot, por si njeri pa asnjë fuqi të mbinatyreshme, me qëllim që t’ja vërtetoi djallit, njerëzve dhe tërë gjithësisë se Zoti është i drejtë dhe se urdhërimet nuk janë të vështira për t’i mbajtur. Jezusi ka arritur t’u përmbahet urdhërimeve të Zotit duke lexuar *Biblën* dhe duke ju lutur Zotit pa kurrfarë fuqie të mbinatyreshme. Të mos harrojmë se këtë gjë mundemi edhe ne ta bëjmë. Jezusi e ka fituar fuqinë e madhe nga Zoti pasi që është pagëzuar.

A është Jezusi i dërguari i Zotit? Po. Jezusi është i dërguari i Zotit. Le të shohim se çfarë thuhet në *Biblë*: “Sepse Perëndia e deshë aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme.” (*Gjoni* 3:16)

Pjesa më e madhe e njerëzimit e pranon Jezusin se është Biri i Perëndisë, kurse pjesa tjetër e mohon një gjë të tillë. Këta që e mohojnë përgjegjjen e kanë te Ungjilli sipas Gjoni 20:29 ku thuhet: “Jezusi i tha: “Sepse më ke parë, Thoma, ti ke besuar; lum ata që nuk kanë parë dhe kanë besuar!” Kurse në një vend tjetër thuhet: “Në qoftë se ju fyejnë për emrin e Krishtit, lum ju, sepse Fryma e lavdisë dhe Fryma e Perëndisë prehet mbi ju...” (*1 e Pjetrit* 4:14)

Për shumë njerëz që s’e kanë lexuar *Biblën* (edhe ata që e kanë lexuar,

por se kanë kuptuar) mendojnë se Zoti s'mund të jetë i lindur. Tani mund t'i pyesim: a u lind Perëndia? Përgjigjen mund ta marrin prapë nga libri i shenjtë: “Dhe s’ka asnjë dyshim se misteri i mëshirës është i madh: Perëndia u shfaq në mish, u shfajësua në Frymë, u duk ndër engjëj, u predikua ndër johebrenj, u besua në botë, u ngrit në lavdi.” (1 e *Timoteut* 3:16)

Siç shihet nga çfarë u tha më sipër Zoti s’ka lindur, por ama është dëftuar në natyrën e njeriut. Sipas Ungjillit të Gjonit 3:16 “... sa dha Birin e tij të vetëmlindurin.” Me një fjalë Perëndia s’ është lindur, por një fëmijë ka lindur e, në këtë fëmijë hyri Fryma e Shenjtë. “Sepse, duke qenë se bijtë kanë marrë pjesë prej mishi dhe gjaku, po ashtu edhe ai u bë pjestar në po ato gjëra, që të shkatërronte, me anë të vdekjes, atë që ka pushtetin e vdekjes, domethënë djallin.” (*Hebrenjve* 2:14); - “I cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazi veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, e përuli vetveten duke u bërë i bindur deri në vdekje, deri në vdekje të kryqit. Prandaj edhe Perëndia e lartësoi madhërisht dhe i dha një emër që është përmbi çdo emër, që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju i krijesave (ose gjërave) qiellore, tokësore dhe nëntokësore, dhe çdo gjuhë të rrëfejë se Jezu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë Atë.” (*Filipianëve* 2:6-11)

Zoti ka mundur të vijë me fuqi të mbinatyreshme, por njerëzit-mëkatarë s’do të kishin mundësi ta shohin, sepse ai zotëron shkëlqim të mrekullueshëm. Po edhe sikur do ta shohin Zotin, ata do ta adhuronin nga frika. E një gjë të tillë s’e do, sepse Ai dëshiron që ne ta nderojmë nga dashuria.

Përse Jezusi s’e di ditën e ardhjes së tij?

Ka shumë njerëz që s’e kuptojnë *Biblën* dhe thonë: Jezusi nuk është Zot, sepse nuk e di ditën e ardhjes së tij. Kur e është pyetur Jezusi, ai u ka thënë: “Tani sa për atë ditë dhe për atë orë, askush s’e di, as engjëjt e qieive, por vetëm Ati im.” (*Mateu* 24:36)

A është puna e Perëndisë një mister për njerëzit?

Në *Bibël* thuhet: “Dhe s’ka asnjë dyshim se misteri i mëshirës është i madh: Perëndia u shfaq në mish, u shfajësua në Frymë, u duk ndër engjëj,

u predikua ndër johebrenj, u besua në botë, u ngrit në lavdi.” (1 e *Timoteut* 3:16)

Fuqia e Perëndisë ishte në Jezusin, por Jezusi kishte një cak. Perëndia s’i zbulon të gjitha të fshehtat, për atë ajo s’e zbulon e ardhjen e dytë të Jezusit. Jezusi na ka thënë: “Kam edhe shumë gjëra të tjera për t’ju thënë, por ato ende ju nuk mund t’i mbani.” (*Gjoni* 16:12)

Jezusi dhe Zoti nuk janë dy zotra. Në Ungjillit sipas Gjtonit 10:30 Jezusi ka thënë: “Unë dhe Ati jemi një.”

Jezu Krishti është Shpëtimtari i vetëm i botës: “Sepse paga e mëkatit është vdekja, por dhuntia e Perëndisë është jeta e përjetshme në Jezu Krishtin, Zotin tonë.” (*Romakëve* 6:23); - “Por i pëlqeu Zotit ta rrihte dhe ta bënte të vuante. Duke ofruar jetën e tij si fljim për mëkatin, ai do të shikojë pasardhës, do të zgjasë ditët e tij, dhe vullneti i Zotit do të ketë mbarësi në duart e tij.” (*Isaia* 53:10); - “Sepse Perëndia e ka pajtuar botën me veten në Krishtin, duke mos ua numëruar njerëzve fajet e tyre dhe vuri ndër ne fjalën e paqimit.” (2 e *Korintasve* 5:19); - “Kjo fjalë është e sigurt e denjë për t’u pranuar plotësisht, që Krishti Jezus erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët, ndër të cilët unë jam i pari.” (1 e *Timoteut* 1:15); - “Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem.” (*Vëprat e Apostujve* 4:12); - “Sepse, po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jezus, dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, do të shpëtohesh. Sepse me zemër, njeriu beson në drejtësi dhe me gojë bëhet rrëfim për shpëtim.” (*Romakëve* 10:9-10); - “Dhe dëshmia është kjo: Perëndia na dha jetën e përjetshme dhe kjo jetë është në Birin e tij. Ai që ka Birin, ka jetën; ai që nuk ka Birin e Perëndisë, nuk ka jetën.” (1 e *Gjtonit* 5:11-12)

Isret Isaja-Jezusi-Mesia është i njëjti person që janë duke pritur: myslimanët, të krishterët, dhe çifutët, i cili duhet të kthehen nga qielli. Jezusi erdhi në tokë për të na mësuar se si të përgatitemi për ardhjen e tij të dytë. Ardha e dytë e Jezusit do të jetë ndryshe. Ai do të vijë për të na marrë dhe për të na çuar në parajsë dhe këtë herë ai nuk do të ecën në tokë. Kjo do të thotë atë që nuk shkojnë në qiell me Isret Isajën-Jezusin, nuk është dikush tjetër që do të vijë për të marrë atë. Nëse ju nuk i luteni Zotit për të vërtetën, atë s’do ta gjeni kurrë.

Jezusi ka pushtet për t’i falë mëkatet tona: “Dhe tani, që ta dini se Biri i njeriut ka pushtet të falë mëkatet mbi dhe, unë po të them (i tha

të paralizuarit): Çohu, merre vigun tënd dhe shko në shtëpinë tënde!” (Markut 2:10-11); - “Dhe kur e pashë, rashë para këmbëve të tij si i vdekur. Dhe ai vuri dorën e tij të djathtë mbi mua, duke më thënë: “Mos u tremb! Unë jam i pari dhe i fundit, dhe i gjalli; isha i vdekur, por ja, jam i gjallë në shekuj të shekujve, amen; dhe unë i kam çelësat e vdekjes e të Hadesit.” (Zbulesa 1:17-18)

Dashuria e Jezusit është shpëtim ynë

Jezu Krishti ka thënë në *Bibël* te Ungjilli sipas Gjonit 15:12,13: “Ky është urdhërimi im: ta doni njëri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve. Askush s’ka dashuri më të madhe nga kjo: të japë jetën e vet për miqtë e tij.” - “Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri, i cili e dha veten si çmim për të gjithë, për dëshmim në kohën e caktuar.” (1 e Timoteut 2:5, 6). Kurse në një vend tjetër thuhet: “Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë, por janë shfajësuar falas me anë të hirit të tij, nëpërmjet shpengimit që është në Krishtin Jezus. Atë ka paracaktuar Perëndia për të bërë shlyerjen nëpërmjet besimit në gjakun e tij, për të treguar kështu drejtësinë e tij për faljen e mëkateve, që janë kryer më parë gjatë kohës së durimit të Perëndisë, për të treguar drejtësinë e tij në kohën e tanishme, me qëllim që ai të jetë i drejtë dhe shfajësues i atij që ka besimin e Jezusit.” (Romakëve 3:23-26). Kurse në një rast tjetër Jezu Krishti thotë: “Sepse unë kam zbritur nga qielli jo për të bërë vullnetin tim, por vullnetin e atij që më ka dërguar. Ky është vullneti i Atit që më ka dërguar: që unë të mos humbas asgjë nga të gjitha ato që ai më ka dhënë, por t’i ringjall në ditën e fundit. Ky, pra, është vullneti i atij që më ka dërguar: që kushdo që sheh Birin dhe beson në të, të ketë jetë të përjetshme, dhe unë do ta ringjall atë në ditën e fundit.” (Gjoni 6:38-40); “... Mos u tremb! Unë jam i pari dhe i fundit, dhe i gjalli; isha i vdekur, por ja, jam i gjallë në shekuj të shekujve, amen; dhe unë i kam çelësat e vdekjes e të Hadesit.” (Zbulesa 1:17, 18); “Dhe Jezusi u foli atyre përsëri duke thënë: “Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës.” (Gjoni 8:12); “Zemra juaj mos u tronditë; besoni në Perëndi dhe besoni edhe në mua! Në shtëpinë e Atit tim ka shumë banesa; përndryshe do t’ju thoja. Unë po shkoj t’ju përgatis një vend. Dhe kur të shkoj e t’ju përgatis vendin,

do të kthehem dhe do t'ju marr pranë meje, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju.” (Gjoni 14:1-3).

Kthehuni nga Krijuesi!

Në Biblën shenjtë thuhet: “Perëndia, pra, duke kaluar përmbi kohërat e padijes, i urdhëron të gjithë njerëzit dhe kudo që të pendohen. Sepse ai ka caktuar një ditë në të cilën do të gjykojë me drejtësi botën me anë të atij njeriu të cilin ai e ka caktuar; dhe për këtë u ka dhënë të gjithëve një provë të sigurt, duke e ringjallur prej të vdekurit.” (*Vëprat e Apostujve* 17:30, 31); “Pastaj pashë një engjëll tjetër që fluturonte në mes të qiellit dhe që kishte ungjillin e përjetshëm, që t’ua predikojë banorëve të dheut dhe çdo kombi, dhe fisi, dhe gjuhe, dhe populli, dhe thoshte me zë të madh: “Druani Perëndinë dhe i jepni lavdi, sepse ora e gjyqit të tij erdhi; adhuroni atë që bëri qiellin, dheun, detin dhe burimet e ujërave.” (*Zbulesa* 14:6, 7); “Të dëgjojmë, pra, përfundimin e gjithë ligjëratës: “Ki frikë nga Perëndia dhe respekto urdhërimet e tij, sepse kjo është tërësia e njeriut”. Sepse Perëndia do të vërë të gjykohet çdo vepër, edhe çdo gjë që është fshehur, qoftë e mirë apo e keqe.” (*Predikuesi* 12:13, 14); “Ai duke u përgjigjur tha: “Dua je Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë forcën tënde dhe me gjithë mendjen tënde, edhe të afërmin tënd pors i vetveten.” (*Luka* 10:27).

Është thënë disa herë se në këtë botë ka disa fe. E kur ka shumë fe, kjo do të thotë se ka shumë zotëra. Ky është një gabim trashanik, sepse dihet se është vetëm një zot i vërtetë. Kurse Perëndia na ka thënë: “Kthehuni nga unë dhe do të shpëtoni, ju mbarë skaje të tokës. Sepse unë jam Perëndia dhe nuk ka asnjë tjetër.” (*Isaia* 45:22)

Në botë ka shumë besime dhe shumë emra për Perëndinë. Perëndia ka vetëm një emër Yahve, dhe Ai ka shumë tituj. Besimet e ndryshme fetare thërrasin Perëndinë me emra të ndryshëm, të cilat nuk i përkrasin Krijuesit. Nëse ju doni të luteni Perëndisë së vërtetë, lutju Krijuesit tënd, në këtë mënyrë nuk do të bëni një gabim, sepse është vetëm një Krijues.

Ne s’kemi nevojë për ta mbrojtur Zotin!

Që shumë njerëz vrasin veten ose njerëz të tjerë për zot të tyre. Nëse vjen koha Perëndia ka për të mbrojtur atë, kjo do të thotë se Zoti im është i varfër e, kjo do të thotë se Zoti im s’është Perëndi. Unë nuk zemërohem

në ata që shajnë Perëndinë time, sepse ata nuk më bëjnë asgjë, as mua e as Perëndisë time. Ata vetëm i bëjnë të keqe vetëm vetvetës, sepse ata do të përgjigjen një ditë Perëndisë për veprimet e tyre.

Njerëzit i dalin zot të keqes me të keq, e të mirës me të mirë. Në është Zoti i juve i mirë, dilni zot të mirës me të mirë.

Në *Bibël* shkruhet: “Ai që nuk ka dashuri nuk e ka njohur Perëndinë, sepse Perëndia është dashuri.” (1 e Gjonit 4:8)

Perëndia dëshiron që ne të zbatojmë urdhërimet e tij: “Sepse kjo është dashuria e Perëndisë: që ne të zbatojmë urdhërimet e tij; dhe urdhërimet e tij nuk janë të rënda.” (1 e Gjonit 5:3)

Cilat janë urdhërimet e Zotit?

Janë dhjetë Urdhërimet e Perëndisë, i cila i shkroi me dorën e tij mbi pllakën prej gurit dhe ia dhuroi Moisiut. Këta urdhërime janë shkruar për të gjithë botën, të cilët duan të jenë me Perëndinë.

Urdhërimi i parë gjindet në të shenjtën *Bibël* sipas Eksodit 20:1-3: “Atëherë Perëndia shqiptoi tërë këto fjalë, duke thënë: “Unë jam Zoti, Perëndia yt, që të nxori nga vendi i Egjiptit, nga shtëpia e skllavërisë. Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje.”

Kjo do të thotë se ne nuk duhet të lutemi në tjetër zot përveç Krijuesit tonë. Populli shqiptar i lutet zotërave të tjerë, idhujve, si dhe njerëzve të vdekur.

Urdhërimi i dytë gjindet po ashtu tek *Eksodi* 20:4-6: “Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëlltyrë të asnjë gjëje që ndodhet aty në qiejt ose këtu poshtë në tokë ose në ujërat nën tokë. Nuk do të përkulesh para tyre dhe as do t’i shërbesh, sepse unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xheloz që dënon padrejtësinë e etërve mbi fëmijve të tyre deri në brezin e tretë dhe të katërt të atyre që më urrejnë, dhe unë përdor dashamirësi për mijëra, për ata që më duan dhe që zbatojnë urdhërimet e mia.”

Duhet të dijmë një gjë: ne s’duhet të kemi askënd dhe asgjë midis nesh dhe Perëndisë, sepse gjithçka ç’është në mes nesh dhe Perëndisë, dihet se do të na ndan nga Perëndia.

Urdhërimi i tretë gjindet po ashtu tek *Eksodi* 20:7: “Nuk do ta përdorësh emrin e Zotit, të Perëndisë tënd, kot, sepse Zoti nuk do të lërë të pandëshkuar atë që përdor kot emrin e tij.”

Një gjë është e qartë: s' duhet ta mallkojmë Perëndinë, por as s' duhet të betohemi për te. Le të shohim se çfarë thuhet në *Bibël* sipas Ungjillit të Mateut 5:34-37: “Por unë po ju them: “Mos u betoni fare, as për qiellin, sepse është froni i Perëndisë, as për tokën, sepse është stol i këmbëve të tij, as për Jeruzalemin, sepse është qyteti i Mbretit të madh. Mos u beto as për kokën tënde, sepse nuk ke fuqi të zbardhësh ose të nxish qoftë edhe një fije floku; Por fjala jote të jetë: Po, po; jo, jo; gjithçka më tepër vjen nga i ligu.”

Urdhërimi i katërt gjindet po ashtu tek *Eksodi* 20:8-11: “Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar. Do të punosh gjashtë ditë dhe në ato do të bësh të gjithë punën tënde; por dita e shtatë është e shtuna, e shenjtë për Zotin, Perëndinë tënd; nuk do të bësh në atë ditë asnjë punë, as ti, as biri yt, as bija jote, as shërbëtori yt, as shërbëtorja jote, as kafshët e tua, as i huaji që ndodhet brenda portave të tua; sepse në gjashtë ditë Zoti krijoi qiejt dhe tokën, detin dhe gjithçka që është në to, dhe ditën e shtunë ai pushoi; prandaj Zoti e ka bekuar ditën e shabatit dhe e ka shenjtëruar atë.”

Mund të pyesim: pse është e rëndësishme që ne të mbajmë ditën e shenjtë? Përgjigjia është dhënë qartë tek *Ezekieliu* 20:19, 20: “Unë jam Zoti, Perëndia juaj; ecni sipas statuteve të mia, respektoni dekretet e mia dhe i vini në praktikë, shenjtëroni të shtunat e mia dhe ato le të jenë një shenjë midis meje dhe jush, në mënyrë që ju të pranoni që unë jam Zoti, Perëndia juaj.”

Urdhërimi i pestë gjindet po ashtu tek *Eksodi* 20:12: “Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde, me qëllim që ditët e tua të jenë të gjata mbi tokën që Zoti, Perëndia yt, po të jep.”

Urdhërimi i gjashtë thotë: “Nuk do të vrasësh.” (*Eksodi* 20:13)

Po shënojmë një mendim të Faik Konicës: “Dhe për të vënë këtë urdhër në veprim, janë bërë kanunet, gjyqet, xhandarët, burgjet: katër vegla, të cilat, kur s'mbaten të ndryshkura po punojnë si duhet, janë shenjat e para të një populli të qytetëruar”.

Urdhërimi i shtatë gjindet po ashtu tek *Eksodi* 20:14: “Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore.”

Urdhërimi i tetë gjindet po ashtu tek *Eksodi* 20:15: “Nuk do të vjedhësh.”

Nëse ju vjedhni pakë ose shumë, një të varfër apo të pasur, vjedhni nga nevoja ose nga dëshira për të vjedhur duhet të keni një gjë parasysh: do të përgjigjeni përpara Perëndisë për mëkatin tuaj.

Urdhërimi i nëntë gjindet tek *Eksodi* 20:16: “Nuk do të bësh dëshmi të rreme kundër të afërmit tënd.”

Urdhërimi i dhjetë gjindet po ashtu tek *Eksodi* 20:17: “Nuk do të dëshirosh shtëpinë e të afërmit tënd; nuk do të dëshirosh gruan e të afërmit tënd, as shërbëtorin e tij, as shërbëtoren e tij, as lopën e tij, as gomarin e tij, as asgjë tjetër që është e të afërmit tënd.”

Ashtu qoftë!

Urdhërimet e Zotit janë të përrjetshme dhe të pandryeshueshme!

Perëndia ka thënë në dy raste për urdhërimet: së pari te *Ligji i Përtërirë* 4:2: “Nuk do t’i shtoni asgjë atyre që unë ju urdhëroj dhe nuk do t’u hiqni asgjë, por zotohuni të zbatoni urdhrat e Zotit, Perëndisë tuaj, që unë ju porosis.” (*Ligji i Përtërirë* 4:2) ; së dyti te *Galatasët* 1:8 “Por, edhe sikur ne ose një engjëll i qiellit t’ju predikonte një ungjill të ndryshëm nga ai që ju kemi predikuar, qoftë i mallkuar.”

Pse ne duhet t’i mbajmë urdhërimet e Zotit?

Në *Biblën* e shenjtë shkruhet: “Sepse kjo është dashuria e Perëndisë: që ne të zbatojmë urdhërimet e tij; dhe urdhërimet e tij nuk janë të rënda.” (*1 e Gjonit* 5:3); - “Ah, sikur t’u kishe kushtuar kujdes urdhërimeve të mia! Paqja jote do të ishte si një lumë dhe drejtësia jote si valët e detit.” (*Isaia* 48:18); - “Dhe nga kjo e dimë se e kemi njohur atë, në qoftë se i zbatojmë urdhërimet e tij. Ai që thotë: “Unë e kam njohur atë,” dhe nuk zbaton urdhërimet e tij, është gënjeshtar dhe e vërteta nuk është në të. Por kush e zbaton fjalën e tij, në të me të vërtetë dashuria e Perëndisë është përsosur. Nga kjo e njohim se jemi në të.” (*1 e Gjonit* 2:3-5); - “Por në rast se nuk i bindesh zërit të Zotit, Perëndisë tënd, për të respektuar me kujdes të gjitha urdhërimet dhe të gjitha statutet e tij që sot të urdhëroj, do të ndodhë që të gjitha këto mallkime do të bien mbi ty dhe do të të gjejnë.” (*Ligji i Përtërirë* 28:15).

Dhjetë Urdhërimet janë ligji moral i Perëndisë. Sipas këtij ligji, Zoti do të dënojë njerëzit në Ditën e Gjykimit. Askush s’ka të drejtë për të ndryshuar këtë ligj, sepse ky është ligji i pandryshueshëm dhe i paprekshëm. Dhjetë Urdhërimet e Perëndisë janë një pasqyrë në të cilën mund të shohim se çfarë mëkatesh kemi. Kjo na bën që ne mund të shohim sesa jemi të larguar nga Perëndia. E të mbash urdhërimet e Perëndisë ka një shpresë për të shkuar në qiell. Perëndia na jep një jetë të re. Por nëse ju nuk i mbani urdhërimet e Perëndisë, e largoni veten

nga Perëndia, atëherë nuk mund të merrni jetën e përjetshme, dhuratë e Perëndisë. As kisha, as xhami, as teqeja nuk do të jenë në gjendje të mbrojnë ty përpara Perëndisë, për atë që t'i s'ke mbajtur urdhërimet e Zotit. Në ditën e gjykimit s'do të jesh në gjendje për të fajësuar dikë për mëkatin e tuaj. Prandaj, zoti na ka vënë para një detyre që duhet t'i mbajmë dhjetë urdhërimet.

“Ai që thotë: “Unë e kam njohur atë,” dhe nuk zbaton urdhërimet e tij, është gënjeshtar dhe e vërteta nuk është në të. Por kush e zbaton fjalën e tij, në të me të vërtetë dashuria e Perëndisë është përsosur. Nga kjo e njohim se jemi në të.” (1 e Gjonit 2:4-5) .

Populli shqiptar ka qenë shumë herë i pushtuar nga armiqtë dhe unë jam i mendimit se kjo ka ndodhur më së shumti se populli ynë e braktisi Perëndinë. Të braktisësh Perëndinë do të thotë të humbasësh mbrojtjen e Zotit. E kjo sot për sot na bën të mendojmë se ku jemi duke shkuar? Çfarë jemi duke bërë? A duhet të ruhem nga mëkati dhe kështu me radhë.

Duhet të mos harrojmë se mëkati s'është thjesht ai që thyen ligjet e Perëndisë, por më së shumti ai është që thyen zemërat tona. Të mos harrojmë: Perëndia do të na provon! Të gjithë ata që shkojnë në qiell, doemos duhet t'i nënshtrohen një provimi përpara Zotit. Në *Biblën* e shenjtë shkruhet: “Prandaj kështu thotë Zoti i ushtrive: “Ja, unë do t'i rafinoj dhe do t'i vë në provë.” (Jeremia 9:7); - “Këtë të tretë do ta bëj të kalojë nëpër zjarr, do ta rafinoj ashtu si rafinohet argjendi dhe do ta vë në provë ashtu si provohet ari. Ata do të thërrasin emrin tim dhe unë do t'i kënaq. Unë do të them: Ky është populli im, dhe ai do të thotë: Zoti është Perëndia im.” (Zaharia 13:9): - “Mos ki frikë nga ato për të cilat do të vuash; ja, djalli do të hedhë disa prej jush në burg, që të provoheni, dhe ju do të keni shtrengim për dhjetë ditë. Ji besnik deri në vdekje dhe unë do të të jap kurorën e jetës.” (Zbulesa 2:10); - “Lum njeriu që ngulmon në provë, sepse kur del i aprovuar, do të marrë kurorën e jetës, të cilën Zoti ua premtoi atyre që e duan.” (Jakobi 1:12).

Njeriu shfajësohet nga veprat: “Ju shikoni, pra, se njeriu shfajësohet nga veprat dhe jo vetëm nga besimi.” (Jakobi 2:24); - “Sepse, sikurse trupi pa frymën është i vdekur, ashtu edhe besimi, pa vepra, është i vdekur.” (Jakobi 2:26); - “Sepse kjo është dashuria e Perëndisë: që ne të zbatojmë urdhërimet e tij; dhe urdhërimet e tij nuk janë të rënda.” (1 e Gjonit 5:3); - “Por, duke qenë se u miratuam prej Perëndisë që të na besohet ungjilli, kështu ne flasim jo që t'u pëlqejmë njerëzve, por Perëndisë, që provon zemrat tona.” (1 e Thesalonikasve 2:4).

Mënyra më e drejtë për njerëzimin sot është që t'i binden urdhërimeve të Perëndisë e jo të njeriut! Të mos harrojmë: Jezu Krishti së shpejti do të vijë përsëri në tokë! Kjo shihet më së miri te Ungjilli sipas Gjonit 14:3: “Dhe kur të shkoj e t’ju përgatis vendin, do të kthehem dhe do t’ju marrë pranë meje, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju.”

A jeni gati për ditën e kiametit, për ardhjen e Jezusit?

Si duhet të përgatitemi për ardhjen e Jezusit?

1. Ne duhet të kemi një besim të fortë në Zotin. - “Edhe pa besim është e pamundur t’i pëlqesh Atij, sepse ai që i afrohet Perëndisë duhet të besojë se Perëndia është, dhe se është shpërblenjësi i atyre që e kërkojnë atë.” (*Hebrenjve* 11:6)
2. Kërkoni Perëndisë t’ia falë të gjitha mëkatet. - “Po t’i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.” (*1 e Gjonit* 1:9)
3. Falni mëkatet e tjetrit. - “Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin.” (*Efesianëve* 4:32); “Kujt do t’ia falni mëkatet, do t’i jenë falur, kujt do t’ia mbani, do t’i jenë mbajtur.” (*Gjoni* 20:23); “Sepse në qoftë se ju ua falni njerëzve gabimet e tyre, Ati juaj qiellor do t’juua falë edhe juve; por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj nuk do t’ua falë juve gabimet tuaja.” (*Mateu* 6:14, 15)
4. Duaje të afërmin tënd si veten tënde. - “Nuk do të hakmerresh dhe nuk do të mbash mëri kundër bijve të popullit tënd, por do ta duash të afërmin tënd si veten tënde. Unë jam Zoti.” (*Levitiku* 19:18); “Por unë po ju them: “Duani armiq të tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin.” (*Mateu* 5:44); “Në qoftë se armiku yt ka uri, jepi bukë për të ngrënë, dhe në se ka etje, jepi ujë për të pirë.” (*Fjalët e Urta* 25:21); “Duani njëri-tjetrin me dashuri vëllazërore; në nderim tregoni kujdes njeri me tjetrin. Mos u tregoni të përtuar në zell; jini të zjarrtë në frymë, shërbeni Perëndisë, të gëzuar në shpresë, të qëndrueshëm në shtrëngime, këmbëngulës në lutje; ndihmoni për nevojat e shenjtoreve, jini mikpritës. Bekoni ata që ju përndjekin, bekoni dhe mos mallkoni. Gëzohuni me ata

që gëzohen, dhe qani me ata që qajnë. Kini të njëjtat mendime njeri me tjetrin; mos lakmoni për lart, por rrini me të përunjurit; mos e mbani veten për të mënçur. Mos ia ktheni kurrkujt të keqen me të keqe, kërkoni të bëni të mirën përpara gjithë njerëzve. Po të jetë e mundur dhe aq sa varet prej jush, jetoni në paqe me gjithë njerëzit. Mos u hakmerrni për veten tuaj, o të dashur, por i jepni vend zemërimit të Perëndisë, sepse është shkruar: Mua më përket hakmarrja, unë kam për të shpëguar, thotë Zoti. Në qoftë se armiku yt, pra, ka uri, jepi të hajë; në pastë etje, jepi të pijë; sepse, duke bërë këtë, do të grumbullosh mbi krye të tij thëngjij të ndezur. Mos u mund nga e keqja, por munde të keqen me të mirën.” (Romakëve 12:10-21)

5. Zbatoni urdhërimet e Perëndisë. - “Sepse kjo është dashuria e Perëndisë: që ne të zbatojmë urdhërimet e tij; dhe urdhërimet e tij nuk janë të rënda.” (1 e Gjonit 5:3); “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia.” (Gjoni 14:15); “Ai që thotë: “Unë e kam njohur atë,” dhe nuk zbaton urdhërimet e tij, është gënjeshtar dhe e vërteta nuk është në të. Por kush e zbaton fjalën e tij, në të me të vërtetë dashuria e Perëndisë është përsosur. Nga kjo e njohim se jemi në të.” (1 e Gjonit 2:4, 5)

6. Rrëfeu Jezusit si Shpëtimtarin tuaj. - “Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri, i cili e dha veten si çmim për të gjithë, për dëshmim në kohën e caktuar.” (1 e Timoteut 2:5, 6); “Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohem.” (Veprat e Apostujve 4:12; “Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Po vjen ora, madje ka ardhur, kur të vdekurit do të dëgjojnë zërin e Birit të Perëndisë, dhe ata që e kanë dëgjuar do të jetojnë.” (Gjoni 5:24); “Pastaj Jezusi u afrua dhe u foli atyre duke thënë: “Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen.” (Mateu 28:18-20).

7. Ne duhet të pagëzohem, sepse pagëzimi është një pranim i Jezusit në turmë. Sipas Ungjillit të Shën Mateut 28:19, 20. Jezusi tha: “Shkoni, pra,

dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen.”

“Pastaj u tha atyre: “Dilni në mbarë botën dhe i predikoni ungjillin çdo krijese; ai që beson dhe është pagëzuar, do të jetë i shpëtuar; por ai që nuk ka besuar, do të jetë i dënuar.” (*Marku 16:15-16*).

“Dhe tani ç’pret? Çohu dhe ji i pagëzuar dhe i larë nga mëkatet e tua, duke thirrur emrin e Zotit.” (*Veprat e Apostujve 22:16*).

Nëse ju plotësoni këto kërkesa, Hyji do t’ju bekojë në mënyrë që ju do të jeni të befashuar. Përveç kësaj ju do të jenë të përgatitur për ardhjen e Jezusit. Nëse ju nuk shkoni me Jezusin, nuk është dikush tjetër që do të vijë për t’i marrë ju në qiell. Nga të gjitha shenjat që Jezusi na dha, ne shohim se po jetojmë në ditët e fundit të historisë së botës. Ne s’kemi shumë kohë. Ne duhet të jemi të përgatitur për të shkuar në qiell. Djalli do të përdorë të gjitha njohuritë e tij dhe fuqinë për të na ndaluar që të mos përgatitemi për të shkuar në qiell. Ai do t’i ngushtojë rrugët, në mënyrë që ne të jemi të detyruar të qëndrojmë me të. Para ardhjes së Jezusit, cilido që s’është me djallin nuk do të jetë në gjendje për t’i blerë apo shitur ndonjë gjësend. Ne duhet të jemi me Jezusin, dhe Jezusi është ai që do të kujdeset për ne.

E vetmja lidhje me Perëndinë është lutja: “Dhe gjithçka të kërkon në lutje, duke patur besim, do të merrni.” (*Mateu 21:22*); - “Dhe ne e dimë se të gjitha gjëra bashkëveprojnë për të mirë për ata që e duan Perëndinë, për ata që janë të thirrur sipas qëllimit të tij.” (*Romakëve 8:28*); - “Kjo është siguria që kemi përpara tij: nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të tij, ai na e plotëson: Dhe nëse dimë se ai na i plotëson të gjitha ato që i kërkojmë, ne dimë se i kemi ato që i kërkuam atij.” (1 e *Gjonit 5:14-15*).

Lutja është bisedë me Perëndinë dhe çelësi për parajsë.

Si të lutemi? Jezu Krishti na ka mësuar se si t’i lutemi Zotit: “Dhe ai u tha: “Kur të luteni, thoni: “Ati ynë që je në qiej, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë vullneti yt si në qiell edhe në tokë. Na jep çdo ditë bukën tonë të nevojshme. Dhe na i fal mëkatet tona, sepse edhe ne i falim fajtorët tanë; dhe mos lejo të biem në tundim, por na shpëto nga i ligu.” (*Luka 11:2-4*).

1. Së pari falenderoje Perëndinë për bekim.
2. Lutju Zotit që t'i falë mëkatet që ke bërë. Në *Biblën* e shenjtë shkruhet: “Po t'i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.” (1 e Gjonit 1:9). “Mos mendoni se ju jeni të pamëkat. Perëndia tha: “Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë.” (Romakëve 3:23).
3. Lutju Perëndisë që të kujdeset për ty dhe familjen tuaj.
4. Lutju Perëndisë për njëri-tjetrin, për miqtë, familjen, shokët, dhe për armiqet.
5. Lutju Perëndisë për diturinë, sepse të mos harrojmë se dituria vjen nga Perëndia.
6. Kërkoni Zotit t'ju ndihmojë për të forcuar besimin.
7. Nëse s'jeni të martuar, lutuni Zotit që të ju japë një bashkëshorte të mirë. Perëndia kurrë s' gabon.
8. Lutju Perëndisë për shëndetin.
9. Lutju Perëndisë për paqen në familje.
10. Lutju Perëndisë, sepse ai do t'ju bekojë.

Lutju Perëndisë për çdo ditë. Lutju Krijuesit tonë, sepse Ai është i vetmi Perëndi e vërtetë. Nëse ju s'e kanë provuar fuqinë e Perëndisë, lutuni për atë dhe ju do të shihni se çfarë ai mund të bëjë për ju. Shpejt do të ndjeni se ju jeni një person i ndryshëm. Do të ndjehen në paqe me veten dhe me familjen tuaj. Paqja në shtëpi vjen vetëm nga Krijuesi ynë, e jo në nga perënditë e tjera të rrejshme.

Kur Perëndia nuk përgjigjet lutjeve tona

1. Nëse ne nuk kemi një besim të fortë në atë. - Dhe Jezusi u tha atyre: “Prej mosbesimit tuaj; sepse në të vërtetë, unë po ju them, se po të keni besim sa një kokërr sinapi, do t'i thoni këtij mali: “Zhvendosu nga këtu atje”, dhe ai do të zhvendoset; dhe asgjë nuk do të jetë e pamundshme për ju.” (Mateu 17:20); “Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia,

le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t'i jepet. Por le ta kërkojë me besim, pa dyshuar, sepse ai që dyshon i ngjan valës së detit, të cilën e ngre dhe e përplas era. Dhe ky njeri të mos pandehë se do të marrë diçka nga Zoti.” (*Jakobi 1:5-7*)

2. Perëndia nuk do t'i përgjigjet lutjeve tona, në qoftë se ju kërkon diçka të panevojshme. - “Ju kërkon dhe nuk merrni, sepse kërkon keqas që të shpenzoni për kënaqësitë tuaja.” (*Jakobi 4:3*).

3. Perëndia nuk do t'i përgjigjet lutjeve tona, në qoftë se ju nuk i mbani urdhërimet. - “Në rast se dikush e kthen veshin gjetiu për të mos dëgjuar ligjin, vetë lutja e tij do të jetë një gjë e neveritshme.” (*Fjalët e urta 28:9*); “Ja, dora e Zotit nuk është tepër e shkurtër për të shpëtuar, as veshi i tij nuk është tepër i rënduar për të dëgjuar. Por paudhësitë tuaja kanë shkaktuar një ndarje midis jush dhe Perëndisë tuaj, dhe mëkatet tuaja kanë bërë të fshihet fytyra e tij prej jush, që të mos ju dëgjojë më. Sepse duart tuaja janë ndotur me gjak dhe gishtërinjtë tuaj me paudhësi; buzët tuaja thonë gënjeshtër, gjuha juaj pëshpërit çoroditje. Askush nuk çel padi me drejtësi, askush nuk e mbron me të vërtetën; kanë besim te fjalët boshe dhe thonë gënjeshtër, mendojnë të keqen dhe pjellin paudhësinë.” (*Isaia 59:1-4*); “Kur i shtrini duart tuaja, unë i fsheh sytë e mi nga ju; edhe kur i shumoni lutjet tuaja, unë nuk dëgjoj; duart tuaja janë tërë gjak.” (*Isaia 1:15*); “Ju burra, gjithashtu, jetoni me gratë tuaja me urtësi, duke e çmuar gruan si një enë më delikate dhe e nderoni sepse janë bashkëtrashëgimtare me ju të hirit të jetës, që të mos pengohen lutjet tuaja.” (1 e *Pjetrit 3:7*)

4. Perëndia nuk do t'i përgjigjet lutjeve të tyre, për të gjitha ata që s'u penduan për mëkatet e bëra. - “Kujtohu, pra, se nga ke rënë, pendohu, dhe bëj veprat e para; në mos do të vi së shpejti te ti dhe do ta luaj shandanin tënd nga vendi i vet, nëse nuk pendohesh.” (*Zbulesa 2:5*); “Kujto, pra, atë që more dhe dëgjove, dhe ruaje edhe pendohu. Po të mos rrish zgjuar, unë do të vij te ti si vjedhës, dhe nuk do të dish në ç'orë do të vij te ti.” (*Zbulesa 3:3*); “Pendohu, pra, për këtë ligësi që ke dhe lutju Perëndisë që, po të jetë e mundur, të të falet mendimi i zemrës sate.” (*Veprat e Apostujve 8:22*); “Po t'i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.” (1 e *Gjonit 1:9*)

Pothuajse, pa përjashtim, të gjithë mendojmë se do të shkojmë në qiell. Le të shohim se çfarë thotë Jezu Krishti: “Unë po ju them: atë natë dy



veta do të jenë në një shtrat; njëri do të merret dhe tjetri do të lihet. Dy gra do të bluajnë bashkë; njëra do të merret e tjetra do të lihet. Dy burra do të jenë në ara: njëri do të merret e tjetri do të lihet.” (*Luka 17:34-36*). Sipas fjalëve të Jezusit jo të gjithë do të vemi në qiell. Pra, me një fjalë, të gjithë ata njerëz që mendojnë se janë të mirë s’ do të shkojnë në qiell, Zoti ka thënë: “Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë.” (*Romakëve 3:23*).

Siç shihet, kjo botë ku jetojmë s’është pa mëkate. Pra, në një mënyrë a një tjetër, të gjithë pa përjashtim jemi mëkatarë. Në Parajsë do të shkojnë vetëm ata që mbajnë urdhërimet, pranojnë mëkatet e tyre ndaj Perëndisë dhe e pranojnë Jezu Krishtin si Shpëtimtar.

Si do të duket, ardhjen e dytë Jezu Krishtit? - “Dhe atëherë do të duket në qiell shenja e Birit të njeriut; dhe të gjitha kombet e dheut do të mbajnë zi dhe do ta shohin Birin e njeriut duke ardhur mbi retë e qiellit me fuqi dhe lavdi të madhe. Ai do t’i dërgojë engjëjt e vet me tinguj të fuqishëm borie; dhe ata do t’i mbledhin të zgjedhurit e tij nga të katër erërat, nga një skaj i qiellit te tjetri.” (*Mateu 24:30, 31*); “Sepse Zoti vetë, me një urdhër, me zë kryeengjëlli dhe me borinë e Perëndisë, do të zbresë nga qielli dhe ata që vdiqën në Krishtin do të ringjallen të parët; pastaj ne të gjallët, që do të kemi mbetur, do të

rrëmbehemi bashkë me ata mbi retë, për të dalë përpara Zotit në ajër; dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin. Ngushëlloni, pra, njëri-tjetrin me këto fjalë.” (1 e *Thesalonikasve* 4:14-18)

Po qe se nuk shkoni me Jezu Krishtin në qiell, mos pritni kot, se s’do t’i vijë t’i marrë dikush tjetër.

Pesë gjëra që na pengojnë që të jemi më afër Zotit

Liria është thelbi i shpirtit, dhe i mendjes; aty ku s’ka liri, mendja dhe shpirti thahen si bima pa ujë. Sami Frashëri

Njerzit janë sikur sytë, shohin gjithçka, përpos vetes. Ivo Andriç

Nëse do ta hapim zemrën e së keqes, do të hyjnë demonët.

Dashuria, me të vërtetë, është çelësi për një jetë të lumtur dhe të kënaqshme.

Ka dy lloje njerëzish në botë: ata që zgjedhin të jenë të lumtur (marrin gjërat në duart e tyre) dhe ata që nuk bëjnë një gjët ë tillë.

1. Urrejtja. - Ne duhet të falim të gjithë njerëzit me të cilët kemi lidhje. Ti hapim zemrat e, atëherë do të hyjë Shpirti i Shenjtë. Po qe se keni urrejtje në zemër, fuqia e Perëndisë nuk mund të rrjedhin përmes jush. Kjo urrejtje është armiku kryesor në jetën tuaj shpirtërore. Le të shohim se çfarë thuhet në Ungjillin sipas Mateut 6:14, 15 Jezusi ka thënë: “Sepse në qoftë se ju ua falni njerëzve gabimet e tyre, Ati juaj qiellor do t’juaj falë edhe juve; por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj nuk do t’ua falë juve gabimet tuaja.”

2. Frika. - Nëse ju keni frikë nga diçka, kur e lini derën hapur (me frikë Satani do të futet). Frika tërheq të keqen. Sot për sot është e domosdoshme t’i mësojmë njerëzve që t’i dorëzojnë frikën dhe mosmarrëvshjet Perëndisë. Prapë sipas Ungjillit të Mateut 1 7:20: kur Jezusi i thotë atyreve: “Prej mosbesimit tuaj; sepse në të vërtetë, unë po ju them, se po të keni besim sa një kokërr sinapi, do t’i thoni këtij mali: “Zhvendosu nga këtu atje”, dhe ai do të zhvendoset; dhe asgjë nuk do të jetë e pamundshme për ju.”

3. Ndjenja e një vlerë më të ulët. - Shumë njerëz ndjehen inferior dhe për këtë arsye janë vazhdimisht të pafat në jetë. Mbetën dështak. Disa

mendojnë se për ta janë gjëra që s'bëhen dot. Por le të shohim se çfarë thuhet në Librin e Shenjtë: “Unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon.” *Filipianëve* 4:13. Kurse në Ungjillin sipas Gjjonit 15:5 thuhet: “Unë jam hardhia, ju jeni shermendet; kush qëndron në mua dhe unë në të, jep shumë fryt, sepse pa mua nuk mund të bëni asgjë” Te Ungjilli sipas Markut 9:23 Jezusi thotë: “Nëse ti mund të besosh, çdo gjë është e mundshme për atë që beson.” Kurse në Letrën drejtuar Korintasve 15:19 thuhet: “Në qoftë se shpresojmë në Krishtin vetëm në këtë jetë, ne jemi më të mjerët e të gjithë njerëzve.”

Për Perëndinë çdo gjë është e mundur!

4. Faji: brejtje e ndërgjegjes. - Rrëfeji mëkatet te Jezusi dhe Ai do t'ju falë. Te Ungjilli sipas Markut 2:10: “Dhe tani, që ta dini se Biri i njeriut ka pushtet të falë mëkatet mbi dhe.” Refuzoje urrejtjen, frikën, ndjenjat e pavlefshmëri dhe të fajit, kështu që ju jeni të njohur me fuqinë e Krijuesit tonë.

5. Pasuria. - Një njeri është i shëmtuar, i vogël nga shtati; edhe ka pak mendje. Dikush më thotë në vesh: Ka pesë-dhjetë mijë lira të ardhura. Është vetëm punë e tij dhe për mua s' do të jetë kurrë as më liksht as më mirë. Në qoftë se nis ta shoh me sy tjetër e, në mos qofsha i zoti të bëj ndryshe, sa i humbur qenkam.

Të bëhem “i pasur” është një frazë aq e bukur, edhe e cila thotë një gjë aq të mirë, sa përdorimi i saj është i përbotshëm. Njihet në të gjitha gjuhët: u pëlqen të huajve edhe barbarëve, mbretëron në oborr edhe në qytet, ka shpuar manastiret edhe ka kapërcyer muret e abbacive të njerit e të tjetrit seks; nuk ka vende të shenjtëruara ku të mos ketë hyrë, nuk ka shkreti vetmie ku të jetë e panjohur.

Duke bërë kontratë të re, e duke parë si argjendi po shëmb për ditë thesët e tyre, ca njerëz besojnë më në fund se kanë një kokë të mirë e po thua të zonjën të qeverisë.

Për të fituar pasuri e më tepër një pasuri të madhe, lipset një farë mendje.

S' është as mendja e mirë, as e bukura, as e madhja e as e larta, as e forta, as e holla: nuk di pikërisht se cila mendje lipset, pres të m'a mësojë dikush.

Ai është i pasur, që merr më tepër se sa prish; ai është i vobektë,

shpërdorimet e të cilit teprojnë të ardhurat.

Akshcili, me dy milionë të ardhura, mund të jetë çdo vit i vobektë për gjysmëmilioni.

Në mos harrove gjëkafshë për të bërë begatiën tënde, sa punë! Në harrove më të voglën gjë, sa pendim!

“Sepse atje ku është thesari juaj, atje do të jetë edhe zemra juaj. (Luka 12:34)

Më thuaj: a ka kuptim për të humbur një parajsë për pasuri?

Çfarë i bënë njerëzit të lumtur?

1. Njerëzit të cilët kanë ëndrra dhe dëshira të mëdha, ata janë më të prirë për arritje se sa ata që nuk kanë ndonjë ëndrrë apo dëshirë.
2. Shikoni se sa problem ka në jetën e përditshme.
3. Njerëzit më të lumtur s’i kanë të mirat në çdo gjë, veçse i bëjnë të mirë çdo gjë që ata kanë.
4. Njerëzit e lumtur nuk jetojnë me të kaluarën dhe nuk shqetësohen për të ardhmen. Ata jetojnë për të tashmen.
5. Pranoni gjërat që ju s’mund të ndryshoni.
6. Njerëzit e zgjuar kanë mundësi për të zgjedhur fatin e tyre.
7. Ndershmëria përmirëson gjendjen mendore dhe rrit besimin e të tjerëve tek ju.
8. Gjithmonë të keni kohë për të parë familjen, për të folur me të dashurit dhe miqtë e tu.
9. Është e rëndësishme që të rrini vetëm me njerëz optimist, sepse do t’iu nxisin të keni suksese.
10. Keni kujdes, kur krahasoheni me të tjerët.
11. Zgjidh miqtë të mençur. S’është e mirë në qoftë se je i rrethuar me budallenj.
12. Njerëzit e ditur s’bëjnë shpjegime dhe aq më tepër s’fajësojnë të tjerët për dështimet vetjake, sepse në vend të kësaj ata e pranojnë gabimin dhe mundohen ta përmirësojnë.

13. Mos u shqetësoni për gjëra të vogla
14. Të flasim mirë për të tjerët.
15. Mos e kujto të keqen. Njerëzit e ditur janë të vetëdijshëm se është më mirë që të falin dhe të harrojnë se sa të nxisin gjëra që janë në kundërshtim me ndërgjegjen e tyre.
16. Zgjidheni në të njëjtën kohë për çdo mëngjes, sepse rrit qëndrueshmërinë në punë.
17. Flisni më pak dhe dëgjoni më shumë.
18. Dëgjoni se çfarë thonë bota, por asnjëherë mos kërkon bekimin e tyre.
19. Ndero, për të fituar nderin.

Urdhërimet e Zotit për prindërit

1. Mësoni fëmijët tuaj për të lexuar dhe për të dëgjuar fjalën e Perëndisë. “Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj do të mbeten në zemrën tënde; do t’ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh. Do t’i lidhësh si një shenjë në dorë, do të jenë si shirita midis syve, dhe do t’i shkruash mbi pllakat e shtëpisë sate dhe mbi portat e tua.” (*Ligji i Përtërirë* 6:6-9)
2. Jepi përshtypje fëmijëve dhe ata të jenë të disiplinuar. “Korrigjo birin tënd, ai do të japë rehatinë dhe do t’i sigurojë kënaqësi shpirtit tënd.” (*Fjalët e Urta* 29.17) Ose: “Mësoji fëmijës rrugën që duhet të ndjekë, dhe ai nuk do të largohet prej saj edhe kur të plakët.” (*Fjalët e Urta* 22:6)
3. Mos u nxito, mos u zemëro. “Dhe ju, etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj, por i edukoni në disiplinë dhe në këshillë të Zotit.” (*Efesianëve* 6:4)

Njëmbëdhjetë shenjat e fundit të kohës

1. Kthimi i çifutëve në shtetin e tyre, Izraelin. Çfarë ndodhi 15.5.1948? - Në *Bibël*, sipas *Ezekielit* 37:21, thohet: “Dhe u thuaj atyre: Kështu thotë Zoti, Zoti: Ja, unë do të marr bijtë e Izraelit nga kombet ndër të cilët kanë vajtuar, do t’i mbledh nga çdo anë dhe do t’i çoj përsëri në

vendin e tyre.” Më 15 maj 1948 çifutët u kthyen në vendin e tyre dhe Izraeli u bë shtet. Kjo përmbush këtë profeci biblike.

2. Globalizimi i botës, rendi i ri botëror. *Daniel 7:7*: “Mbas kësaj, unë shikoja në vegime nate, dhe ja një kafshë e katërt e llahtarshme, e tmerrshme, jashtëzakonisht e fuqishme; kishte dhëmbë të mëdha prej hekuri; hante, thërrmonte dhe shtypte kusurin me këmbë; ishte ndryshe nga të gjitha kafshët e mëparshme dhe kishte dhjetë brirë.” *Po aty, 7, 24*: “Dhjetë brirët janë dhjetë mbretër që do të dalin nga kjo mbretëri; mbas tyre do të dalë një tjetër, që do të jetë ndryshe nga të mëparshmit dhe do të rrëzojë tre mbretër.”
3. Udhëtimit dhe njohjet. - *Daniel 12:4*: “Por ti, Danieli, mbaji të fshehura këto fjalë dhe vulose librin deri në kohën e mbarimit; shumë njerëz do ta shfletojnë dhe dituria do të shtohet.” Ne mund të themi vetëm se me shturjen e fluturimeve ajrore që njerëzit udhëtojnë, vërtet vijmë në këtë fazë. Sot është bërë një përmirësim i madh në të gjitha fushat e shkencës dhe të teknologjisë.
4. Rënia morale e njerëzve. - 2 e *Timoteju 3:1-4*: “Dhe dije këtë: në ditët e fundit do të vijnë kohë të vështira, sepse njerëzit do të jenë egoistë, lakmues parash, mburravecë, krenarë, blasfemues, të pabindur ndaj prindërve, mosmirënjohës, të paudhë, të padhembshur, të papajtueshëm, shpifës, të papërmbajtur, mizorë, që s’e duan të mirën, tradhtarë, kokëshkretë, fodullë, dëfrimdashës më fort se perëndidashës.” *Po aty 3:12,13*: “Të gjithë ata që duan të rrojnë me perëndishmëri në Krishtin Jezus do të përndiqen, por njerëzit e këqij dhe mashtrues do të shkojnë keq e më keq, duke gënjyer dhe duke u gënjyer vetë.”
5. Humbja e dashurisë. - Sipas Ungjillit të Mateut 24:12 thuhet: “Dhe, duke qenë se paudhësia do të shumohet, shumëkujt do t’i ftohet dashuria.” Sot njeriu modern është egoist, lakmues dhe i pamoralshëm, siç është kjo profeci biblike.
6. Rritja e popullsisë botërore. - *Zanafilla 1:28*: “Dhe Perëndia i bekoj; dhe Perëndia u tha atyre: “Të jeni të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën e nënshtrojeni, e sundoni mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit dhe mbi çdo qenie që lëviz mbi tokë.”

7. Ungjillizimi i botës. - *Marku* 13, 10: “Por më parë duhet që t’u përhapet ungjilli gjithë popujve.” Te *Mateu* 24:14 thuhet: “Dhe ky ungjill i mbretërisë do të predikohet në gjithë botën si një dëshmi për gjithë kombet, dhe atëherë do të vijë mbarimi.” Sot për sot ungjilli përhapet me shpejtësi, sepse janë disa faktorë që e bëjnë të mundur: shtypi, televizioni, por edhe njerëzit që shkojnë derë më derë. Dhe në fund prapë te *Mateu* 24:34: “Në të vërtetë po ju them se ky brez nuk do të kalojë, pa u realizuar të gjitha këto.”
8. Tërmeti, lufta dhe uria. - Sipas *Markut* 13:7-8: “Por, kur të dëgjoni të flitet për luftëra dhe për ushtime luftërash, mos u shqetësoni; sepse këto gjëra duhet të ndodhin; por nuk do të jetë ende mbarimi. Në fakt do të ngrihet kombi kundër kombit dhe mbretëria kundër mbretërisë; do të ndodhin tërmete në vende të ndryshme, zi buke dhe turbullira. Këto gjëra nuk do të jenë tjetër veçse fillimi i dhembjeve të lindjes.”
9. Bota është në errësirë. - *Gjoni* 3:19: “Tani gjykimi është ky: Drita erdhi në botë dhe njerëzit deshën errësirën më tepër se dritën, sepse veprat e tyre ishin të mbrapshta.” Bota pa Jezusin është në errësirë. Le ta citojmë prapë *Gjonin* 8:12: “Dhe Jezusi u foli atyre përsëri duke thënë: “Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës.”
10. Shkelje ligjesh: “Dhe, duke qenë se paudhësia do të shumëhohet, shumëkujt do t’i ftohet dashuria; por ai që do të ngulmojë deri në fund do të shpëtohet.” (*Mateu* 24:12-13).
11. Ndjekja e të krishterëve: “Atëherë do t’ju dorëzojnë në mundime dhe do t’ju vrasin; dhe të gjithë kombet do t’ju urrejnë për shkak të emrit tim. Atëherë shumë do të skandalizohen, do ta tradhëtojnë njeri tjetrin dhe do të urrejnë njeri tjetrin.” (*Mateu* 24:9-10) *Zbulesa* 11:18: “Kombet ishin zemëruar, por erdhi mëria jote, dhe erdhi koha që të gjykohen të vdekurit dhe t’u jepet paga shërbëtorëve të tu, profetëve, dhe shenjtorëve, dhe atyre që druajnë emrin tënd, të vegjëleve dhe të mëdhenjve, dhe të shkatërrosh ata që shkatërrojnë dheun.” Të gjitha këta gjëra provojnë se po jetojmë në ditët e fundit të kësaj bote.

Për të qenë njeri i mirë

Mos humb kohë me njerëz të humbur! Mos e gënje vetveten! Mos u bë dikushi që nuk je! Mos u përpjek që të mbahesh në të kalurën! Mos u frikëso se do të bësh një gabim! Ruaje veten nga gabimet e shkuara! Mos u nxit për të blerë lumturinë! Mos kërko për të tjerët lumturinë kur se ke për vete! Mos rri i papunë! Mos rri duke menduar se nuk je gati! Mos u përfshi në gjëra të huaja! Mos ngurro për shoqëri të re! Mos vepro kundër të gjithëve! Mos u bë xheloz për të tjerët! Mos mbaj mëri! Të mos kesh zili! Mos humb kohë duke shpjeguar vetveten! Mos u mundo se do të bësh vetëm gjëra të përsosura! Mos rrah ujë në havan! Mos fajëso të tjerët për hallet tuaja! Mos u bë jobesimtar!

Yoga dhe muzika rap

Për shqiptarët nuk është Yoga. Ajo vjen nga India dhe i ka rrënjët në hinduizëm. Yoga në shfaqje është një cikël ushtrimesh, kurse në fakt është një formë e re e fesë. Mënyra më e mirë për mistifikimin e fesë me anë të ushtrimeve.

Për shqiptarët nuk është muzika rap. Në *Bibël* te *Letra e parë e Korintasve* thuhet: “Pra, nëse hani, nëse pini, nëse bëni ndonjë gjë tjetër, të gjitha t’i bëni për lavdinë e Perëndisë.” Këngët që flasin rreth kurvërisë dhe mallkimeve (vëshame) janë mëkat. Mëkati na çon në ferr, apo jo!

Çfarë është parajsë?

Le të shohim se çfarë premtimi ka dhënë Krijuesi Ynë sipas Biblës së shenjtë? –“Sepse ja, unë krijoj qiej të rinj dhe një tokë të re, dhe gjërat e mëparshme nuk do të kujtohen më dhe nuk do të vijnë më në mëndje. Por ju gëzohuni dhe ngazëllohuni përjetë për atë që krijoj; sepse, ja, unë krijoj Jeruzalemin për kënaqësinë dhe popullin e tij për gëzimin. Do të kënaqem me Jeruzalemin dhe do të gëzohem me popullin tim; në të nuk do të dëgjohet më asnjë zë vaji ose zë klithme. (*Isaia* 65:17-19); - “Dielli nuk do të jetë më drita jote gjatë ditës, as hëna nuk do të të ndriçojë më me vezullimin e saj; por Zoti

do të jetë drita jote e përfjetshme dhe Perëndia yt lavdia jote. Dielli yt nuk do të perëndojë më dhe hëna jote nuk do të tërhiqet më, sepse Zoti do të jetë drita jote e përfjetshme dhe ditët e tua të zisë do të marrin fund. (Isaia 60:19, 20); Dhe pashë një qiell të ri dhe një dhe të ri; sepse qielli i parë dhe dheu i parë kishin shkuar, dhe deti nuk ishte më. Dhe unë, Gjoni, pashë qytetin e shenjtë, Jeruzalemin e ri, që zbriste nga qielli, nga Perëndia, që ishte bërë gati si nuse e stolisur për burrin e vet. Dhe dëgjova një zë të madh nga qielli që thoshte: “Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi e tyre. Dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre; dhe vdekja nuk do të jetë më; as brengë, as klithma, as mundim, sepse gjërat e mëparshme shkuan.” Dhe ai që rrinte mbi fron tha: “Ja, unë i bëj të gjitha gjërat të reja.” Dhe më tha: “Shkruaj, sepse këto fjalë janë të vërteta dhe besnike.” Edhe më tha: “U bë! Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi! Atij që ka etje unë do t’i jap si dhuratë nga burimi i ujit të jetës.” (Zbulesa 21:1-6); “Muri ishte bërë ishte prej diaspri; dhe qyteti ishte prej ari të kulluar, i ngjashëm me kristal transparent. Themelet e murit të qytetit ishin stolisur me gjithfarë gurësh të çmuar; themeli i parë ishte prej diaspri, i dyti prej safiri, i treti prej kalcedoni, i katërti prej smeraldi, i pesti prej sardoniku, i gjashti prej sardi, i shtati prej krizoliti, i teti prej berili, i nënti prej topazi, i dhjeti prej krizopazi, i njëmbëdhjeti prej hiacinti, i dymbëdhjeti prej ametisti. Dhe të dymbëdhjetë portat ishin dymbëdhjetë margaritarë, secila portë ishte bërë prej një margaritari të vetëm, edhe sheshi i qytetit ishte prej ari të kulluar, si kristal i transparent. Dhe nuk pashë asnjë tempull në të; sepse Zoti Perëndi i plotfuqishëm dhe Qengji janë tempulli i tij. Dhe qyteti nuk ka nevojë për diell, as për hënë që të ndriçojnë në të, sepse lavdia e Perëndisë e ndriçon atë, dhe llamba e tij është Qengji. Dhe kombet e të shpëtuarve do të ecin në dritën e tij; dhe mbretërit e dheut do të sjellin lavdinë dhe nderin e tyre në të. Dhe portat e tij nuk do të mbyllen asnjëherë gjatë ditës, sepse nuk do të ketë asnjëherë natë. Edhe në të do të sjellin lavdinë dhe nderin e kombeve. Edhe nuk do të hyjë asgjë e papastër dhe askush që kryen neveri e gënjeshtër, por vetëm ata që janë të shkruar në librin e jetës të Qengjit.” (Zbulesa 21:18-27)

Mjerë ju, kur të gjithë njerëzit do të flasin mirë për ju!

Në të shenjtën *Bibël* shkruhet: “Ne dimë se jemi nga Perëndia dhe se gjithë bota dergjet në ligësi.” (1 e Gjonit 5:19); - “Mjerë ju, kur të gjithë njerëzit do të flasin mirë për ju, sepse në të njëjtën mënyrë vepruan etërit e tyre me profetët e rremë.” (Luka 6:26); - “O shkelës dhe shkelëse të kurorës, a nuk e dini se miqësia me botën është armiqësi me Perëndinë? Ai, pra, që don të jetë mik i botës bëhet armik i Perëndisë.” (Jakobi 4:4); - “Në qoftë se ju fyejnë për emrin e Krishtit, lum ju, sepse Fryma e lavdisë dhe Fryma e Perëndisë prehet mbi ju; nga ana e tyre ai blasfemohet, kurse nga ana juaj ai përlëvdohet.” (1 e Pjetrit 4:14); - “Mos u çuditni, vëllezër të mi, nëse bota ju urren.” (1 e Gjonit 3:13) kurse Jezu Krishti ka thënë: “Nëse bota ju urren, ta dini se më ka urrer mua para jush. Po të ishit nga bota, bota do të donte të vetët; por sepse nuk jeni nga bota, por unë ju kam zgjedhur nga bota, prandaj bota ju urren.” (Gjoni 15:18, 19); - “Ju jeni prej Perëndisë, o djem të rinj, dhe i keni mundur ata, sepse ai që është në ju është më i madh se ai që është në botë.” (1 e Gjonit 4:4).

Një fjalë e urtë e Albert Guinonit është: “Kur të gjithë janë kundër jush kjo do të thotë që ju jeni tërsisht i gabuar ose tërsisht i drejtë.”

Jeta pa Zotin

Të gjithë ata që nuk e njohin Perëndinë, ata kanë një gropë të thellë në zemrën e tyre. Ata janë duke u përpjekur për të mbushur me: pasuri, alkool, duhan, drogë, kurvëri dhe me shumë vese të tjera të liga. Veçse zemra e tyre është ende e zbrazët. Të mos harrojmë se zemra e njeriut mund të mbushet vetëm me Frymën e Shenjtë. Nëse ju jeni me Perëndinë, zemra juaj është e plotë dhe me pak ju jeni të kënaqur. Ne jemi shumë të shpejtë për të sharë njëri-tjetrin, t'i themi një fjalë të keqe, ta lëndojmë ose edhe më keq ta vrasim. Ky është një mëkat dhe një turp i madh përpara Perëndisë. Të gjithë njerëzit janë krijesa të Zotit dhe të gjithë jemi mëkatarë, por veçse Perëndia na do në mënyrë të barabartë. E për këtë, pra, ne duhet të respektojmë njëri-tjetrin. As ka thënë Perëndia: “Ai duke u përgjigjur tha: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë forcën tënde dhe me gjithë mendjen tënde, edhe të afërmin tënd porsì vetveten.” (Luka 10:27)

A shkojnë të gjithë njerëzit e botës para gjykimit të Perëndisë?

Jezusi ka thënë: “Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Ai që e dëgjon fjalën time dhe beson në atë që më ka dërguar, ka jetë të përjetshme, dhe ai nuk vjen në gjyq, por ka kaluar nga vdekja në jetë.” (*Gjoni 5:24*)

Siç e kemi parë, ata që janë me Jezusin, nuk shkojnë në gjykimin e Perëndisë. Të gjithë ata që shkojnë përpara gjykimit të Perëndisë, ata nuk kanë asnjë rast për të shkuar në qiell, sepse hiri i Perëndisë nuk do të jetë i pranishëm në gjykatë. Nëse ju nuk përgatiteni tani për ardhjen e Jezusit, nesër mund të jetë tepër vonë.

X. MISCELLANES

Shkenca sipas Darvinit thotë se njeriu e ka prejardhjen nga majmuni. Një gjë e tillë s'është e vërtetë. Nga ana tjetër shkenca deri më sot s'ka arritur ta thotë fjalën e saj se ndonjë majmun është bërë njeri. E dihet se majmunët janë kafshë pa mend.

Perëndia krijoi njeriun e parë. - Në *Bibël* thuhet: “Pastaj Perëndia tha: “Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne, dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe”. Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën.” (*Zanafilla* 1:26-27)

Si e krijoi Perëndia Adamin? - “Atëherë Zoti Perëndi formoi njeriun nga pluhuri i tokës, i fryu në vrimat e hundës një frymë jete, dhe njeriu u bë një qenie e gjallë.” (*Zanafilla* 2:7)

Si e krijoi Perëndia Evën? - “Pastaj Zoti Perëndi tha: “Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm; unë do t'i bëj një ndihmë që i leverdis.” (*Zanafilla* 2:18); - “Atëherë Zoti Perëndi e futi në një gjumë të thellë njeriun, të cilin e zuri gjumi; dhe mori një nga brinjët e tij dhe e mbylli mishin në atë vend. Pastaj Zoti Perëndi me brinjën që i kishte hequr njeriut formoi një grua dhe e çoi te njeriu.” (Po aty, 2:21-22)

Siç shihet shkurt e shqip: Bibla e tregon qartë se njerëzit s'e kanë prejardhjen nga kafshët, por ne jemi krijim i Zotit.

Çfarë është jeta jonë?

Në fillim plani i Krijuesit tonë ishte që të kemi jetë të përvetshme. Çuditërisht njeriu i parë ra në mëkat dhe me këtë njerëzimi e humbi jetën

e përjetshme. Mëkati i tij solli vdekjen. Perëndia s'kishte dëshirë që ne të vdisnim. Zoti na thërret që të kthehemi tek Ai. E dihet që jeta jonë është tepër e shkurtër. Me një fjalë, sot jemi e nesër mund të mos jemi. Detyra jonë më e rëndësishme në këtë tokë është të përgatisim veten dhe familjen për të shkuar në qiell. Le Bryer mendonte:

Nuk ka gjë të cilën njerëzit duan ta mbajnë më tepër, edhe të cilën e kursejnë më pak, se jetën e vet.

Të gjitha të ligat tona vijnë duke mos mundur të jemi vetëm: prandaj kërkojmë lodrat e fatit; shpërdorimi i tepërt i detyrës; pijet alkoolike; gratë dhe më në fund është padia jonë që ta harrojmë vetveten dhe Perëndinë.

Pothuajse shumica e njerëzve përdorin të parën pjesë të jetës së tyre për të bërë pjesën tjetër të mëshirshme.

Në qoftë se jeta është e mëshirshme, është vështirë të durohet; në qoftë e është jeta e lumtur, është tmerrshme të humbet. Që të dyja një janë.

Gjuha vret: Ne duhet t'i shikojmë të dashurit tanë, sepse ne mund t'i lëndojmë me fjalë të liga. Nëse e lëndoni plagën e dikujt, e keni për detyrë për ta shëruar atë. E kur të vijë koha për ta shëruar, ndoshta mund të jetë tepër vonë. Mund të ndodh ndarja, ose e gruaja mund të pësojë ndonjë sëmundje nga stresi. Jetën për ta rregulluar e keni në duart e tuaja.

Mos u ankoni vazhdimisht me ata që jetoni, sepse do të bëhesh i mërztishëm dhe i padurueshëm. Kjo lloj jete do t'i sjellë bashkëshortes stres e, pastaj do të përfundoni në ndarje. Është mirë që të mos jesh i mërztishëm në familje apo edhe në shoqëri.

Armiku ynë

Njeriu është armiku më i madh i vetvetes. Njerëzit kanë nevojë për t'u ruajtur nga vetvetja, se sa prej ndonjë prej armiqve të tyre. Ndodh shpeshherë që ta vëjmë veten në një situatë të rrezikshme. Si duhet ta luftojmë vetveten? Padyshim, se kjo luftë mund të fitohet vetëm me ndihmën e Perëndisë. Ja pse duhet t'i lutemi Perëndisë, me qëllim që të ndryshojmë krejtësisht.

Jemi komb i ndarë në disa shtete. Duam bashkim kombëtar, sepse shqiptarët e bashkuar do të zënë një vend të rëndësishëm në Ballkan.

Çfarë duhet që bashkimi kombëtar të jetë i mundshëm?

Duhet të kemi më shumë dashuri. Duhet të jemi më të lidhur njëri me tjetrin. E këta sot për sot na mungojnë. Për atë armiku ka hyrë lehtë në

mesin tonë. A është thënë se delja e ndarë nga kopeja përfundon lehtë në gojë të ujkut. Armiku i shqiptarit është vetë shqiptari. Ka ardhur koha për të ndryshuar: është turp përpara Perëndisë.

Kombi shqiptar duhet të kenë një flamur, një gjuhë, një zemër, një besim, një shpirt dhe një dashuri që na bashkon!

Fjalët e hallkut

Shumë njerëz janë të përditshëm. Ata vazhdimisht shqetësohen në lidhje me shqetësimet e njerëzve të tjerë në një kuptim të lig. Nga këta njerëz, ne duhet të kemi kujdes, për shkak se ata kanë një praktikë për të ulur njerëzit në nivelin e tyre të ulët. Pra, mos i kushtoni vëmendje njerëzve çfarë thonë për ju. Ata do të jenë më të fyer nëse ne nuk do t'i përgjigjem më fjalë.

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit thuhet: “A fola a s’fola, goja nuk vulosë gjã. Fjalët e sterqive kanuja s’i merr para sysh.”

Le t’i shënojmë ca fjalë të urta: Zapi i gjuhës shumë herë është pshtimi i kokës; Fjalët e hallkut e birat e gardhit nuk mbyllën kurrë; Në mos do dreqi të largohet, largohu ti; Dikush bënë çka di, e dikush di çka bënë; Ka njerëz që më shumë i gëzohen rrezikut të huaj se sa gëzimit të tyre; Njerëzit janë vetëm fëmijë të rritshëm; Gojën kapak e rri pa marak; Kafshatën përtype një herë, fjalën dhjetë herë; Fjalët peshoi, mbasandej lëshoi; Mos fol shpesh, se dikush të përqesh; Fjalët e mira merri, e të këqijat treti; Kur s’ke nevojë, mos e hapë gojën; Kush s’din me heshtë, s’din as me kuvend; Kush kuvend shumë dinë pak; Sa më e rrallë të jetë fjala është më e fortë; Kalit i ka hije shala, e burrit fjala; Fjala e mirë të shpëton, e keqja të verbon dhe në fund Mark Doshi thoshte se fjalët duhen peshuar dhe jo të numrohen.

Kush i kontrollon mendimet tona?

Sot në botë ekzistojnë dy fuqi që mund të na kontrollojnë. Njëra është fuqia e Perëndisë e, që është fuqia e Frymës së Shenjtë kurse tjetra është fuqia e djallit. Gjithçka varet nga ne: të dëgjojmë Perëndinë apo të dëgjojmë djalli. E Perëndia na mëson gjithmonë për të punuar si duhet: si ta mbajmë shëndetin, si ta mbajmë familjen, si të punojnë, si të dëgjojnë, si të durojmë, si të respektojmë dhe si të ndihmojmë. Prej Perëndisë kemi

shëndet, shpresë, besim dhe dashuri. Po djalli gjithmonë na mëson të kundërtën: si ta shkatërrojmë shëndetin, si ta shkatërrojmë familjen, si të mirën ta kthejmë me të keqe dhe kështu me radhë. Në *Bibël* thuhet “Zoti të varfëron dhe të pasuron, ai të poshtëron dhe ai të lartëson.” (1 e *Samuelit* 2:7); - “I përmbysi pushtetarët nga fronat e tyre dhe i ngriti të përlulurit.” (Luka 1:52); - “Dhe Perëndia mund të bëjë që gjithë hiri të teprojë për ju, aq sa mbasi të keni gjithnjë mjaft në çdo gjë, t’ju tepërojë për çfarëdo pune të mirë.” (2 e *Korintasve* 9:8); - “Sepse Zoti Perëndi është diell dhe mburojë; Zoti do të japë hir dhe lavdi; ai nuk u refuzon asnjë të mirë atyre që ecin drejt.” (*Psalmet* 84:11).

Rreziku ynë

Pse e vëjmë jetën në rrezik? Disa nga shkaqet që e rrezikojnë jetën tonë 1) mënyra e të ushqyerit; 2) shoqëria e keqe; 3) rrugët e këqija - ka shumë vende ku s’duhet të shkohet; 4) Kurvëria, droga, bixhozi; 5) fjalori i ndyrë; 6) pasuria - njerëzit bëjnë gjithçka për t’u pasuruar; 7) fuqia - njerëzit bëjnë gjithçka për të ardhur në pushtet; 8) martesë e keqe; 9) nxitimi - nxitohemi në fjalë e nxitohemi me makinë e këta janë veprime të njerëzve të krisur; 10) mëkati - djalli ka fuqi mbi ne; 11) mosbesimi në Perëndinë - e kur ne humbasim besimin në Zot atëherë rreziku është afër nesh.

Le t’i shënojmë ca fjalë të urta: Kur e bënë vet, mos më thuaj çka më gjetë; Të gjithë rreziqet vijnë prej andej ku s’ka besim e dashuri; Trim është vetëm që dinë me duru rrezikun.

Pjesa dërmuse e rreziqeve vijnë nga mëkati, sepse mëkati prekë aty ku dhembë më së shumti: në shëndet dhe në familje. Të mos harrojmë: Perëndia s’mund të ndalojë rrezikun që ne e kemi përgatitur.

Krimi

Krimi s’paguhet në asnjë llojë mënyre. Disa shqiptarë, në mbarë botën, janë të përfshirë në krim: kurvëri, trafikim droge, korrupsion dhe vrasje. Këta të gjerë duket se kanë harruar se Perëndia sheh çdo gjë dhe se këta mëkatarë një ditë do të japin përgjigje përpara Perëndisë për veprimet e tyre të fëlliqura. Perëndia i shikon vetëm se çfarë bëjnë këta matrapazë deri

në ditën e fundit. E Perëndia do t'i ndëshkojë për ligësitë e tyre në ditën e gjykimit. “Sepse Perëndia do të vërë të gjykohej çdo vepër, edhe çdo gjë që është fshehur, qoftë e mirë apo e keqe.” (*Predikuesi* 12:14). Hiqni dorë nga krimi po qe se dëshironi të shpëtoni shpirtin tuaj. “Po t'i rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi. Po të themi se s'kemi mëkatuar, e bëjmë atë gënjeshtar dhe fjala e tij nuk është në ne.” (*1 e Gjonit* 1:9).

Këshillë për udhëheqësit e popullit shqiptar

Që të jetë kombi shqiptar i përparuar deomos duhet të ketë udhëheqës të mirë. Sot për sot populli ynë s'ka fat të ketë udhëheqës të përshtatshëm. Sikurse në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë dhe viset shqiptare udhëheqja nuk ka respekt të mjaftueshëm për popullin, sepse janë të zënë më shumë me interesat vetjake. Udhëheqësi është zgjedhur për t'i shërbyer popullit, e jo populli për t'i shërbyer atij. Shteti ekziston për njerëzit, e jo njerëzit për shtetin. S'duhet të lejojmë që armiku t'i zgjedhë udhëheqësit tanë, për shkak se liderët e tillë s'do të jenë për shqiptarë. Sot bota perëndimore ka një ndikim të jashtëzakonshëm për të zgjedhur liderët tanë. Populli ynë duhet të vetëdijsohet për ata që i voton.

Në viset shqiptare ku shqiptarët janë pakicë s'kanë nevojë të kenë shumë parti politike. Kjo është ideja e armiqve tanë, sepse në këtë mënyrë pakësojnë deputetët shqiptarë në parlamentin e tyre. Ne kemi nevojë për një parti dhe një njeri të ndershmë në pushtet. Ne kemi nevojë për një person pa ndonjë interes personal, sepse kur pushtetari të vdesë s'do ta marrë pushtetin me vete, përpos një kostumi.

Pasuria

Pasuria, siç është e mirë, po aq mund të jetë e keqe. Ju duhet të kujdeseni për veten, sepse pasuria mund të bëhet një vrasës i karakterit tuaj. Ne nuk jetojmë për të punuar, por të punojmë për të jetuar. Ne s'duhet të humbasim familjen apo shëndetin për pasuri.

Në *Bibël* thuhet: “Pasuria e përftuar në mënyrë jo të ndershme do të katandiset në pak gjëra, por atij që e grumbullon me mund do t'i shtohet ajo.” (*Fjalët e urta* 13:11); - “Dhe tani ju, o pasanikë: qani dhe vajtoni për

të këqijat që do t'ju zënë! Pasuria juaj u kalb dhe rrobat tuaja i brejti tenja. Ari dhe argjendi juaj u ndryshkën, dhe ndryshku i tyre do të jetë një dëshmi kundër jush dhe do t'ju përpijë mishërat si zjarr; keni mbledhur thesare në ditët e fundit. Ja, paga që u keni ngrënë puntorëve që ju korren arat, po këlthet; dhe klithmat e atyre që korren, arritën në vesh të Zotit të ushtrive. Jetuat mbi tokë ndër qejfë dhe shkapërderdhje; i ushqyet zemrat tuaja si për ditë të të therurit. Dënuat dhe vratë të drejtin: ai nuk ju kundërshtoi.” (Jakobi 5:1-6); - “Pasuritë nuk sjellin dobi ditën e zemërimit, por drejtësia të shpëton nga vdekja.” (*Fjalët e urta* 11:4); - “Kush ka besim në pasuritë e tij do të rrëzohet, por të drejtët do të çelin si gjethe.” (*Fjalët e urta* 11:28); - “Kush është i dhënë pas parasë, nuk ngopet kurrë me para, dhe kush dëshiron pasuritë nxjerr përfitim prej tyre. Edhe kjo është kotësi.” (*Predikuesi* 5:10); - “Është një e keqe tjetër e vajtueshme që kam parë nën diell: pasuritë e ruajtura për pronarin e tyre në dëm të tij.” (*Predikuesi* 5:13); - “Dikujt Perëndia i ka dhënë pasuri, të mira dhe lavdi, dhe nuk i mungon asgjë nga gjithë ato që mund të dëshirojë, por Perëndia nuk i jep mundësinë t'i gëzojë, por i gëzon një i huaj. Kjo është kotësi dhe një e keqe e madhe.” (*Predikuesi* 6:2); - “Dishepujt u habitën shumë nga këto fjalë të tij. Por Jezusi foli përsëri dhe u tha atyre: “O bij, sa e vështirë është që të hyjnë në mbretërinë e Perëndisë ata që mbështeten te pasuria.” (*Marku* 10:24); - “Dhe nëse njëri ka të mirat e kësaj bote dhe sheh të vëllanë që është në nevojë dhe e mbyll zemrën e tij, si qëndron në të dashuria e Perëndisë?” (*1 e Gjonit* 3:17); - “Porositi të pasurit e kësaj bote të mos jenë krenarë, dhe të mos i mbajnë shpresat në pasurinë që është e pasigurt, por në Perëndinë e gjallë, i cili na jep gjithçka bujarisht për ta gëzuar, të bëjnë të mira, të bëhen të pasur në vepra të mira, të jenë bujarë dhe të gatshëm për të dhënë, duke mbledhur si thesar një themel të mirë për të ardhmen, për të arritur jetën e përjetshme.” (*1 e Timoteut* 6:17-19); - “Sepse atje ku është thesari juaj, atje do të jetë edhe zemra juaj.” (*Luka* 12:34).

Le t'i shënojmë ca fjalë të urta: Parja mund ta blejë shtratin, por jo gjumin; Paraja mund ta blejë orën, por jo kohën; Paraja mund ta blejë librin tënd, por jo dijen; Paraja mund ta blejë pozitën tënde, por jo respektin; Paraja mund ta blejë ilaçin, por jo shëndetin. Paraja mund ta blejë gjakun, por jo jetën. Paraja mund ta blejë seksin, por jo dashurinë. Paraja mund t'i blejë të gjitha kënaqësitë e kësaj bote, por jo parajsën.

Sot njerëzit në mbarë botën përdorin çdo mjet për t'u pasuruar. Mos harroni kjo jetë është e shkurtër dhe jeta në qiell është e përjetshme.

Për shkak se nuk ka të mirë për të humbur jetën e përjetshme për një kënaqësi të shkurtër në këtë botë.

Të këqijat

E keqja fillon ngadalë. Lufta fillon me një plumb. Sëmundja fillon nga një pa kujdesi. Nga një fjalë nis sherri, e nga sherri vjen vrasja. Me një cigare fillon pirja e duhanit. Me një gotë të alkoolit fillon dehja. Me një provë, fillon marrja e drogës. Me një person fillon kurvëria. Nga një pakujdesi vjen aksidenti. Djalli dëshiron ta provoni të keqen dhe pastaj ai bënë shumimin. Mos i provoni gjëra që nuk janë për ju, sepse në qoftë se i provoni s'do të jeni në gjendje për të mbrojtur veten. Gjëra e këqija të shkatërrojnë. Vetëm më pak vëmendje, problemi i madh nuk do të ndodhë.

Budallai dhe i marri

Si duken në letërsinë popullore: Mos u fjalos me budallën se njerëzit, ndoshta s'kanë me dijtë ndryshimin; S'ka njeri në botë që pranon se është budalla; Për budallën nuk ka ilaç; Prej budallait nafaka ikën; Budallait njerëzit i duken të marrë; Budallai pëlqen vetëm mendjen e vet; Vetëm budallai është i kënaqur gjithmonë nga vetja; Një njeri i mençur merrë vendimet e veta - budallai pranon opinionin publik kurse Anjshtani thoshte: Dy gjëra janë të pafundme: universi dhe budallallëku njerëzor. Me njeri të marrë mos u ba kumbarë; Njerëzit e marrë gjithçka dijnë; I marri paraqitet vet; Po nuk foli i marri, nuk dallohet nga i urti.

Liria

Ne duhet të kuptojmë se nuk jetojmë në parajsë, por në tokë. Mbi tokë nuk mund të kemi lirinë e plotë, sepse djalli e kontrollon botën sot. Në *Biblën* e shenjtë shkruhet: “Mjerë ju banorë të tokës e të detit, sepse zbriti djalli drejt jush duke pasur zemërim të madh, duke ditur se ka pak kohë.” (*Zbulesa* 12:12). Ndodh shpeshherë që njeriu humbet lirinë e tij, duke bërë atë që është në përputhje me vullnetin e tij edhe nëse është e drejtë apo jo. Perëndia

ka keqardhje për të humburit: “U thuaj atyre: Ashtu siç është e vërtetë që unë rroj,” thotë Zoti, “unë nuk kënaqem me vdekjen e të pabesit, por që i pabesi të ndryshojë rrugën e tij dhe të jetojë; konvertohuni, konvertohuni nga rrugët tuaja të këqija. Pse vallë duhet të vdisni, o shtëpi e Izraelit?” (Jezekeli 33:11); - “Unë në fakt nuk ndjej asnjë kënaqësi me vdekjen e atij që vdes” thotë Zoti. Zoti. “Ndërroni rrugë, pra, dhe do të jetoni.” (Ezekieli 18:32).

Mos e ndërto rrugën drejt ferrit! Perëndia dëshiron që ne të ndryshojmë: “Shumë të dashur, unë ju këshilloj, si të huaj dhe shtegtarë, të hiqni dorë nga lakmitë e mishit, që luftojnë kundër shpirtit. Silluni mirë ndër johebrenjtë, që aty ku do t’ju paditin si keqbërës, të përlëvdojnë Perëndinë ditën e ardhjes së tij, për shkak të veprave tuaja të mira. Nënshtrohuni, pra, për hir të Zotit, çdo pushteti njerëzor, qoftë mbretit, si më të lartit, qoftë qeveritarëve, si të dërguar prej tij për të ndëshkuar keqbërësit dhe për të lavdëruar ata që bëjnë të mirën, sepse ky është vullneti i Perëndisë, që ju, duke bërë mirë, t’ia mbyllni gojën paditurisë së njerëzve të pamend. Silluni si njerëz të lirë, por jo duke përdorur lirinë si një pretekst për të mbuluar ligësinë, por si shërbëtorë të Perëndisë. Nderoni të gjithë, doni vëllazërinë, druani Perëndinë, nderoni mbretin.” (1 e Pjetrit 2:11:17); - “Që të zhvisheni, për sa i takon sjelljes së mëparshme, nga njeriu i vjetër që korruptohet me anë të lakmive të gënjeshtres, dhe të përtëriteni në frymën e mendjes suaj dhe të visheni me njeriun e ri, të krijuar sipas Perëndisë në drejtësinë dhe shenjtërinë e së vërtetës. Prandaj, duke e lënë mënjane gënjeshtren, secili t’i thotë të vërtetën të afërmit të vet, sepse jemi gjymtyrë, njeri me tjetrin. Zemërohuni dhe mos mëkatoni; dielli të mos perëndojë mbi inatin tuaj; dhe mos i jepni vend djallit. Ai që vidhte, le të mos vjedhë më, por më tepër të mundohet duke bërë ndonjë punë të mirë me duart e veta, që të ketë t’i japë diçka atij që ka nevojë. Asnjë fjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por ajo që është e mirë për ndërtimin, sipas nevojës, që t’u japë hir atyre që dëgjojnë. Dhe mos e trishtoni Frymën e Shenjtë të Perëndisë, me të cilin u vulosët për ditën e shpengimit. Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njëri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin.” (Efesianëve 4:22-32).

*Mos i lëni, mëkatet e tuaja,
pa i pranuar, e pa i pastruar.
Se me mëkat, s’mundet askush,
në parajsë, askurrë me shkua.*

Çfarë duhet ne të ndryshojmë?

1. Duhet mbajtur urdhërimet e Perëndisë. - “Sepse kjo është dashuria e Perëndisë: që ne të zbatojmë urdhërimet e tij; dhe urdhërimet e tij nuk janë të rënda.” (1. e Gjonit 5:3).
2. Duhet ta ruajmë martesën. - “Martesa të nderohet nga të gjithë dhe shtrati martesor i papërlyer, sepse Perëndia do të gjykojë kurvarët dhe kurorëshkelësit.” (Hebrenjve.13:4)
3. Ne kemi nevojë për të pastruar ushqimin tonë dhe pijen. Ata që janë me Perëndinë, nuk duhet të hajnë ushqime biblikisht të pa lejueshme. Trupi i pastër, shpirti i pastër.
4. Ne duhet të ruhem nga mëkatet.
5. Ne kemi nevojë për të punuar, me qëllim që të mos jetojmë në kurriz të dikujt.
6. Mos vidh! Mos vidh asgjë, as nga të pasurit dhe as nga të varfërit. Mos vidh as nga nevoja e as nga qejfi. Për vjedhje nuk ka asnjë shfajësim, hajdutëria është mëkat.
7. Nuk do të vrasësh! Ne kemi marrë jetën nga Krijuesi Ynë, prandaj ne nuk kemi të drejtë të marrim jetën e askujt. Nxjerrja e fëmijës nga nëna është vrasje. Aborti është një mëkat, sepse plani i Zotit është ndërprerë.
8. Ne kemi nevojë për të pastruar fjalorin tonë. - “Kush kontrollon gojën e tij mbron jetën e vet, por ai që i hap shumë buzët e tij shkon drejt shkatërrimit.” (Fjalët e urta 13:3); - “Mos u nxito me gojën tënde, dhe zemra jote të mos shpejtohet të thotë asnjë fjalë përpara Perëndisë, sepse Perëndia është në qiell dhe ti mbi tokë; prandaj fjalët e tua të jenë të pakta.” (Predikuesi 5:2); - “Bëhuni pra imitues të Perëndisë, si bij shumë të dashur, edhe ecni në dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi dhe e dha veten e tij për ne, si ofertë e flijim Perëndisë, si një parfum erëmirë. Por, ashtu si u ka hije shenjtorëve, as kurvëria, as ndonjë papastërti, as kurnacëri të mos zihet në gojë midis jush; as pandershmëri, as të folur pa mend e të përqeshur, të cilat nuk kanë hije, por më tepër të ketë falenderime.” (Efesianëve 5:1-4); - “Asnjë fjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por ajo që është e mirë për ndërtimin, sipas nevojës, që t’u japë hir atyre

që dëgjojnë. Dhe mos e trishtoni Frymën e Shenjtë të Perëndisë, me të cilin u vulosët për ditën e shpengimit. Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njëri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin.”(*Efesianëve* 4:29-32); - “Edhe gjuha është një zjarr, një botë paudhësie; ajo është vendosur midis gjymtyrëve tona, gjuha e fëlliq gjithë trupin, ndez ecjen e natyrës dhe ndizet nga Gehena.” (*Jakobi* 3:6); - “Tashmë fundi i të gjithave u afrua; jini, pra, të përkorë dhe rrini zgjuar për t’iu kushtuar lutjeve. dhe të keni para së gjithash një dashuri të madhe për njëri-tjetrin, sepse “dashuria do të mbulojë një shumicë mëkatesh.” (*1 e Pjetrit* 4:7, 8).

9. Jini të durueshëm! - “Merrni edhe përkrenaren e shpëtimit dhe shpatën e Frymës, që është fjala e Perëndisë, duke u lutur në çdo kohë dhe me çdo lloj lutjeje dhe përgjërimi në Frymën, duke ndenjur zgjuar për këtë qëllim me çdo ngulmim dhe lutje për të gjithë shenjtorët.” (*Efesianëve* 6:17, 18); - “Jini të durueshëm edhe ju dhe forconi zemrat tuaja, sepse ardhja e Zotit është afër.” (*Jakobi* 5:8).

10. Rrëfeni Jezusin si Shpëtimtarin tuaj! - “Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohemi.” (*Vëprat e Apostujve* 4:12).

11. Kërkoni Zotin! - “Kërkoni Zotin dhe forcën e tij, kërkoni vazhdimisht fytyrën e tij!” (*1 i Kronikave* 16:11).

12. Rrini zgjuar! - “Rrini zgjuar dhe lutuni, që të mos bini në tundim; sepse fryma është gati, por mishi është i dobët.” (*Mateu* 26:41).

Le t’i kujtojmë ca fjalë të urta: Me zaptu vetin është më e madhja trimëri; Mos thuaj se je, mos thua se ke, nuk je tjetër vetëm një grusht dhé; Asnjë gjë s’përparon ku s’është Zoti.

Mendoni për të ardhmën! - “Ndërsa ne nuk i drejtojmë sytë ndaj gjërave që duken, por ndaj gjërave që nuk shihen, sepse gjërat që duken janë për një kohë, kurse ato që nuk shihen janë të përjetshme.” (*2 e Korintasve* 4:18)

Kombi i ynë ka mbetë në terr

Historia e kombit tonë,
është shumë gjatë për t'u shkruar.
Por besoj se e meritoni,
disa fjalë që me u thënë dua.

Kombi i ynë ka heq zi,
se shumë kush shkel e ka.
Nuk po di a është i mallkuar,
se shumë here në gjak u la.

Na kanë shkel e po na shkelin,
për me heq zi, ne jemi mësuar.
Kur na vjen djalli mbi kokë,
për të shkojmë ne me votu.

Kombi i ynë ka mbetë në terr,
asgjë nuk sheh ai rreth vetit.
Si pranon asnjëherë gabimet,
fajin gjithmonë ia lë tjetrit.

Për ditë qajmë për kombin tonë,
duam shqiptarët ne me i bashku.
Por si brinjët në thes këta janë,
kurrë s'po mundem ne me i palu.

Ne jem të ndamë e çka atëherë,
e kemi gjakun si ma parë.
Tash është koha për me ndrrua,
mos duem kombit me i tretë farën.

Në zemër më dhimset kur i shoh,
vëllazërit, kur s'munden me u marr vesh.
Si bëjmë vetë ne me njëri-tjetrin,
dashuri ma s'ka ndër ne.

Askush në tokë s'është pa gabime,
por ne djallit ia kemi kaluar.
A mendoni se i ka ardhë koha,
kombit tonë për me u ndryshu?

Kush e do kombin tonë,
kush do vëllezërit me i bashku.
E kemi mbledhjen sa ma parë,
para Zotit me u takua.

Bënju bashkë, ju vëllezër shqiptarë,
prej një prindi, ne jemi të tanë.
Mos të ketë djalli, gjë me ne,
dikur kemi qenë, tanë në një fe.

I madhi Zot, është dashuri,
ai na thirr, me i shkua në shtëpi.
Që me qenë, gjithmonë të gëzuem,
se prej mëkatit, jemi të rrëzuem.

Bija ime

Kur më vjen bija në gjini,
shtëpia gëzohet pa kufi.
Gjyshja nipat i lazron,
e nga zemra u këndon.

Bija e mirë është krenari,
ta bën jetën lumturi.
I lidh dy shtëpi me dashuri,
e jeta është në harmoni.

Nuk ka gëzim pa ardh bija,
Pa bijë në vdekje, nuk të qan shtëpia.
Bija është lulja e shtëpisë,
Kjo është vegla e dashurisë.

Etika Indiane

1. Zgjohu me diellin dhe lutu. Lutuni për veten tuaj dhe lutuni më shpesh, sepse Shpirti i Madh do t'i dëgjojë, nëse ju jeni duke folur.
2. Të jeni tolerant ndaj atyre që e kanë humbur rrugën nga padija, zemërimi, xhelozia dhe lakmia nga shpirtrat e humbur. Lutuni për ata që të gjejnë udhëzim.
3. Mos lejo të tjerët të drejtojnë rrugën. Është koha jote - të tjerët mund të vijnë me ty, por askush nuk mund të shkojë për ju.
4. Trajtoni të ftuarit në shtëpi me shumë kujdes. T'i shërbeni atyre ushqimin më të mirë, për t'i dhënë atyre shtratin më të mirë, i trajton ata me respekt dhe ndershmëri.
5. Mos e merrni atë që nuk është e juaja.
6. Respektoni çdo gjë që ekziston në Tokë..
7. Kurrë të mos flasim keq për të tjerët.
8. Të gjithë njerëzit bëjnë gabime. Të gjitha gabimet mund të falen.
9. Mendimet negative shkaktojnë sëmundjen e mendjes, trupit dhe shpirtit.
10. Natyra nuk është e jona, është pjesë e jona. Kjo është pjesë e familjes sonë botërore.
11. Fëmijët janë fara e së ardhmës.
12. Mos lëndo të tjerët.
13. Jini të ndershëm në çdo kohë. Ndershmëria është testi i trashëgimisë dhe qëndrueshmërisë në këtë hapësirë.
14. Të jeni përgjegjës për veprimet tuaja.
15. Mos prek pronën e huaj, sidomos mos prekni në gjërat e shenjta dhe shpirtërore. Është e ndaluar.
16. Nderoni besimet e tjera fetare. Mos i detyroni të tjerët të besojnë sikurse ti.
17. Ndaje lumturinë tuaj.

Emri im është “Mos prek”

I lumi Zot më ka fal fëmijë,
e jam ma i vogëli në shtëpi.
Për me ec unë kam fillua,
e dua gjithçka me sprovua.

Nisa me ec, unë shumë mirë,
por i kam do rob të vështirë.
Se kur ishin fëmijë këta kanë harrua,
dhe gjithçka janë, duke më prua.

Jam më i riu në familje,
pa gjelozi, e pa hile.
Emri im është “Mos prek”
trup i im çka po hjek.

Dua jetën për të organizuar,
gjithçka shoh, me prek dua.
Ligji i fort është në këtë shtëpi,
çka kanë me mua, nuk po e di.

Kam ra në hall me këta rob,
nuk më lanë as me ba hop.
S’më lanë kokën, për me ngrit,
as në sofër për me hyp.

E kam gjetë një sekret të mirë,
se tek dajat ka vend të lirë.
Atje bëj unë gjithçka dua,
askush s’del për me më prua.

Gjyken e Gjyshin rueji Zot,
me dashuri këta janë plot.
Askurrë këta s’janë zëmrua,
por si Zotin, unë i dua.

Nuk po di unë çka me ba,
zot shtëpie s’duen me u ba.
Jam i bukur, e jam i ri,
dhe ma i miri në këtë shtëpi.

Jeto sikur kjo është dita e fundit në jetën tuaj!

A keni pyetur ndonjëherë veten, nëse kjo është dita e fundit e jetës tuaj, çfarë do të bëni? Le të themi se sot ju keni për të lënë këtë botë dhe do të shkoni në qiell që të takoheni me Krijuesin, çfarë do të bëni? Besoj se do të kërkosht gjithë të afërimit që t'i falësh. Pastaj do t'i përqafosh dhe do t'i thuash: “Unë ju dua! Shihemi në Qiell” Ta bëni këtë sot, sepse nesër mund të jetë tepër vonë. Ne nuk e dimë se sa kohë do të jetojmë. Vdekja mund të na vijë çdo minutë. Prandaj, bë paqe me Perëndinë dhe me njerëzit, që do të jesh i gatshëm për të shkuar në qiell.

Le të lutemi për kombin shqiptar

Krijuesi ynë, i cili krijoi qiellin, tokën dhe gjithçka që është në tokë dhe në qiell. Të lutem, o Zot, shiko mbi popullin shqiptar, i cili është i shkapërderdhur pothuajse në të gjithë botën dhe në disa besime të ndryshme. Vendosi ata në rrugën e drejtë. Jepu atyre njohuri, shpresë, dashuri dhe besim. Mësoji o Zot shqiptarët se si të ecin në rrugën Tënde. Vërtet, se si të respektojnë Ty dhe popullin Tonë. Të lutem o Zot, bekoje popullin shqiptar. Zot, na mëso se si të përgatitem për Ardhjen Tënde. Shkëlqeftë lavdia Jote e përjetëshme, Ashtu qoftë!

Zoti ju bekoftë!

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Qëllimi i këtij libri është që t'iu kujtoj se të gjithë mund të bëni më shumë për vete dhe për popullin shqiptar. Ne nuk mund të ndryshojmë të tjerët, por ne mund të ndryshojë veten. Le të fillojmë me veten. Le të japim një shembull të mirë të tjerëve. Shpresoj e besoj se të gjithë do të merrni përgjegjësinë për ndryshim. Mos u bëni si të tanë bota, sepse ata nuk janë më të mirë se ne. Në rast se e gjeni vetin në këtë libër, ju lutem mendoni për ndryshime. Po qe se s'e keni gjetur veten në këtë libër, kjo do të thotë që jeni një ëngjëll.

Në *Biblën* e shenjtë shkruhet: “Dhe dije këtë: në ditët e fundit do të vijnë kohë të vështira, sepse njerëzit do të jenë egoistë, lakmues parash, mburravecë, krenarë, blasfemues, të pabindur ndaj prindërve, mosmirënjohës, të paudhë, të padhembshur, të papajtueshëm, shpifës, të papërmbytur, mizorë, që s’e duan të mirën, tradhtarë, kokëshkretë, fodullë, dëfrimdashës më fort se perëndidashës, të perëndishëm në dukje, por mohues të fuqisë së saj; edhe nga këta largohu.” (2 e *Timoteut* 3:1-5); - “Tashmë fundi i të gjithave u afrua; jini, pra, të përkorë dhe rrini zgjuar për t’iu kushtuar lutjeve, dhe të keni para së gjithash një dashuri të madhe për njëri tjetrin, sepse “dashuria do të mbulojë një shumicë mëkatesh.” (1 e *Pjetrit* 4:7 dhe 8); - “Dashuria le të mos jetë me hipokrizi; urreni të keqen dhe ngjituni pas së mirës. Duani njëri tjetrin me dashuri vëllazërore; në nderim tregoni kujdes njëri me tjetrin. Mos u tregoni të përtuar në zell; jini të zjarrtë në frymë, shërbeni Perëndisë, të gëzuar në shpresë, të qëndrueshëm në shtrëngime, këmbëngulës në lutje; ndihmoni për nevojat e shenjtorëve, jini mikpritës. Bekoni ata që ju përndjekin, bekon i dhe mos mallkoni. Gëzohuni me ata që gëzohen, dhe qani me ata që qajnë. (*Romakëve* 12:9-15); - “Dërgojini klithma gëzimi Zotit, o banorë të të gjithë tokës! I shërbeni Zotit me gaz, ejani para tij me këngë gëzimi. Pranoni që Zoti është Perëndia; na ka bërë ai dhe jo ne vetë; ne jemi populli i tij dhe kopeja e kullotës së tij. Hyni në portat e tij me falenderim dhe në oborret e tij me lavde; kremtojeni, bekon i emrin e tij. Sepse Zoti është i mirë; mirësia e tij është e përjetshme dhe besnikëria e tij vlen për të gjitha brezat.” (*Psalmet* 100:1-5)

BIBLIOGRAFIA

BIBLA SHQIP: http://albkristian.com/bibla_shqip/index2.htm.

Të gjitha citimet në libër janë nga këtu janë marrë.

BRISKU, Bahri: *Kombësia dhe feja shqiptare. Reflektimi i besimit pagan në këngët e stinëve në krahinën e Ulqinit*; Tiranë 1994.

DANČTOVIĆ, Vojslav: *Fjalë të urta shqipe*. Prishtinë 1971.

DELA ROKA, Roberto Moroco: *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*; Tiranë 1994.

FISHTA, Gjergj: *Lahuta e malcis*. Shkodër 1940.

FILIPAJ, SIMON: *BIBLA: Shkrimi i shenjt Besëlidhja e vjetër dhe besëlidhja e re*. Tiranë 2011.

FILIPAJ, SIMON: *Jetëshkrim i shkurtër*. Podgoricë 2011.

FISHTA, Gjergj: *Mrizi i zanavet*. Shkodër 1941.

FISHTA, Gjergj: *Shqyptarët e të drejtat e tyne*, Shkodër 1920.

FRASHËRI, Kristo: *Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Jeta dhe veprat*. Tiranë 2002.

FRASHËRI, Sami: *Vepra I-VIII*. Prishtinë, 1979.

GJEÇOVI, Shtjefën: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Përmbledhur e kodifikur nga Shtjefën Gjeçovi. New York 1989.

HARAPI, Anton: *Fjalimi i Shkëlqesës P. Anton Harapi me rasën e betimit përpara Parlamentit: “T’a bâjmë monumentin kombtar: Bashkimin e Shqiptarëve”*; Tiranë 1994.

HARAPI, Anton: *Vlerë shpirtërore*, Shkodër 1936.

ILLIA, Frano: *Kanuni i Skanderbegut*. Mbledhje e kodifikue nga Dom Frano Illia; Milot 1993.

ILLIA, Frano: *Mësimi i Krishtenë*; Shkodër 1994.

KASTRATI, Jup: *Faik Konica*; New York 1995.

KONITZA, Faik: *Albania: The Rock Garden of Southeastern Europe*; Boston 1957.

LONGFELLOW, Henry Wadsworth: *Skënderbeu*; Boston 1916.

MIRDITA, Zef: *Krishtënimi ndër shqiptar*; Prizren-Zagreb 1998.

NOLI, Fan S.: *Historia e Skënderbeut, e kryezotit të Arbërisë 1405-1468*; Boston 1950.

PALAJ, Bernardin: *Mitologji: doke dhe zakone shqiptare*; botuar nga Nosh Gjollaj; Prishtinë, 2000.

PANAJOTI, Jorgo - XHAGOLLI, Agron: *Fjalë të urta shqipe*. Prishtinë 1987.

PETTERS, Markus W. E.: *Përballjet e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996*; Tiranë 2010

PLLUMI, Zef: *Rrno vetëm për me tregue 1944-1967*; Tiranë 1995, 1997.

PRENNUSHI, Vinçenc: *Uzdaje në Zotin. Letër baritore*; Shkodër 1944.

QIRIAZI, Dhori: *Krishtërimi në Shqipëri*; Tiranë 1967.

SIRDANI, Marin: *Shqypnija e shqyptarët*; Shkodër 1941.

WHITE, Ellen G.: *Beteja e madhe ndërmjet Zotit dhe djallit*. Shkup, 2003.

WHITE, Ellen G.: *Patriarchs and Prophets*. 2010.

WHITE, Ellen G.: *The desire of Ages: A Classic on the Life of Christ*. 2009.

WHITE, Ellen G.: *The great controversy between Christ and Satan: the conflict of the ages in the Christian dispensation*. Mountain View, Calif. 1975.

Për pyetje dhe komente ju lutemi kontaktoni:

prela@hotmail.com

ose

[https://www.facebook.com/Krenaria jonë](https://www.facebook.com/Krenaria_jonë)

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Lekoçaj, Prelë

Krenaria jonë / Prelë Lekoçaj ; rec. Zef Kastrati ;
red. Haxhi Berisha. – Tiranë : Mediaprint, 2017
1-136 f. ; 14x20 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-08-323-4

1.Etnologjia shqiptare 2.Shqiptarë 3.Doke dhe zakone
4. Proverba 5.Feja 6.Besimi

39(=18)

2 -523(=18)

Libri “Krenaria jonë” është strukturuar në dy pjesë: në njërën anë autori është përpjekur që të dhënat nga burime të ndryshme t’i shohë me sy kritik dhe të dalë me argumente sa më të vërteta, kurse në anën tjetër ai të gjitha këto fakte i sjell duke i ballafaquar me burime të mbështetura në Shkrimin e Shenjtë.

E veçanta e kësaj vepre është se mbështetet kryesisht në filozofë, mendimtarë, dijetarë, humanistë, letërsi popullore dhe në të drejtën zakonore.

Karakteristikë e stilit të Prelë Lekoçajt janë mendimet, të dhënat me forcën e arsytimit, një gjuhë e pasur, e larmishme si dhe rrjedhshmëria e shprehjes.